



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

“Mbi auditimin tematik të përputhshmërisë në pensionet e minatorëve të ushtruar në Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Tiranë, Dhjetor 2019



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

PËRMBAJTJA	<i>Faqe</i>
I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
II. HYRJA	3-5
a. Objektivat dhe qëllimi	3-4
b. Identifikimi i çështjes	4-4
c. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	4-4
d.Përgjegjësitë e audituesve	4-4
e. Kriteret e vlerësimit	4-5
f. Standardet e auditimit	5-5
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	6-11
IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET	11-61
A. Zbatueshmëria e kuadrit ligjor në fuqi, nga ana e strukturave përgjegjëse të ISSH –së përpensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë .	11-40
B. Verifikimi i rregullshmërisë dhe saktësisë së basës së të dhënave për përfituesit e pensionit që kanë punuar në minierë, në nëntokë.	40-49
C. Vlerësimi i sistemit të kontrollit të brendshëm në lidhje me mbrojtjen e fondin të sigurimeve shoqërore.	50-61
V. KONKLUZIONE	62-66



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Misioni i Institutit të Sigurimeve Shoqërore (ISSH) është administrimi i sigurimeve shoqërore në përgjithësi, dhe i politikave të pensioneve në veçanti, vendosja e personave të siguruar dhe përmirësimi i shërbimit ndaj tyre në qendër të veprimtarisë së këtij Institucioni, mbulimi i popullsisë me elementë të sigurimeve shoqërore në çdo vend dhe kohë kur lind kjo e drejtë, rritja e numrit të kontribuesve dhe grumbullimi i të ardhurave nga kontributet e fermerëve dhe të siguruarit vullnetarë, përmirësimi i efikasitetit të menaxhimit të fondeve të sigurimeve shoqërore, i fondeve përkohësisht të lira dhe fondit rezervë.

Objektivat e përgjithshme të ISSH-së

- a. Vazhdimi i punës për implementimin e skemës së reformuar të pensioneve;
- b. Zbatimi i politikave të Qeverisë për rritjen e të ardhurave të pensionistëve nëpërmjet rritjes së masës së pensioneve dhe indeksimit të tyre;
- c. Përmirësimi të administrimit të buxhetit të ISSH-së dhe cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve;
- d. Vazhdimi i punës për krijimin e një baze të plotë, të informatizuar të të dhënave, siç janë periudhat kontributive të personave, zbatimi i plotë i një sistemi të informatizuar të autorizimit dhe pagesave të pensioneve online, si për pagesat në zonat urbane, ashtu dhe ato rurale;
- e. Përmirësimi rrënjësor i praktikave të punës së inspektimit dhe të kontrollit të brendshëm, fokusimin e tij në luftën kundër informalitetit, duke zbatuar standardet e përcaktuara.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014 Datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit nr.919/1 , datë 15.11.2019, miratuar nga Kryetari i KLSH, në subjektin Instituti i Sigurimeve Shoqërore u krye “Auditim tematik i përputhshmërisë” nga Grupi i Auditimit me këtë përbërje:

1. B. J, Përgjegjës Grupi
2. Xh. K, Auditues
3. Xh. Xh, Auditues

Titulli: Auditim Tematik mbi Përputhshmërinë në Pensionet e Minatorëve në Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

a. Objektivat dhe qëllimi i auditimit: Në zbatim të programit të auditimit, objektivi kryesor i këtij auditimi është përputhshmëria e veprimtarisë së Institutit të Sigurimeve Shoqërore, për pensionet e minatorëve, me kuadrin ligjor në fuqi, për këtë fushë dhe më konkretisht, me Ligjin nr.7703, datë 11.05.1993, të ndryshuar, Ligjin nr.8685, datë 09.11.2000, të ndryshuar, Ligjin nr.150/2014, Ligjin 72/2017, Ligjin nr.29/2019, me aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi, si dhe me kërkesat e Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar.

Qëllimi i këtij auditimi është vlerësimi nëse aktiviteti i strukturave përgjegjëse të ISSH-së është kryer në përputhje me kuadrin rregullator, për kategorinë e pensioneve të minatorëve, në drejtim të: Identifikimit të saktë të të gjithë përfituesve nga kjo skeme pensioni; Pasqyrimin



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

të tyre në sistemin informatik të pensioneve PCAMS; Identifikimit të rasteve të përfitimit të pensionit në mënyrë abuzive, nga strukturat e inspektimit dhe kontrollit të brendshëm, si dhe pasqyrimin të tyre në sistemin informatik të pensioneve.

b. Identifikimi i çështjes: Për ushtrimin e aktivitetit, ISSH mbështetet në Ligjin nr 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në RSH”, të ndryshuar, Ligjin nr.8685, datë 09.11.2000, “Për një trajtim të vecantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, të ndryshuar, Ligjin nr.150/2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë”. Ligjin nr.29/2019 “Për trajtimin financiar, suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji”, si dhe aktet ligjore e nënligjore në funksion të tij si dhe rregulloret e udhëzimet përkatëse.

c. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese. Drejtimi i ISSH-së është përgjegjës për përputhshmërinë e vepimtarisë së ISSH me kuadrin ligjor në fuqi për pensionet e minatorëve si dhe rregulloret për implementimin e tyre, konkretisht në përfshirjen e përfituesve, sipas kriterëve, në skemat respektive të pensioneve të minatorëve, të nëntokës dhe krijimin e një baze të plotë të dhënash.

d. Përgjegjësitë e audituesve. Përgjegjësia e audituesve të KLSH është që të vlerësojnë përputhshmërinë e aktivitetit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për pensionet e minatorëve si dhe me ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin.

Për këtë qëllim auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme, sipas evidencës së mbledhur të auditimit.

e. Kriteret e vlerësimit: Për vlerësimin nëse përfshirja e personave përfitues në skemën e pensioneve të minatorëve, nga ana e strukturave përgjegjëse në ISSH, është kryer në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi; verifikimi i rregullshmërisë dhe saktësisë së basës së të dhënave për përfituesit e pensionit që kanë punuar në minierë, në nëntokë; vlerësimi i sistemit të kontrollit të brendshëm në lidhje me mbrojtjen e fondeve sociale.

Vlerësimi mbështetet në:

- Ligjin nr.7703, datë 11.05.1993 “Per sigurimet shoqërore në RSH”, të ndryshuar;
- Ligjin nr.8685, datë 09.11.2000 “Për një trajtim të vecantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, të ndryshuar;
- Ligjin nr.150/2014 “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë”;
- Ligjin nr.72/2017 “Për faljen e detyrimeve ndaj fondit të sigurimeve shoqërore të personave në pension invaliditeti, sipas Ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të personave në pension, sipas Ligjit nr.150/2014 “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, të krijuara për shkak të punësimit gjatë kohës së përfitimit të pensionit”;
- Ligjin nr.29/2019 “Për trajtimin financiar, suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji”;
- Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar;
- Ligjin nr.114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, të ndryshuar;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

- VKM nr.73, datë 15.02.2001 “Për kriteret dhe masën e trajtimit të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në minierë, nëntokë;
- VKM nr.78, datë 28.01.2015, “Për zbatimin e Ligjit nr.150/2014 “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë”;
- VKM nr.301, datë 23.05.2018 “Për procedurën e faljes së detyrimeve për subjektet e Ligjit 72/2017, “Për faljen e detyrimeve ndaj fondit të sigurimeve shoqërore të personave në pension invaliditeti...”;
- VKM nr.721, datë 11.11.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit, shumës vjetore të transfertës nga buxheti I shtetit dhe procedurave të financimit të fondit të sigurimeve shoqërore, për trajtimin financiar suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji”;
- Databaza e minatorëve që përfitojnë trajtim të veçantë nga ligji nr.8685 datë 09.11.2000 sipas degëve rajonale;
- Databaza e minatorëve që kanë përfituar trajtim të veçantë nga ligji nr.8685 datë 09.11.2000, të cilët janë transpozuar në sistemin informatik në vitin 2012;
- Databaza e minatorëve që kanë bërë kërkesë dhe kanë përfituar pension nga ligji nr.150/2014 datë 24.11.2014 sipas degëve rajonale;
- Databaza e minatorëve përfitues të trajtimit të veçantë me ligjin nr.8685, që me hyrjen në fuqi të ligjit nr.150/2014 kaluan në këtë lloj përfitimi;
- Databaza e minatorëve që kanë bërë kërkesë për përfitim me hyrjen në fuqi të ligjit nr.29/2019 datë 23.05.2019, dhe databaza me minatorët që kanë bërë kërkesë dhe u është miratuar përfitimi sipas ligjit 29/2019 deri në këto momente, sipas degëve rajonale;
- Rregullore e brendshme e ISSH-së, e të tjera akte nënligjore;
- Rregullore Nr. 1/2, Datë 04.03.2011 “Për një shtesë në rregulloren nr.1, datë 21.10.2008 “Për caktimin, administrimin dhe pagesën e pensioneve”, i ndryshuar;
- Rregullore e Brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin administrativ të KLSH-së”, miratuar me vendim të Kryetarit të KLSH-së nr.85, datë 30.06.2015;
- Urdhër Nr. 108 datë 17.11.2016 i Ministrisë së Financave “Për miratimin e Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit”.

f.Standardet e auditimit: Auditimi u bazua në Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, Rregulloren “Për Procedurat e Auditimit” miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr.107 datë 08.09.2017, referenca të tjera ligjore dhe në referencë të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t.

Auditimi është kryer sipas standardeve ndërkombëtare të SAI mbi auditimin e përputhshmërisë. ISSAI 100 “Auditimi i përputhshmërisë përcakton se deri në ç’masë subjekti i audituar ndjek rregullat, legjislacionin dhe aktet normative, politikat, kodet e miratuara apo kushtet e përcaktuara si, kushtet e kontratës apo klauzolat e një marrëveshjeje financimi” ISSAI 100 (Parimet themelore të auditimit të sektorit publik) përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;

ISSAI 400 (Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë) përcakton parimet themelore të ISSAI 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;

ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”;

ISSAI 4100 “Udhëzimet për auditimin e përputhshmërisë për auditimet që kryhen veçmas nga auditimi i pasqyrave financiare



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

III. PËRSHKRIMI AUDITIMIT

Informacioni i Përgjithshëm: Auditimi Tematik në Institutin e Sigurimeve Shoqërore, për vitin 2019, pati si pikënisje, ankesën e Sindikatës së Minatorëve të Shqipërisë “Janar 1991”. me nr.4/10, datë 18.10.2019, protokolluar në KLSH me nr.510/2, datë 18.10.2019.

Në mbështetje të ankesës së sipërcituar u hartua programi i auditimit me nr.919/1, datë 15.11.2019, i cili u miratua nga Kryetari i KLSH.

Në thelb ankesa fokusohet në dy çështje kryesore:

a) Identifikimin e saktë të përfituesve të pensioneve si ish punonjës miniere dhe vënien e tyre në dispozicion të Sindikatës së Minatorëve të Shqipërisë “Janar 1991”;

b) Pastrimin e skemës së pensioneve të minatorëve nga përfituesit abuzivë.

Referuar objektivave të ISSH-së , është detyrë e këtij Institucioni identifikimi i saktë i të gjithë përfituesve të pensioneve për ish punonjësit që kanë punuar në miniera, në nëntokë, nëpërmjet krijimit të një baze të plotë, të informatizuar të të dhënave, si dhe përmirësimi rrënjësor i praktikave të punës së inspektimit dhe të kontrollit të brendshëm, me fokus, luftën kundër informalitetit.

Objekti i këtij auditimi është përputhshmëria e veprimtarisë së Institutit të Sigurimeve Shoqërore, për pensionet e minatorëve, me kuadrin ligjor në fuqi, për këtë fushë dhe më konkretisht, me Ligjin nr.7703, datë 11.05.1993, të ndryshuar, Ligjin nr.8685, datë 09.11.2000, të ndryshuar, Ligjin nr.150/2014, Ligjin 72/2017, Ligjin nr.29/2019, me aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi, si dhe me kërkesat e Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar.

Qëllimi dhe fushëveprimi i auditimit.

Qëllimi i këtij auditimi është vlerësimi nëse aktiviteti i strukturave përgjegjëse të ISSH-së është kryer në përputhje me kuadrin rregullator, për kategorinë e pensioneve të minatorëve, në drejtim të: Identifikimit të saktë të të gjithë përfituesve nga kjo skeme pensioni; Pasqyrimin të tyre në sistemin informatik të pensioneve PCAMS; Identifikimit të rasteve të përfitimit të pensionit në mënyrë abuzive, nga strukturat e inspektimit dhe kontrollit të brendshëm, si dhe pasqyrimin të tyre në sistemin informatik të pensioneve.

Fushëveprimi i këtij auditimi lidhet kryesisht me të dhënat e data base-s së pensioneve, si dhe me evidencat, statistikat, raportet e prodhuara nga strukturat përgjegjëse në ISSH, në funksion të pensioneve të minatorëve. Evidencat janë marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e ISSH, duke qenë se, drejtoritë rajonale nuk kanë qenë objekt i këtij auditimi.

Çështjet kryesore të Auditimit: Çështjet kryesore të auditimit janë ato çështje të cilat në gjykimin tonë, kanë rezultuar më të rëndësishmet në bazë të vlerësimit të risqeve të identifikuar në fazën e parë të auditimit si dhe çështjeve të dala gjatë auditimit mbi aktivitetin e Instituit të Sigurimeve Shoqërore. Çështjet kryesore në auditimin e aktivitetit të këtij Institucioni në lidhje me pensionet e minatorëve të nëntokës paraqiten bazuar në Programin e Auditimit, si më poshtë:

Përshkrim i përmbledhur i gjetjeve dhe rekomandimeve nga auditimi

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
------------	-----------------------	------------------------------------	----------	-------------



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1.	Pasaktësi në hedhjen fillestare të të dhënave në sistemin e pensioneve PCAMS, në vitin 2012, për përfituesit e skemës së Ligjit nr.8685, datë 09.11.2000 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në minierë, në nëntokë”.	Faqe 12-15 &32-34	E lartë	a) ISSH të kalojë në një proces inspektimi/verifikimi dhe më pas dixhitalizimi, të gjithë regjistrat e kërkesave, kthimeve, caktimeve, mbylljeve, të trajtimit të vecantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të cilat administrohen nga Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore; b) Në përfundim të procesit të inspektimit/verifikimit, të dokumentacionit të administruar nga DRSSH, ISSH të verifikojë gjithë informacionin e hedhur në sistemin informatik të pensioneve PCAMS, në vitin 2012 dhe rezultatet e këtij procesi t'i pasqyrojë në sistem në një kolonë të vecantë.
2.	Bazuar në të dhënat e sistemit PCAMS, sot përfitojnë trajtim të veçantë sipas ligjit nr.8685 datë 09.11.2000, ende 147 ish minatorë, por evidencat për kategorinë e minatorëve përfitues sipas ligjit nr.8685 datë 09.11.2000, që kanë zgjedhur të trajtohen në vijim sipas ligjit nr.150/2014 datë 24.11.2014, vënë në dispozicion grupit të auditimit, paraqesin pasaktësi.	Faqe 41-42&47-48	E lartë.	a) Njësia e Inspektimit në ISSH të kalojë në një proces shqyrtimi/certifikimi 147 dosjet e personave përfitues të Ligjit nr.8685, datë 09.11.2000, të cilët aktualisht rezultojnë aktiv në skemë; b) ISSH të identifikojë numrin e saktë të ish përfituesve sipas Ligjit nr.8685 datë 09.11.2000, që sot trajtohen me përfitim sipas nenit 9 “E drejta për të zgjedhur përfitimin”, të Ligjit nr.150/2014 datë 24.11.2014; c) Në përfundim të procesit, për të garantuar transparencën ndaj grupeve të interesit të publikojë në faqen zyrtare të ISSH listat emërore të personave përfitues aktiv sipas Ligjit nr.8685, datë 09.11.2000.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
3.	<p>Nga kryqëzimi dhe testimi me zgjedhje i evidencave të vëna në dispozicion, gjeneruar nga sistemi PCAMS, të përfituesve të Ligjit nr.150/2014 datë 24.11.2014, është konstatuar se evidenca e përfituesve aktual aktiv të Ligjit 150/2014 vënë në dispozicion nga Drejtoria e Burimeve të Informacionit ka pasaktësi, për rrjedhojë është e pamundur identifikimi i numrit të saktë total të përfituesve nga ky ligj. Gjithashtu nga auditimi është konstatuar se në sistemin PCAMS për të njëjtën kategori përfituesish “subjekte që u ndërpritet përfitimi pas verifikimeve të vet strukturave të ISSH” ekzistojnë në sistem 3 kategori të ndryshme, duke rezultuar në një praktikë të paunifikuar të hedhjes së të dhënave në sistem, çka shkakton konfuzion dhe keq interpretim të shifrave.</p>	Faqe 43-45&48-49	E lartë.	<p>a)) ISSH të marrë masat për identifikimin e saktë të përfituesve aktiv sipas Ligjit 150/2014 datë 24.11.2014, të ndarë sipas dy kategorive në “përfitues të ardhur nga Ligji nr.8685” dhe “përfitues të rinj”, dhe në përfundim të procesit të publikojë në faqen zyrtare listën emërore të përfituesve të këtij ligji, për të garantuar transparencën;</p> <p>b) ISSH të unifikojë praktikën e hedhjes së të dhënave në sistem në të gjitha rajonet, duke përcaktuar qartësisht në një akt administrativ, se si do të përshkruhen në sistem veprime specifike dhe ndryshime të statusit të dosjeve.</p>
4.	<p>a) 658 nga 774 debitorë, ose 85% e numrit të përgjithshëm të debitorëve nuk janë në proces arkëtimi dhe shuma e debisë që ata përfaqësojnë (436,067,017 lekë) zë 89% të shumës totale të debisë (487,931,873 lekë);</p> <p>b) 64 përfitues debitorë në shumën 36,561,410 lekë, ose 9,7% e debitorëve nuk shlyejnë debinë edhe pse rezultojnë të jenë pjesë e skemës së përfitimeve nga viti 2013 deri në vitin 2019.</p> <p>c)10 nga 37 përfitues (punonjës që kanë punuar në miniera, në nëntokë), ose 27% e atyre që u është ndërprerë TVM për shkak të punësimit, rezultojnë debitorë në shumën</p>	Faqe 21-23&34-35	E lartë.	<p>Të hartojë politika dhe të formalizojë procedura të qarta, për të mundësuar arkëtimin e shumës debitorë prej 436,067,017 lekë, nga moment i hyrjes së përfituesve debitorë në një prej skemave të përfitimit;</p> <p>b) Të nxjerrë përgjegjësitë administrative, sipas DRSSH-ve respektive për mosarkëtimin e debisë për 64 përfituesit debitorë të cilët edhe pse rezultojnë të jenë pjesë e skemës së përfitimeve nga viti 2013 deri në vitin 2019, ende vazhdojnë të mosshlyejnë debinë.</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	5,741,200 lekë dhe aktualisht janë në kushtet e pamundësisë për të shlyer debinë.			
5.	880 procese gjyqësore të humbura nga ISSH ndaj punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë për periudhën 2000-2019. Vetëm për periudhën 01.01.2008-31.10.2019, ISSH ka paguar për proceset gjyqësore të humbura kundrejt minatorëve përfitues të skemës së Ligjit nr.8685/2000 dhe Ligjit nr.150/2014, në total 709,169,746 lekë, ose 96.3% të debisë totale të arkëtuar.	Faqe 21 & 36-37	E lartë.	ISSH të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë administrative në lidhje me vendimet gjyqësore, në dëm të institucionit. Për çdo proces gjyqësor të përfunduar, të zhvillohen analizat nga Drejtoria Juridike në ISSH dhe Drejtori i Përgjithshëm i ISSH-së dhe të nxirren përgjegjësitë administrative kundrejt personave të autorizuar të ISSH-së, për mosveprimet dhe mospërbushjen e detyrës shtetërore.
6.	Pasaktësi në raportimet e Drejtorisë së Financës në drejtim të numrit të përfituesve dhe shumës faktike të transfertës buxhetore, për kategorinë e minatorëve të nëntokës.	Faqe 23-25 & 37-38	E lartë.	ISSH të marrë masa për zhvillimin e sistemit elektronik të pensioneve PCAMS duke e ndërlidhur atë me sistemin e financës FMS.
7.	Mosushtrimi nga ana e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm i kërkesave të pikës 3 të VKM nr.301, datë 23.05.2018, dalë në zbatim të Ligjit nr.72/2017, për auditimin e rregullshmërisë së vendimeve të DRSSH lidhur me evidentimin dhe likuidimin e detyrimeve të falura sipas dispozitave të Ligjit nr.72/2017.	Faqe 26-29 & 38-39	E lartë.	Drejtorja e Auditimit të Brendshëm në ISSH, në planin vjetor të vitit 2020, të planifikojë një auditim të vecantë mbi rregullshmërinë e vendimeve të DRSSH, në lidhje me evidentimin dhe shlyerjen e detyrimeve të falura sipas dispozitave të Ligjit nr.72/2017 dhe në përfundim të procesit, për rezultatet e arritura të njoftojë Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
8.	Mosrakordim të dhënash midis sistemit informatik të pensioneve PCAMS dhe strukturës së inspektimit, në lidhje me numrin e dosjeve të mbyllura.	Faqe 18-20 & 35-36	E lartë	<p>a) Strukturat përgjegjëse në ISSH të koordinojnë punën në funksion të, saktësisimit dhe detajimit të 991 përfituesve, (dosjet e të cilëve rezultojnë të mbyllura nga auditimi në sistemin informatik të pensioneve PCAMS), nga zbatimi i skemave të Ligjit nr.8685/2000 dhe Ligjit nr.150/2014;</p> <p>b) Pasi të saktësohet statusi i tyre të pasqyrohen vecmas në sistem nën kategorinë “Konkluduar sa përfituar padrejtësisht”.</p>
9.	Mangësi në funksionimin dhe dokumentimin e Kontrollit të Brendshëm, në drejtim të: a) Mosreflektimit në rregulloret e ISSH-së të ndryshimeve strukturore gjë e cila riskon mosgarantimin e ndarjes së qartë të detyrave sipas pozicioneve të punës; b) Mospërfshirjes në to së të drejtës së vendosjes së gjobës, si detyrim që rrjedh nga zbatimi i nenit 5 të Ligjit nr.150/2014“Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, c) Mospërfshirjes në regjistrin e riskut të objektivave që lidhen me, identifikimin e saktë të të gjithë përfituesve të pensioneve që kanë punuar në miniera, në nëntokë dhe pasqyrimin e tyre në sistemin informatik të pensioneve PCAMS: d) Pasaktësisë së raporteve të prodhuara dhe shpërndara nga Njësia Përgjegjëse për Inspektimin, gjë e cila riskon garantimin e gjurmës së auditimit dhe realizimin e objektivit të ISSH –së, që është përmirësimi rrënjësor i praktikave të punës së inspektimit dhe të kontrollit të brendshëm, me fokus luftën kundër informalitetit, nëpërmjet zbatimit të standardeve të përcaktuara.	Faqe 18-19; 31-32 & 50-61	E lartë.	<p>a) ISSH të marrë masa për përmirësimin e Rregullores për Organizimin e Detyrave Funksionale në Drejtorinë e Përgjithshme të ISSH-së dhe Rregullores nr.1/2, datë 04.03.2011 “Për një shtesë në Rregulloren nr.1, datë 21.10.2008 “Për caktimin, administrimin dhe pagesën e pensioneve”, e ndryshuar, në drejtim të reflektimit në to të ndryshimeve strukturore si dhe të përfshirjes në detyrat e Njësisë Përgjegjëse për Inspektimin të drejtën e vendosjes së gjobës, si detyrim që rrjedh nga zbatimi i nenit 5 të Ligjit nr.150/2014“Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”;</p> <p>b)Strukturat përgjegjëse të ISSH-së të vlerësojnë në regjistrin e riskut të gjitha problematikat e dala nga Njësia e Inspektimit të Përfitimeve, për pensionet suplementare të minatorëve që paraqesin risk;</p> <p>c) Institucioni të marrë masa që planifikimi i kontroleve dhe çertifikimi i pensioneve të minatorëve nga Njësia e Inspektimit të Përfitimeve të kryhet jo më vonë se një vit, me qëllim identifikimin në kohë të mangësive dhe dëmeve të shkaktuara në mënyrë që fondet për pensione të përdoren me efektivitet;</p>



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
				d)Njësia Përgjegjëse për Inspektimin të marrë masa për përmirësimin rrënjësor të praktikave të punës së inspektimit dhe të kontrollit të brendshëm, me synim garantimin e gjurmës së auditimit dhe realizimin e objektivit të ISSH –së, me fokus luftën kundër informalitetit.
10.	Në relacionin shoqëruar të pasqyrave financiare të vitit 2018, nuk ka një analizë të detajuar të kategorive të përfituesve që përbëjnë shumën 7,543,983,113.92 lekë pasqyruar në zërin “Të tjera kërkesa debitore”.	Faqe 25-26&39-40	E mesme	Drejtoria e Financës të marrë masa që në hartimin e pasqyrave financiare të vitit 2019, të analizojë zërin “Të tjera kërkesa debitore”, sipas të gjitha kategorive të përfituesve që e përbëjnë atë dhe në mënyrë të veçantë, të saktësojë shumën e përfitimeve për kategorinë e punonjësve që kanë punuar në minierë në nëntokë.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

Grupi i auditimit vlerëson punën e bërë nga stafi drejtues i ISSH për të formalizuar praktikatat dhe procedurat që ndiqen nga DRSSH-të, që konsistojnë në hartimin dhe miratimin e rregulloreve, udhëzimeve dhe manualeve, duke përcaktuar rregullat dhe përgjegjësitë për cdo strukturë përgjegjëse, si dhe gadishmërinë dhe bashkëpunimin me grupin e auditimit gjatë ushtrimit të auditimit në ISSH. Krahas vlerësimeve për punën voluminoze dhe dinamike të kryer nga stafi i ISSH, grupi i auditimit ka konstatuar edhe parregullsi, të cilat janë trajtuar sipas drejtimeve të programit, si vijon:

A. Zbatueshmëria e kuadrit ligjor në fuqi, nga ana e strukturave përgjegjëse të ISSH-sëpërpensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë.

Përlllogaritja e pensioneve për punonjësit që kanë punuar në miniera, në nëntokë, deri në daljen e Ligjit specifik nr.8685, datë 09.11.2000 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në minierë, në nëntokë”, janë kryer referuar, Ligjit nr.4171, datë 13.09.1966 “Për Sigurimet Shoqërore Shtetërore në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë”, të ndryshuar, Dekretit nr.7464, datë 31.01.1991 “Për disa ndryshime në Ligjin nr.4171, datë 13.09.1966 “Për Sigurimet Shoqërore Shtetërore në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë...” si dhe Ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në RSH”, të ndryshuar.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr.8685, datë 09.11.2000 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në minierë, në nëntokë e deri në miratimin e Ligjit 29/2019, “Për trajtimin financiar, suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji”, trajtimi i punonjësve që kanë punuar në minierë, në nëntokë, ka kaluar në disa etapa.

I. Ligji nr.8685, datë 09.11.2000 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në minierë, në nëntokë”, i ndryshuar dhe aktet e dala në zbatim të tij.

Ligji nr.8685, datë 09.11.2000 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në minierë, në nëntokë”, përcakton si kategori përfituesish ata punonjës që kanë punuar në minierë për një periudhë jo më pak se 11 vjet e gjysëm nëntokë dhe kanë një periudhë sigurimi jo më pak se 23 vjet, në rastet kur nuk ushtrojnë veprimtari ekonomike. Përfitimi për këta punonjës është në masën 60 % të bazës së vlerësuar.

Në nenin 4 të Ligjit nr.8685, datë 09.11.2000 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në minierë, në nëntokë”, shprehimisht përcaktohet:

“Kërkesa për përfitim paraqitet nga përfituesi pranë degëve të agjencive të drejtorive rajonale të sigurimeve shoqërore dhe e drejta e ushtrimit të kërkesës për përfitim nga ky ligj, mund të ushtrohet nga subjektet që e përfitojnë atë deri në datë 31.03.2001”.

Nga informacioni i administruar grupit të auditimit rezulton se, informacioni me të dhëna të plota në lidhje me kërkesat për përfitim, për kategorinë e minatorëve të nëntokës, gjendet pranë agjencive rajonale, pasi janë ato që i kanë regjistruar në mënyrë manuale, në një rregjistër të veçantë, të gjitha kërkesat e përfituesve të trajtimit të veçantë, që rrjedhin nga zbatimi i Ligjit nr.8685, datë 09.11.2000 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, të ndryshuar.

Në total, numri i kërkesave për përfitim nga Ligji nr.8685, datë 09.11.2000, në evidencat e paraqitura grupit të auditimit nga strukturat e auditimit dhe certifikimit në ISSH paraqitet 5,527 kërkesa, të ndara në 10 rajone, ndërkohë që referuar të dhënave të ofruara nga drejtoria e financës në ISSH, për vitin 2003 ky numër paraqitet 5,549 përfitues dhe për vitin 2004, rritet në 5,554 përfitues.

Deri në vitin 2012, të dhënat për këtë kategori përfituesish janë mbajtur vetëm manualisht në rregjistra pranë agjencive rajonale, ndërkohë që nga viti 2012, këto të dhëna rezultojnë të identifikuar nga ISSH në sistemin elektronik të pensioneve PCAMS (Pension Calculation Management System) në një shtyllë të veçantë.

Referuar sqarimeve zyrtare, të marra nga Drejtoria e Burimeve të Informacionit, në sistem, në momentin fillestar, janë hedhur në total të gjitha të dhënat për përfituesit e mbyllur nga ky ligj, përpara se sistemi të vihej në funksion. Theksojmë se, hedhja e të dhënave nga rregjistrat fizikë në sistemin elektronik të pensioneve PCAMS është bërë nga operatorë jo profesionist, gjë e cila nuk përjashton mundësinë e gabimeve në hedhje.

Data e mbylljes në sistem jo në të gjitha rastet përkon me datën reale, pasi ka përfitime të mbyllura para vënies në funksion të sistemit, të cilat janë hedhur në sistem dhe janë mbyllur brenda ditës. Arsyeja e këtij veprimi ka qenë që në data base-n e pensioneve të ketë një historik edhe për këto “përfitime të mbyllura”.

Në datën 25.11.2019, zyrtarisht, në rrugë elektronike, grupit të auditimit, i’u vu në dispozicion një pjesë e gjeneruar nga sistemi i pensioneve PCAMS, për kategorinë e minatorëve përfitues të Ligjit nr.8685, datë 09.11.2000 dhe kategorinë e minatorëve përfitues të Ligjit 150/2014, në format excel.

➤ Në sheet-in e parë të këtij informacioni gjenden të pasqyruara të dhënat e personave që në datën e gjenerimit të këtij informacioni rezultojnë përfitues aktiv nga skema e Ligjit 8685/2000;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

➤ Në sheet-in e dytë janë të pasqyruar të dhënat e personave që në datën e gjenerimit të këtij informacioni rezultojnë të mbyllur, përfshirë këtu edhe përfituesit që kanë kaluar në skemën e përfitimit nga Ligji 150/2014;

➤ Në sheet-in e tretë janë të pasqyruar të dhënat e personave që në datën e gjenerimit të këtij informacioni rezultojnë përfituesit të skemës së përfitimit nga Ligji 150/2014 ardhur nga skema e përfitimit të Ligjit 8685/2000.

Nga të dhënat e sistemit elektronik të pensioneve PCAMS të administruara nga grupi i auditimit, në datë 25.11.2019, rezultojnë:

- Me status aktiv 147 dosje të minatorëve përfitues nga skema e Ligjit nr.8685, datë 09.11.2000, në 10 agjenci rajonale;
- Të mbyllura 4,283 dosje, sipas arsyeve të poshtëshënuara:
 - 37 ish përfitues fillojnë punë;
 - 2,237 ish përfitues kalojnë si përfitues në një lloj tjetër pensioni (Ligji 150/2014);
 - 1,818 dosje të ish përfituesve rezultojnë të mbyllura nga auditimi/nuk plotësojnë kushtet;

- 90 dosje të ish përfituesve rezultojnë të pezulluara;
- 57 dosje të ish përfituesve rezultojnë të transferuar në një rajon tjetër;
- 44 ish përfitues rezultojnë të vdekur.

Bazuar në informacionin e gjeneruar nga sistemi i pensioneve PCAMS në datë 25.11.2019, grupi i auditimit në projektraportin e auditimit, ka konstatuar se, në total, në datën 25.11.2019, rezultojnë përfitues të Ligjit nr.8685, datë 09.11.2000, “Për një trajtim të vecantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, të ndryshuar, 4,430 persona nga 5,527 kërkesa të administruara dhe njëkohësisht përfitues fillestar të kësaj skeme sipas informacionit të ofruar nga strukturat e ISSH-së.

Nga 4,430 përfitues të identifikuar në sistemin e ISSH-së, 1,908 dosje përfituesish rezultojnë në sistem të mbyllura (nga auditimi/nuk plotësojnë kushtet/janë të pezulluara).

Nga kryqëzimi i të dhënave të sheet-it të mbyllura në data base-n e përfituesve sipas Ligjit 8685/2000, kategoria të mbyllura nga auditimi/nuk plotësojnë kushtet /pezullim, me sheet-in të mbyllura në data base-n e përfituesve sipas Ligjit 150/2014 (të mbyllur pas vitit 2015), u identifikuan dublime për 42 individë, të cilët rezultojnë në të dy data base-t në kategorinë të mbyllura (arsyeja: nga auditimi/nuk plotësojnë kushtet/pezulluar). Pas sistemit të këtij dublimi, numri i dosjeve të mbyllura, për përfituesit e Ligjit 8685/2000, rezulton të jetë 1,866, për rrjedhojë këta 1,866 persona përfitues të skemës së Ligjit nr.8685, datë 09.11.2000, klasifikohen “Debitorë”, pasi dosjet e tyre rezultojnë të jenë mbyllur nga auditimi me arsyen e mosplotësimit të kushteve për të përfituar nga kjo skemë.

Në informacionin e sipërcituar nuk jepen detaje në lidhje me këto 1,866 dosje.

Grupi i auditimit, gjatë kohës së ushtrimit të auditimit në ISSH, kërkoi një analizë të detajuar të dinamikës së ecurisë së përfaqësimit dhe shlyerjes së detyrimit që mbartin 1,866 dosjet e mbyllura të përfituesve të skemës së Ligjit nr.8685, datë 09.11.2000, konkretisht, në lidhje me: shumën totale të kësaj debie; numrin/listën emërore/shumën e debisë, për kategorinë e përfituesve që i’u është mbyllur dosja dhe ndërkohë nuk janë pjesë e asnjë prej skemave të tjera të pensionit; identifikimin e tyre në sistemin informatik të pensioneve në shtyllë të vecantë si dhe politikën që ndjek ISSH për vjeljen e këtyre debive.

Gjithashtu grupi i auditimit kërkoi informacion të detajuar në lidhje me 1,097 përfitues të cilët nuk paraqiten në sistem, por rezultojnë si diferencë e numrit fillestar të përfituesve të skemës së Ligjit nr.8685, datë 09.11.2000 (5,527 përfitues) me numrin aktual të përfituesve në sistemin e pensioneve në datë 25.11.2019 (4,430 përfitues).

Deri në përfundim të auditimit, grupit të auditimit nuk i’u paraqit një analizë e tillë e dokumentuar, gjithashtu grupi i auditimit nuk mund të shprehet në lidhje me shumën totale të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

kësaj debie, pasi në data base-n që ISSH gjeneroi për grupin e auditimit në datë 25.11.2019, kolona e vlerës nuk paraqitej.

Për pasaktësitë e konstatuara në data base-n e të dhënave që ISSH vuri në dispozicion të grupit të auditimit, përgjegjësi mban znj. [REDAKTUAR] me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Burimeve të Informacionit.

Konstatimi i grupit të auditimit në projektraportin e auditimit:

Bazuar në informacionin e gjeneruar nga sistemi i pensioneve PCAMS në datë 25.11.2019: Pasaktësi dhe mungesë të dhënash në informacionin e gjeneruar nga sistemi elektronik i pensioneve PCAMS për përfituesit e skemës së Ligjit nr.8685, datë 09.11.2000 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në minierë, në nëntokë”.

Sqarimet e paraqitur nga ISSH me shkresën nr.7719/3, prot, datë 23.12.2019, protokolluar në KLSH me nr.919/3, datë 24.12.2019:

Në shkresën e sipërcituar, ndërmjet të tjerash, theksohet specifikisht:

“Caktimi, administrimi dhe pagimi i trajtimeve të veçanta, si dhe i të gjithë përfitimeve realizohet në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore. Sipas të dhënave të regjistrave të kërkesave që mbahen në Drejtorinë Rajonale (Agjencitë e Sigurimeve Shoqërore), janë evidentuar 5893 kërkesa, por pas shqyrtimit paraprak një pjesë e tyre janë refuzuar dhe nuk kanë kaluar në proces shqyrtimi dhe caktimi të përfitimit. Bazuar në të dhënat statistikore numri mesatar i dosjeve të kërkuarve të pranuar deri në vitin 2002 arriti në 5549 persona.

Diferenca midis kërkesave të drejtuara dhe të pranuar kryesisht është e lidhur me mos plotësimin e kushteve të përfitimit, si të vjetërsisë së përgjithshme në punë ashtu edhe të vjetërsisë në punë të vështirë prej 11,5 vite. Baza e të dhënave të pensioneve në sistemin informatik aktual PCAMS ka filluar të popullohet me të dhëna në vitin 2012 dhe janë hedhur të dhënat me operatorë duke u nisur nga dosjet stok. Në këtë kohë u hodhën edhe të dhënat e dosjeve të TVM që ishin aktive, pra që paguheshin si dhe dosjet që ishin të pezulluara apo mbyllura me qëllim evidentimin e tyre për të shmangur lidhjen e një përfitimi tjetër pa ju evidentuar debia dhe mbajtja e debisë kur të përfitonin nga ndonjë skemë tjetër. Vlen të theksohet se në atë kohë të dhënat mbaheshin në bazë rajonale në formatin excel gjë që nuk të mundësonte kontrollin total të lidhjes së përfitimeve.

Nisur nga aktkonstatimi juaj ju kërkua rajoneve që të dërgonin të dhënat nga regjistrat në letër për përfituesit e TVM dhe ndryshimet që kanë ndodhur. Nga këto ka rezultuar që deri në vitin 2012 kanë kaluar nga trajtim i veçantë në një trajtim tjetër nga ligji 7703, gjithsej 844 persona dhe kanë vdekur gjatë kësaj periudhe 59 persona. 37 persona kanë ndërprerë trajtimin për shkak të punësimit dhe të vetë punësimit. Trajtime të veçanta aktive që paguheshin në vitin 2014 para se të dilte ligji 150/2014 kanë qënë 3573 persona (kjo shifër është marrë nga llogaritjet që janë bërë për efektet financiare të ligjit 150/20014). 207 vetë kanë kaluar në një pension tjetër sipas ligjit 7703 nga 2012 – 2014 dhe 774 persona janë debitorë që vilen apo presin për tu vjelë. Nga numri 5527 që ka qënë në fillim po të zbresim të gjitha sa më sipër rezulton që 33 persona nuk kanë status dhe mendojmë se mund të kenë ndërrura jetë gjatë periudhës 2012-2014 ose kanë shlyer debinë dhe nuk janë të evidentuar. Për këta persona do të kontrollohet dhe të sistemohen.

Përsa i përket të dhënave nga sistemi PCAMS, të dhënat janë hedhur në vitin 2012 dhe numri total që janë hedhur është 4396 përfitime nga të cilët 148 vetë vazhdojnë të përfitojnë trajtimin e veçantë pasi nuk kanë mbushur moshën e daljes në pension sipas 150/2014, 3214 persona kanë kaluar në përfitim sipas ligjit 150/2014, 774 janë debitorë në financë që vilen ose priten të futen në skemë që të vilet debia, 207 persona që kanë kaluar në përfitim tjetër nga



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

2012 deri 2014, 13 persona të hedhur në vitin 2012 kanë qënë të vdekur pasi NID i tyre është AB....., që është një NID për persona të vdekur si dhe 40 persona kanë ndërruar jetë gjatë viteve 2012-2014.

Ju sqarohet se të dhënat e datës 25 janë të gjeneruara sipas rajoneve dhe agjensive ndërsa të dhënat që po ju nisim janë gjeneruar duke hequr kufizimin e rajonit dhe përdorur si çelës vetëm NID-in me qëllim shmangjen e rasteve që janë transferuar nga një rajon në tjetrin. Kjo pasi nëse ruhet kufizimi rajon atëherë sistemi i numëron atëherë sa janë sa i gjen dhe për pensionet e transferuara i numëron në të dy apo tre rajonet ku kanë qënë të regjistruar apo paguar”.

Trajtimi nga grupi i auditimit i sqarimeve të paraqitura nga ISSH:

Grupi i auditimit vlerëson punën e bërë nga stafi drejtues i ISSH për të sqaruar pasaktësitë e konstatuara në projektraportin e auditimit, në lidhje me informacionin e gjeneruar nga sistemi informatik i pensioneve PCAMS dhe paraqet qëndrimin e vet si vijon:

Së pari: Të dy data base-t e paraqitura nga ISSH nuk janë të njëjta si statistika pasi janë nxjerrë duke marrë si çelës data të ndryshme kërkimi.

Së dyti: Sqarohet hedhja në sistem e dosjeve stok (dosje aktive+dosje të mbyllura/pezulluara), jepet një pasqyrë e dinamikës së trajtimit të vecantë të minatorëve (TVM) ndër vite, raportohet se në vitin 2012 në sistemin PCAMS janë hedhur në total 4,396 përfitime nga 5.549 të pranuar deri në vitin 2002 por, nuk jepen sqarime për diferencën prej 1,153 përfituesish të pahedhur në sistem.

Së treti: Sqarimi juaj se, pasaktësitë e informacionit të gjeneruar në datë 25.11.2019, kanë ardhur si pasojë e gjenerimit sipas rajoneve dhe jo sipas NID-it, duke numëruar dy ose tre herë pensionet e transferuara nga një rajon në tjetrin pranohet vetëm për rastet e dubluara si pasojë e transferimeve gjë e cila reflektohet në gjenerimin e tanishëm, ku numri i përfituesve në vitin 2012 paraqitet 34 përfitues më pak (4,396 nga 4,430 që paraqitej në informacionin e datës 25.11.2019), ndërkohë që në tërësinë e vet materiali i risjellë nga ana juaj paraqet pasaktësi në:

-Hedhjen fillestare të të dhënave në vitin 2012 (1,153 përfitues nuk janë pasqyruar në sistem në vitin 2012 (diferenca 5,549 kërkesa të pranuar - 4,396 përfitime të hedhura në sistem në vitin 2012);

-Analizën e dinamikës së TVM para vitit 2012 (844 persona transferuar nga TVM te Ligji 7703, 59 persona të vdekur dhe 37 persona ndërprerë TVM për shkak të punësimit), në total 940 persona dhe jo 1,153 që është numri i përfituesve që nuk janë pasqyruar në sistem në vitin 2012, për më tepër referuar sqarimeve tuaja edhe këto kategori duhej të hishin hedhur në sistem për të krijuar historikun e TVM.

Përfundimi:

Grupi i auditimit në raportin përfundimtar të auditimit lë si gjetje pasaktësitë në hedhjen fillestare të të dhënave në sistemin e pensioneve PCAMS, në vitin 2012.

Në zbatim të Ligjit nr.8685, datë 09.11.2000 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në minierë, në nëntokë”, ka dalë VKM nr.73, datë 15.02.2001 “Për kriteret dhe masën e trajtimit të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në minierë, në nëntokë”, e cila:

Në pikën 5 të saj përcakton shprehimisht se:

“Personat që plotësojnë kushtet për përfitimin e trajtimit të veçantë do të pajisen nga ISSH me 2 kopje të kërkesës për përfitim” dhe

Në pikën 10 përcakton se: “ISSH përcakton dokumentacionin që autorizon dhe vërteton pagesën e përfitimeve, në zbatim të Ligjit nr.8685, datë 09.11.2000”.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Nga auditimi rezulton se, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, në zbatim të VKM nr.73, datë 15.02.2001, ka hartuar dhe miratuar, Udhëzimin nr.1, datë 16.01.2001 “Për zbatimin e VKM “Për kriteret dhe masën e trajtimit të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në minierë, në nëntokë”, ndryshuar me Udhëzimet: nr.1/1, datë 20.03.2001 dhe nr.1/2, datë 06.06.2001, ku janë përcaktuar emërtimet e dokumenteve, procedimi i kërkesës si dhe procedurat administrative që do të ndiqen.

Në udhëzimin nr.1, datë 16.01.2001 “Për zbatimin e VKM “Për kriteret dhe masën e trajtimit të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në minierë, në nëntokë”, i ndryshuar, përcaktohet se procedurat të cilat do të ndiqen për caktimin, administrimin dhe pagimin e këtij trajtimi të vecantë do të jenë ato të parashikuara në Rregulloren nr.25, datë 03.09.1999, “Për caktimin dhe administrimin e përfitimeve suplementare të ushtarakëve”, për pensionet e parakohshme për vjetërsi shërbimi. Kjo për arsye se, financimi i këtij lloj trajtimi të vecantë është totalisht buxhetor dhe i së njëjtës natyrë me atë të ushtarakëve.

Strukturat drejtuese në ISSH kanë realizuar detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i VKM nr.73, datë 15.02.2001 “Për kriteret dhe masën e trajtimit të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në minierë, në nëntokë” e dalë në zbatim të Ligjit nr.8685, datë 09.11.2000 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në minierë, në nëntokë”, në lidhje me hartimin dhe miratimin e dokumentacionit që autorizon dhe vërteton pagesën e përfitimeve.

Ligji nr.9356, datë 17.03.2005 “Për disa shtesa e ndryshime në Ligjin nr.8685, datë 09.11.2000

“Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në minierë, në nëntokë”, nënenin 6/1, shprehimisht citon:

“Personi që ka përfituar të ardhura në mënyrë e me mjete të padrejta, detyrohet të kthejë të gjithë shumën e marrë tepër”.

Nga auditimi rezulton se, Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka kryer periodikisht kontrole të dosjeve të përfituesve të Ligjit nr.8685, datë 09.11.2000 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në minierë, në nëntokë”, të ndryshuar.

Për periudhën 2002-2010, nga informacioni i administruar në ISSH, ka rezultuar se kontrollet dhe inspektimet janë realizuar nga Drejtoria e Trajtimeve të Vecanta dhe Suplementare dhe nga Drejtoria e Auditimit të Përfitimeve, pjesë e DAB. Nga informacioni i disponuar grupit të auditimit theksohet se kontrollet e kësaj periudhe kanë identifikuar problematika në drejtim të dokumentacionit të paraqitur për përfitim trajtimi të vecantë, nga vetë personat ose nga ndërmarjet sipas përcaktimeve të VKM nr.73, datë 15.02.2001. Në shumë raste ky dokumentacion, krahasuar me regjistrat, ose kryqëzuar me historikun e punës së personave, ka rezultuar i tjetërsuar ose ka patur raste të fallsifikimit të të dhënave. Këto problematika të konstatuara, kanë qenë pikënisja e ndërmarjes së një kontrolli të plotë nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithëshme të ISSH për të gjithë përfitimet e caktuara, sidomos atyre të pas vitit 1997 dhe në veçanti për ish minatorët me trajtim të veçantë financiar. Gjatë kësaj periudhe kontrollet rezultojnë të jenë kryer me grupe të veçanta auditi. Gjithashtu trajtimet e veçanta, kanë qenë objekt kontrolli dhe certifikimi, pavarësisht nga kontrollet e ushtruara mbi bazë risku, kjo me arsyen se, dokumentacioni i grumbulluar nga arkivat e shtetit në arkivat e ISSH ka qenë mjaft voluminoz, përfshinte një periudhë të gjatë kohore (1945-1993), si dhe kishte një numër shumë të lartë rekordesh që kanë kaluar në proces dixhitalizimi, për të mundësuar kontrollin dhe ballafaqimin e të dhënave. Për realizimin e procesit të kontrollit grupet e kontrollit, si bazë të dhënash kanë marrë kërkesat e dorëzuara nga personat e interesuar për trajtim të vecantë, ndërsa kontrolli është bazuar në ligjshmërinë e caktimit të pensioneve suplementare dhe trajtimeve të veçanta për cdo drejtori rajonale duke i'u referuar dosjes individuale të paraqitur nga cdo minator.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Për periudhën 2002-2011, grupit të auditimit nuk i'u vunë në dispozicion të dhëna të plota statistikore në lidhje me: numrin e dosjeve të audituara gjithsej, numrin e debitorëve për arsye të mosplotësisimit të kushteve për përfitim, shumën totale të debisë së krijuar, numrin e personave që kanë përfituar të ardhura, në formën e trajtimit të vecantë, në mënyrë e me mjete të padrejta si dhe shumën totale të përfituar prej tyre.

Grupi i auditimit, gjatë kohës së ushtrimit të auditimit në ISSH, kërkoi informacion në lidhje me identifikimin nga ana e ISSH-së të numrit të personave si dhe shumës së përfituar prej tyre në mënyrë e me mjete të padrejta. Informacioni i dhënë grupit të auditimit konsiston në 5,527 dosje të inspektuara prej të cilave 1,658 të pezulluara paraprakisht në 22 raporte inspektimi.

Strukturat përgjegjëse në ISSH, për periudhën 2005 e në vazhdim, nuk kanë respektuar kërkesat e nenit 6/1 të Ligjit nr.9356, datë 17.03.2005 “Për disa shtesa e ndryshime në Ligjin nr.8685, datë 09.11.2000 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në minierë, në nëntokë”, ku shprehimisht citohet:

“Personi që ka përfituar të ardhura në mënyrë e me mjete të padrejta, detyrohet të kthejë të gjithë shumën e marrë tepër”.

Ligji nr.9706, datë 05.04.2007, “Për një shtesë në Ligjin nr.8685, datë 09.11.2000 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në minierë, në nëntokë”, të ndryshuar, në nenin 1 përcakton shprehimisht se:

“Pagesa e trajtimit të veçantë ndërpritet për aq kohë sa personi përfiton të ardhura nga veprimtaria ekonomike si i punësuar ose i vetëpunësuar....”

Nga përpunimi i bazës së të dhënave të sistemit elektronik të pensioneve PCAMS, në datë 25.11.2019, rezulton se, për 37 persona përfitues është ndërprerë trajtimi i vecantë për arsye të punësisimit/vetëpunësisimit.

Grupi i auditimit, gjatë kohës së ushtrimit të auditimit në ISSH, kërkoi informacion nëse këta 37 persona, në momentin e ndërprerjes së trajtimit të vecantë, për arsye të punësisimit/vetëpunësisimit, kanë rezultuar ose jo debitorë dhe nëse po, sa ka qenë shuma respektive.

Deri në përfundim të auditimit, grupit të auditimit nuk i'u vu në dispozicion ky informacion.

Konstatimi i grupit të auditimit në projektraportin e auditimit, bazuar në informacionin e gjeneruar nga sistemi i pensioneve PCAMS në datë 25.11.2019:

Në sistemin informatik të pensioneve PCAMS nuk evidentohet shuma e debisë për 37 personat përfitues të Ligjit nr.8685, datë 09.11.2000, të cilëve u është ndërprerë trajtimi i vecantë për arsye të punësisimit.

Sqarimet e paraqitur nga ISSH, me shkresën nr.7719/3, prot, datë 23.12.2019, protokolluar në KLSH me nr.919/3, datë 24.12.2019:

Në shkresën e sipërcituar, ndërmjet të tjerash, theksohet specifikisht:

“Në lidhje me 37 personat që kanë filluar punë ose janë vetëpunësuar sqarojmë se 16 nga ish përfituesit kanë ndërprerë punën dhe nuk janë debitorë se kanë deklaruar dhe nuk kanë tërhequr trajtimin, 1 rast është hequr debia me vendim gjykate, 1 përfitues e ka shlyer debinë prej një muaj pagesë. 2 persona janë në procese hetimi dhe gjyqësore, 7 persona po ju vilet debia në pensionin e pleqërisë dhe invaliditetit si dhe 10 persona priten të futen në skemë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

pasi nuk përfitojnë asnjë pagesë nga sigurimet shoqërore”.

Trajtimi nga grupi i auditimit i sqarimeve të paraqitura nga ISSH:

Grupi i auditimit vlerëson analizën e bërë për 37 personat të cilëve u është ndërprerë TVM për arsye të punësimit, por mbetet i painformuar në lidhje me politikat e ISSH në drejtim të arkëtimit të shumës 5,741,200 lekë, e cila përfaqëson debinë e 10 personave të cilët aktualisht nuk janë pjesë e asnjë skeme pensioni.

Përfundimi:

Grupi i auditimit në raportin përfundimtar të auditimit referuar informacionit shtesë të paraqitur nga ISSH, riformulon gjetjen si vijon:

10 nga 37 përfitues (punonjës që kanë punuar në miniera, në nëntokë), ose 27% e atyre që u është ndërprerë TVM për shkak të punësimit, rezultojnë debitorë në shumën 5,741,200 lekë dhe aktualisht janë në kushtet e pamundësisë së shlyerjes së debisë, pasi aktualisht nuk janë pjesë e asnjë skeme pensioni.

II. Ligji nr.150/2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, ka për qëllim rregullimin e pensioneve të pleqërisë për punonjësit që kanë punuar në miniera në nëntokë me, moshë, vjetërsi të përgjithshme dhe vjetërsi punë në profesion, më të vogël se ato të përcaktuara në Ligjin nr.7703, datë 11.05.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Të drejtën e përfitimit të pensionit të pleqërisë si punonjës të minierave në nëntokë, sipas këtij ligji, e kanë ata persona që arrijnë moshën 55 vjet dhe kanë një periudhë të përgjithshme sigurimi 30 vjet e më shumë, nga të cilat, jo më pak se 12 vjet e 6 muaj në proces pune në miniera në nëntokë. Nga ky ligj përjashtohen ish punonjësit e nëntokës të cilët kanë përfituar trajtim të vecantë financiar, sipas Ligjit nr.8685, datë 09.11.2000 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në minierë, në nëntokë”, të ndryshuar, të cilët do të bëhen pjesë e skemës së këtij ligji kur të arrijnë moshën 55 vjet dhe të kenë një periudhë të përgjithshme sigurimi 30 vjet e më shumë, përfshirë këtu edhe periudhën e trajtimit të vecantë financiar, nga të cilat, jo më pak se 11 vjet e 6 muaj të jenë në procese pune në miniera, në nëntokë.

Në nenin 5 të këtij ligji, citohet:

“Personi i cili ka përfituar pension në mënyrë e me mjete në kundërshtim me ligjin, përveçse detyrohet ta kthejë atë, dënohet me gjobë në masën sa katërfishi i dëmit të shkaktuar”.

Në zbatim të këtij ligji, kontrollet/inspektimet janë kryer nga Njësia e Inspektimit të Përfitimeve, strukturë kjo e miratuar me Vendimin e Këshillit Administrativ nr.6, datë 20.07.2010, e cila nga 1 sektor me 5 punonjës sot është shndëruar në një Njësi me 1 kryetar dhe 2 sektorë, me 19 punonjës në total, nga të cilat; Sektori i Inspektimit të Përfitimeve Afatgjata me 16 punonjës dhe Sektori i Inspektimit të Përfitimeve Suplementare dhe Trajttimeve me 3 punonjës.

Njësia e Inspektimit të Përfitimeve ushtron funksionet në zbatim të Rregullores për Organizimin e Detyrave Funksionale në Drejtorinë e Përgjithshme të ISSH-së, si dhe në zbatim të Rregullores nr.1/2, datë 04.03.2011 “Për një shtesë në Rregulloren nr.1, datë 21.10.2008 “Për caktimin, administrimin dhe pagesën e pensioneve”, e ndryshuar.

Grupi i auditimit konstaton se:

➤ Rregullorja për Organizimin e Detyrave Funksionale në Drejtorinë e Përgjithshme të ISSH –së nuk rezulton të jetë miratuar nga Këshilli Administrativ por vetëm nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm, i cili me Urdhërin nr.2115, datë 15.03.2018 e ka përcjellë këtë rregullore tek strukturat përgjegjëse të ISSH-së. Kjo detyrë është lënë rekomandim nga auditimi i mëparshëm, i KLSH-së dhe aktualisht rezulton e përealizuar;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

➤ Në Rregulloren për Organizimin e Detyrave Funktionale në Drejtorinë e Përgjithshme të ISSH –së, në kapitullin VIII “Njësia e Inspektimit të Përfitimeve”, në të cilën përshkruhen detyrat specifike të kësaj njësie ka mospërputhje në emërtime. Më konkretisht: struktura emërtohet “Njësia e Inspektimit të Përfitimeve”, me dy sektorë: Sektori i Inspektimit të Përfitimeve Afatgjata dhe Sektori i Inspektimit të Përfitimeve Suplementare dhe Trajtimeve dhe inspektorët emërtohen “Inspektorë të Njesisë së Kontrollit të Ligjshmërisë së Përfitimeve”;

➤ Në Rregulloren nr.1/2, datë 04.03.2011 “Për një shtesë në Rregulloren nr.1, datë 21.10.2008 “Për caktimin, administrimin dhe pagesën e pensioneve”, e ndryshuar, e emërtuar projekt rregullore për Njësinë e Inspektimit të Përfitimeve, detyrat dhe procedurat i ngarkohen për zbatim Njesisë së Kontrollit të Ligjshmërisë (njësi kjo që nuk është pjesë e strukturës organizative të ISSH në këtë periudhë), dhe jo Njesisë së Inspektimit të Përfitimeve, sipas emërtimeve të strukturës së miratuar.

➤ Në përfundim të kontroleve të ushtruara, në asnjë rast, ISSH nuk rezulton të ketë aplikuar gjobë ndaj personave të cilët kanë përfituar pension në mënyrë e me mjete në kundërshtim me ligjin, veprim ky në kundërshtim me përcaktimet e nenit 5 të Ligjit nr.150/2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”.

➤ E drejta e vendosjes së gjobës, si detyrim që rrjedh nga zbatimi i Ligjit nr.150/2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, nuk është përcaktuar si detyrë specifike e strukturës përgjegjëse as në Rregulloren për Organizimin e Detyrave Funktionale në Drejtorinë e Përgjithshme të ISSH–së, datë 15.03.2018 dhe as në projekt rregulloren për Njësinë e Inspektimit të Përfitimeve datë 04.03.2011.

Ligji nr.150/2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, në nenin 7 të tij, përcakton se, pensioni jepet me kërkesën e të interesuarit, i cili e paraqet atë pranë agjencisë së sigurimeve shoqërore të vendbanimit të tij.

Nga auditimi rezulton se, pranë agjencive të sigurimeve shoqërore në të gjithë vendin, nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji e deri në momentin e auditimit janë administruar manualisht nga DRSSH 5,758 kërkesa për përfitim pensioni që rrjedhin nga zbatimi i Ligjit 150/2014.

Në datë 25.11. 2019, rezultojnë përfitues në sistemin informatik të ISSH –së, 4,168 persona. Diferenca 1,590 përfaqëson kërkesa të administruara por të pacertifikuara, që do të thotë nuk plotësonin kushtet për të përfituar nga ky ligj.

Në nenin 9, të po këtij ligji përcaktohet se, personat përfitues të trajtimit të vecantë financiar, sipas Ligjit nr.8685, datë 09.11.2000, të ndryshuar, por që plotësojnë kushtet e këtij ligji, kanë të drejtë të zgjedhin mes përfitimit që kanë dhe përfitimit që lind nga ky ligj.

Në projektraportin e auditimit, grupi i auditimit i’u referuar të dhënave të sistemit informatik të sigurimeve shoqërore, të gjeneruara në datë 25.11.2019, nga ku rezultuan se, 2,237 persona, të cilët deri në momentin e hyrjes në fuqi të Ligjit nr.150/2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, ishin përfitues të trajtimit të vecantë, në zbatim të Ligjit nr.8685, datë 09.11.2000 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në minierë, në nëntokë”, me hyrjen në fuqi të Ligjit nr.150/2014, zgjedhën të jenë pjesë e skemës përfituese të këtij ligji.

Nga 4,168 përfitues që rezultojnë në sistemin informatik të pensioneve PCAMS, të ISSH–së, në datë 25.11.2019, vetëm 3,177 janë përfitues aktiv të skemës. Diferenca prej 991 përfituesish, përfaqëson numrin e përfituesve, dosjet e të cilëve kanë rezultuar me problem nga verifikimi dhe janë mbyllur.

Në informacionin e gjeneruar në datë 18.12.2019, sqarohet se nuk janë 2,237 por 3,214 përfitues që kanë kaluar nga TVM në përfitim sipas Ligjit 150/2014.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Konstatimi i grupit të auditimit në projektraportin e auditimit:

Grupi i auditimit në projektraportin e auditimit, bazuar në informacionin e administruar gjatë ushtrimit të auditimit, ngarkoi me përgjegjësi strukturat përgjegjëse në ISSH, për periudhën 2015 e në vazhdim, për mospërfshirjen në rregullorret e sipërcituara të së drejtës që ka struktura përgjegjëse për aplikimin e gjobës, si dhe për mosaplikim të gjobës ndaj personave të cilët kanë përfituar pension në mënyrë e me mjete në kundërshtim me ligjin.

Sqarimet e paraqitura nga ISSH, me shkresën nr.7719/3, prot, datë 23.12.2019, protokolluar në KLSH me nr.919/3, datë 24.12.2019:

Në shkresën e sipërcituar, ndërmjet të tjerash, theksohet specifikisht:

“Sa i përket ceshtjeve të ngarkimit të përfituesit me 4 fishin e detyrimit në rast të konstatimit dhe konsiderimit të një falsifikimi, evidentojmë se nga analizat e sjella nga njësia e inspektimit, në asnjë rast tëpërfitimeve nga ligji 150, nuk kemi të bëjmë me një falsifikim të kryer në zbatim të kërkesave të këtij ligji. Njësia ka pezulluar përfitimin, por shuma e përfitimit të referon në faktin se ato janë problematika që vijnë nga përfitimi i trajtimit të veçantë. Në asnjë rast nuk ndeshemi me falsifikim të dokumentave të kryera për shkak të përfitimeve nga ky ligj, ligji 150/2014. Ato janë përfitime të transferuara. Duke qenë se tashmë është krijuar një bazë e plotë e të dhënave, ISSH ka kontrolluar edhe më mirë përfitimet. Nga drejtori është përcaktuar standarti “çdo përfitim i ri ose i shtuar, kontrollohet” dhe në këtë proces ka pasur konstatime të tjerë, pezullime të tjerë, të cilat drejtoritë rajonale i kanë mbyllur dhe financat e rajoneve i kanë evidentuar si debitor”.

Trajtimi nga grupi i auditimit i sqarimeve të paraqitura nga ISSH:

Grupi i auditimit pranon sqarimet e paraqitura për këtë ceshtje dhe nuk i ngarkon me përgjegjësi strukturat përgjegjëse të inspektimit, për mosvendosje gjobe.

Përfundimi:

Grupi i auditimit lë si rekomandim përfshirjen në rregulloret e ISSH të së drejtës së vendosjes së gjobës, si detyrim që rrjedh nga zbatimi i Ligjit nr.150/2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”.

Në zbatim të Ligjit nr.150/2014, ka dalë VKM nr.78, datë 28.01.2015, “Për zbatimin e Ligjit nr.150/2014, datë 06.11.2014 “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, në të cilën përcaktohet se, për personat që, deri në datën e hyrjes në fuqi të Ligjit nr.150/2014, datë 06.11.2014, përfitonin trajtimin e vecantë financiar, sipas Ligjit nr.8685, datë 09.11.2000, të ndryshuar, do të konsiderohet periudhë sigurimi në proces pune në nëntokë, periudha që është njohur dhe miratuar, si periudhë pune në nëntokë në vendimin e caktimit të trajtimit të vecantë dhe do të konsiderohet periudhë sigurimi e vlerësuar me pagë minimale e gjithë periudha nga data e fillimit të trajtimit të vecantë financiar e deri në datën e fillimit të pensionit.

Në pikën 1, të kreut III, të VKM nr.78, datë 28.01.2015 përcaktohet shprehimisht:

“Procedurat e aplikimit, dokumentacioni i kërkuar si dhe procedura e caktimit, administrimit dhe pagesës së pensioneve përcaktohen me rregullore të ISSH.

VKM nr.78, datë 28.01. 2015, në pikën 2 të kreut IV, ngarkon ISSH për nxjerrjen e rregullores përkatëse.

Nga auditimi rezulton se, për zbatimin e kërkesave të VKM nr.78, datë 28.01.2015, ISSH nuk ka hartuar ndonjë rregullore specifike, por i është referuar Rregullores nr.1, datë 21.10.2008 “Për caktimin, administrimin dhe pagesën e pensioneve”, të hartuar, në mbështetje të nenit 74, të Ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” dhe të miratuar nga Këshilli Administrativ.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Në këtë rregullore janë përcaktuar të gjitha hapat që ndjek procesi, duke filluar me paraqitjen e kërkesës për pension (formulari tip i së cilës gjendet bashkëlidhur kësaj rregulloreje); dokumentet që nevojiten për të përfituar pension; rregullat dhe procedurat për verifikimin e dokumenteve për pension; rregullat dhe procedurat për marrjen e vendimit për caktimin e pensionit; ndarja e pensioneve në kategori, regjistrimi i vendimit dhe krijimi i dosjes personale të pensionit; kartela financiare e pensionit dhe urdhërpagesa; librezat e pensionit; rregullat dhe procedurat për ndryshimin, pezullimin dhe mbylljen e pensionit; rregullat dhe procedurat për pagesën e pensionit si dhe përgjegjësitë për moszbatimin e kësaj rregulloreje.

VKM nr.78, datë 28.01.2015, në pikën 6 të kreut III, përcakton se përfitimet sipas Ligjit nr.150/2014, datë 06.11.2014, janë objekt auditimi nga strukturat përkatëse të ISSH.

Strukturë përgjegjëse për auditimin e përfitimeve në zbatim të Ligjit nr.150/2014, rezultojnë të jetë Njësia e Inspektimit të Përfitimeve, strukturë kjo e miratuar me Vendimin e Këshillit Administrativ nr.6, datë 20.07.2010.

Gjatë ushtrimit të funksioneve të saj, për periudhën pas hyrjes në fuqi të Ligjit 150/2014, kjo strukturë ka kryer në total 23 inspektime në 12 degë rajonale. Nga ky proces janë inspektuar në total 3,782 dosje minatorësh përfitues, nga të cilat: certifikuar të rregullta 3,576 dosje, pezulluar 48 dosje dhelënë detyrë për plotësim për 158 dosje. Efekti total i debisë për dosjet e inspektuara nga kjo strukturë arrin në shumën 56,513,530 lekë.

Strukturat përgjegjëse në ISSH, për periudhën 2015 e në vazhdim, rezultojnë të kenë zbatuar detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i VKM nr.78, datë 28.01.2015, “Për zbatimin e Ligjit nr.150/2014, datë 06.11.2014 “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, në lidhje me hartimin dhe miratimin e rregullores për përcaktimin e administrimit dhe pagesës së pensioneve, si dhe kanë audituar rregullisht përfitimet e Ligjit nr.150/2014.

Për vërtetësinë e përfitimeve të identifikuara si të padrejta ISSH rezultojnë të ketë ndjekur rrugën ligjore.

Nga informacioni i disponuar grupit të auditimit rezultojnë se:

a) Në harkun kohor të viteve 2000-2012 kanë përfunduar 418 procese gjyqësore në favor të përfituesve, duke sjellë për pasojë rikthimin e tyre në skemën e pensioneve;

b) Në harkun kohor të viteve 2013-2018, janë hapur gjithësej 610 procese gjyqësore, në 13 rajone të vendit. Nga 610 procese të hapura: 434 procese, ose 71.4% e tyre janë humbur nga ISSH dhe 176 procese, ose 28.6% e tyre janë fituar nga ISSH.

c) Përgjatë vitit 2019, janë hapur gjithësej 195 procese gjyqësore, në 14 rajone të vendit. Nga 195 procese të hapura: 28 procese, ose 14.4% e tyre janë humbur nga ISSH, 26 procese, ose 13.3% e tyre janë fituar nga ISSH dhe 141 çështje, ose 72.3% e çështjeve janë në proces gjykimi.

Konstatim: Mbi 70% e proceseve gjyqësore në harkun kohor 2013-2018 janë humbur nga ISSH, ndërkohë që për vitin 2019, ende nuk ka rezultate përfundimtare pasi 72.3% e çështjeve janë në proces gjykimi.

Në total, për vitet 2000-2019, ISSH rezultojnë të ketë humbur 880 procese gjyqësore, që do të thotë: 880 përfitues, të identifikuar si përfitime të padrejta, i janë rikthyer skemës së përfitimit të pensionit, ndërkohë që ende 141 çështje të hapura gjatë vitit 2019 janë ende në proces shqyrtimi.

Në lidhje me debitorët e krijuar ndër vite, nga informacioni i administruar nga Drejtoria e Financës, rezultojnë këto të dhëna:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Gjendja e debitorëve minatorë për periudhën 2008-2014.

Tabela nr.1
Në lekë

Periudha	Nr i debitorëve	Gjendja e debisë në fillim	Shtuar	Pakësuar	Gjendja e mbetur në fund të vitit
2008-2014	1095	459,780,482	289,372,340	231,371,461	517,781,361

Burimi: Drejtoria e Financës në ISSH

Gjendja e debitorëve minatorë për periudhën 01.01.2015-31.10.2019.

Tabela nr.2
Në lekë

Periudha	Nr i debitorëve në fillim të viteve	Gjendja e debisë në fillim	Shtuar	Pakësuar	Gjendja e mbetur në fund të vitit
Viti 2015	1351	517,781,361	147,876,175	136,301,577	529,355,959
Viti 2016	1310	529,355,959	149,146,227	30,357,296	648,144,890
Viti 2017	1388	648,144,890	21,727,640	97,760,869	572,111,661
Viti 2018	1245	572,111,661	34,287,992	120,039,908	486,359,745
01.01.2019-31.10.2019	903	486,359,745	93,964,214	93,338,635	486,985,324

Burimi: Drejtoria e Financës në ISSH

Për periudhën 01.01.2008-31.10.2019 debia është shtuar, në total, në shumën 736,374,588 lekë dhe është pakësuar në shumën totale prej 709,169,746 lekë, që do të thotë që 96.3% e debisë totale të arkëtuar nga përfituesit debitorë është rikthyer me vendim gjykatë.

Konstatim: Për periudhën 01.01.2008-31.10.2019, ISSH ka paguar për proceset gjyqësore të humbura kundrejt minatorëve përfitues të skemës së Ligjit nr.8685/2000 dhe Ligjit nr.150/2014, në total 709,169,746 lekë, ose 96.3% të debisë totale të arkëtuar.

Gjendja e debitorëve minatorë deri në datë 31.10.2019, sipas Agjencive Rajonale

Tabela nr.3
Në lekë

Nr	Agjencitë Rajonale	Nr i debitorëve minatorë deri në datë 31.10.2019	Gjendja e debitorëve deri në datë 31.10.2019
1	Berat	0	-
2	Dibër	225	146,988,800
3	Durrës	5	1,904,995
4	Elbasan	14	6,432,422
5	Fier	8	7,791,513
6	Gjirokastër	2	407,362
7	Korcë	96	74,594,360
8	Kukës	103	50,076,153
9	Lezhë	41	18,866,217
10	Shkodër	20	8,411,487
11	Tiranë	250	169,131,739
12	Vlorë	6	2,380,276
	Totali	770	486,985,324

Burimi: Drejtoria e Financës në ISSH

Konstatimi i grupit të auditimit në projektraportin e auditimit, bazuar në informacionin e gjeneruar nga sistemi i pensioneve PCAMS në datë 25.11.2019:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Ndonëse në ISSH funksionon sistemi elektronik i pensioneve PCAMS që prej vitit 2012, ende sot, në vitin 2019, të dhënat statistikore, për debitorët, gjenerohen në mënyrë manuale nga DRSSH dhe përpunohen po manualisht nga drejtoria e financës në ISSH, pasi sistemi elektronik i pensioneve PCAMS nuk është i lidhur me sistemin e financës FMS (Financial Management Sistem), duke sjellë pasaktësi në raportime.

Sqarimet e paraqitur nga ISSH, me shkresën nr.7719/3, prot, datë 23.12.2019, protokolluar në KLSH me nr.919/3, datë 24.12.2019:

Në shkresën e sipërcituar, ndërmjet të tjerash, theksohet specifikisht:

“Në procesin e kontrollit, përfundimisht nga viti 2007 e deri në vitin 2019 janë evidentuar debitor për shkak të mbylljes përfundimisht të përfitimit ose pezullimit të tij dhe kalimit në proces ligjor, 1110 raste nga të cilat 944 raste nga TMV dhe 158 raste nga 150/2014. Nga këto janë shlyer, evaduar edhe me vendime gjyqësore në periudhën 2010- 2019, 336 raste dhe përfundimisht me 31.10.2019 rezultojnë debitorë 774 raste me shumë debie 487,931,873 lekë. Nga këto janë në proces arkëtimi 116 raste, janë në proces gjyqësor 141 raste (përfitime të pezulluara, të ngarkuara si debitorë, por në proces gjykimi) janë në proces shqyrtimi në organet e prokurorisë 231 raste”.

Trajtimi nga grupi i auditimit i sqarimeve të paraqitura nga ISSH:

Grupi i auditimit nga shqyrtimi i sqarimeve të paraqitura thekson edhe njëherë pasaktësitë në statistikën e prodhuara, si në drejtim të numrit të debitorëve ashtu edhe të shumës së debisë. Gjatë auditimit Drejtoria e Financës raportoi zyrtarisht 770 debitorë me shumë totale debie 486,985,324 lekë, ndërkohë që në sqarimet e paraqitura më sipër bëhet fjalë për 774 debitorë me shumë totale debie 487,931,873 lekë, fakt ky i pranuar nga ISSH. Nga analiza që ju paraqisni në lidhje me debitorët, sqaroni statusin për 488 persona debitorë, ndërkohë që për 286 persona të tjerë nuk jepni sqarime, gjithashtu nuk shpjegoni se përse 64 persona debitorë në shumën 36,561,410 lekë nuk shlyejnë debinë edhe pse janë futur në skemë në periudhën 2013-2019.

Në projektraportin e auditimit debitorët janë trajtuar në kuadër të të dhënave statistikore, por referuar mangësive të shfaqura në analizën që ju paraqitet, grupi i auditimit është i mendimit ta paraqesë si gjetje dhe të lërë rekomandimin përkatës

Përfundimi:

Grupi i auditimit në raportin final të auditimit referuar informacionit shtesë të paraqitur nga ISSH, formulon gjetjen si vijon:

- 658 nga 774 debitorë, ose 85% e numrit të përgjithshëm të debitorëve nuk janë në proces arkëtimi dhe shuma e debisë që ata përfaqësojnë (436,067,017 lekë) zë 89% të shumës totale të debisë.
- 64 persona debitorë në shumën 36,561,410 lekë, ose 9,7% e tyre nuk shlyejnë debinë edhe pse rezultojnë të jenë pjesë e skemës së përfitimeve nga viti 2013 deri në vitin 2019.

Pasqyra e detajimit të fondeve buxhetore për përbalimin e trajtimit të veçantë të minatorëve për të dy skemat e trajtimeve (Ligji nr.8685/2000; Ligji nr.150/2014), për periudhën 2003-2018, paraqitet si vijon:

Tabela nr.4
Në mijë lekë

Nr	Vitet	Numri i përfituesve në fund të viteve	Plan	Fakt
1	2003	5,549	482,763	484,517
2	2004	5,554	438,000	423,475



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

3	2005	5,435	431,491	420,939
4	2006	5,356	442,134	426,158
5	2007	4,853	407,729	391,221
6	2008	3,842	392,000	325,584
7	2009	3,701	355,274	364,937
8	2010	3,753	465,954	404,968
9	2011	3,770	407,145	430,075
10	2012	3,698	456,015	439,839
11	2013	3,620	436,029	435,006
12	2014	3,535	466,632	441,223
13	2015	2,989	566,807	521,732
14	2016	3,011	623,000	581,719
15	2017	3,079	555,107	403,222
16	2018	3,539	556,885	235,822
Totali			7,482,965	6,730,437

Burimi: Drejtoria e Financës në ISSH

Sipas informacionit të administruar nga drejtoria e financës në ISSH, rezulton:

- Mospërputhje midis numrit fillestar të kërkesave, 5,527 kërkesa, të rregjistruara në DRSSH, të cilat fillimisht u përkthyer të gjitha në numër përfitimesh, paraqitur grupit të auditimit nga strukturat e auditimit dhe certifikimit në ISSH me të dhënat e ofruara nga drejtoria e financës në ISSH ku, për vitin 2003 ky numër paraqitet 5,549 përfitues dhe për vitin 2004, rritet në 5,554 përfitues.

- Për periudhën 2003-2018, përfitimet, nga skemat e trajtimeve, për kategorinë e minatorëve të nëntokës (Ligji nr.8685/2000; Ligji nr.150/2014), i kanë kushtuar buxhetit të shtetit, në total, 6,730,437,000 lekë.

Grupi i auditimit verifikoi të dhënat e sistemit të thesarit të qeverisjes së përgjithshme, për vitin buxhetor 2018, nga ku rezultoi se: për vitin 2018, ISSH ka përfituar transfertë për pagesat e parakohshme për minatorët në shumën totale 663,702,830 lekë, ndërkohë që, në informacionin e dhënë grupit të auditimit, nga drejtoria e financës në ISSH, shuma e shpenzimeve faktike për vitin 2018, për këtë kategori, rezulton të jetë 235,822,000 lekë, ose 427,880,830 lekë më pak se tranferta buxhetore e këtij viti.

Referuar verifikimit të mësipërm, shuma faktike e shpenzimeve buxhetore, për periudhën 2003-2018, prej 6,730,437,000 lekë, e paraqitur nga drejtoria e financës, nuk është e saktë.

-Referuar viteve 2017-2018, rezulton se në fund të vitit 2018 numri i përfituesve është rritur me 460 përfitues, në raport me vitin 2017, ndërkohë që shpenzimet faktike në vitin 2018 janë ulur me 167,400,000 lekë, ose në masën 58.5%, krahasuar me vitin 2017. Në takimin ballafaques, përfaqësuesit e ISSH-së shpjeguan se, në vitin 2018 shpenzimet faktike për përfituesit e Ligjit 150/2014 janë raportuar sëbashku me shpenzimet faktike të përfituesve të Ligjit 7703/1993, i ndryshuar, duke sjellë mosrakordim me transfertënbuxhetore për pagesat e parakohshme për minatorët në shumën 427,880,830 lekë. Për shumën 427,880,830 lekë ishin të ngarkuara më tepër pensionet e pleqërisë, duke cilruar padrejtësisht pensionet nga Ligji 150/2014.

Në vijim të fakteve të parashtruara, informacioni i marrë nga drejtoria e financës në lidhje me numrin e përfituesve, për kategorinë e minatorëve të nëntokës (Ligji nr.8685/2000; Ligji



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

nr.150/2014) dhe shuma faktike e shpenzimevebuxhetore, për periudhën 2003-2018, paraqitet i pasaktë.

Konstatim

Strukturat drejtuese në ISSH kanë realizuar detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i VKM nr.73, datë 15.02.2001 “Për kriteret dhe masën e trajtimit të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në minierë, në nëntokë” e dalë në zbatim të Ligjit nr.8685, datë 09.11.2000 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në minierë, në nëntokë”, në lidhje me hartimin dhe miratimin e dokumentacionit që autorizon dhe vërteton pagesën e përfitimeve, por paraqesin pasaktësi në statistikat e prodhuara.

Përgjegjësi për pasaktësitë në lidhje me, raportimin e numrit të përfituesve, për kategorinë e minatorëve të nëntokës (Ligji nr.8685/2000; Ligji nr.150/2014); shumën faktike të shpenzimeve buxhetore, për periudhën 2003-2018, si dheparaqitjen në kontabilitet të shumës faktike të transfertës buxhetore për pagesat e parakohshme për minatorët e nëntokës, për vitin 2018 e mbajnë z. [REDAKTUAR] me detyrë Zv/Drejtori i Përgjithshëm dhe znj. [REDAKTUAR], me detyrë Drejtore e Financës.

Konstatimi i grupit të auditimit në projektraportin e auditimit, bazuar në informacionin e gjeneruar nga sistemi i pensioneve PCAMS në datë 25.11.2019:

Pasaktësi në raportimet e Drejtorisë së Financës në drejtim të numrit të përfituesve dhe shumës faktike të transfertës buxhetore, për kategorinë e minatorëve të nëntokës.

Sqarimet e paraqitura nga ISSH, me shkresën nr.7719/3, prot, datë 23.12.2019, protokolluar në KLSH me nr.919/3, datë 24.12.2019:

Në shkresën e sipërcituar, ndërmjet të tjerash, theksohet specifikisht:

“Sa i përket çështjes së deformimit lidhur me evidentimin e shpenzimeveinformojmë se nëpër këtë zë të ri shpenzimesh, për arsye fondesh në projekt informatik të vitit 2010 PCAMS nuk është bërë një zhvillim i veçantë evidentimi të shpenzimeve faktike sipas artikullit. Kjo ka sjellë si pasojë që shpenzimet të ngarkohen në zërin pensione pleqërie dhe stornimi i tyre të bëhet në mënyrë empirike dhe me gabime. Programimi i fondeve për mbulimin e pagesave është zë i veçantë, por është i evidentuar ne vehte në planifikim dhe kontabilitet. Në vitin 2018 nuk është bërë kontrolli i plotë për evidentimin në këtë zënë momentin e mbylljes së raportit fiskal, datë 15 janar si dhe të mbylljes së bilancit financiar. Problematika është konstatuar me vonesë”.

Trajtimi nga grupi i auditimit i sqarimeve të paraqitura nga ISSH:

Grupi i auditimit pas shqyrtimit të sqarimeve të paraqitura dhe pranimit nga vetë ISSH të faktit qëdeformimi lidhur me evidentimin e shpenzimeve kanë ardhur si rezultat i moskontrollit të plotë të evidentimit të shpenzimeve për vitin 2018 si dhe moszhvillimit të veçantë në sistem të shpenzimeve faktike sipas artikullit, thekson edhe njëherëdomosdoshmërinë e zhvillimit tësistemit elektronik të pensioneve PCAMS duke e ndërlidhur atë me sistemin e financës FMS.

Përfundimi:

Grupi i auditimit në raportin final të auditimit lë të njëjtën gjetje dhe rekomandim në lidhje me këtë çështje si në projektraportin e auditimit.

Në pasqyrat financiare të vitit 2018, dërguar në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë me nr.2285 prot, datë 26.03.2019, në klasën 4, në zërin “Të tjera kërkesa debitorë”, debitorët në



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

organet e sigurimeve shoqërore, për vitin ushtrimor 2018 paraqiten në shumën 7,543,983,113.92 lekë, nga 6,742,028,913.65 lekë që rezultojnë në vitin 2017. Nga viti 2017 në vitin 2018 debitorët janë shtuar në shumën 801,954,200.27 lekë. Në relacionin shoqërues të pasqyrave financiare sqarohet se shuma debitorësh prej 7,543,983,113.92 lekë, përfaqëson debitorë nga kontributet në shumën 1,560,339,000 lekë dhe debitorë nga përfitimet në shumën 5,893,644,000 lekë. Nga të dhënat statistikore, të marra nga drejtoria e financës, gjendja e mbetur e minatorëve debitorë, në fund të vitit 2018 rezulton të jetë 486,359,745 lekë, nga 5,893,644,000 lekë që është shuma totale e debitorëve nga përfitimet, ndërkohë që në relacionin shoqërues të pasqyrave financiare të vitit 2018, nuk ka një analizë se cilat janë kategoritë e debitorëve nga përfitimet që përbëjnë shumën 5,893,644,000 lekë.

Konstatim:

Në pasqyrat financiare të vitit 2018, në klasën 4, në zërin “Të tjera kërkesa debitorësh”, debitorët në organet e sigurimeve shoqërore, për vitin ushtrimor 2018, paraqiten në shumën 7,543,983,113.92 lekë, që përfaqëson: debitorë nga kontributet në shumën 1,560,339,000 lekë dhe debitorë nga përfitimet në shumën 5,893,644,000 lekë. Në relacionin shoqërues të pasqyrave financiare të vitit 2018, nuk ka një analizë të kategorive të debitorëve nga përfitimet që përbëjnë shumën 5,893,644 mijë lekë.

Në lidhje me politikat e ndjekura nga ISSH, për shlyerjen e detyrimeve rezulton se, fillimisht ISSH me shkresën nr.7094, datë 21.08.2017, kërkon nga të gjitha DRSSH të kryejnë një analizë të plotë të gjendjes dhe evadimit të debitorëve dhe sidomos të vënies në ekzekutim të vendimeve gjyqësore apo kalim në proces gjyqësor për vjeljen e debitorëve, duke marrë masa për ndjekjen e ecurisë së kallzimeve penale.

Në vitin 2018 kemi një përpjekje për formalizimin e politikave në drejtim të shlyerjes së detyrimeve. Kjo konsiston në hartimin e një akti marrëveshjeje për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura e cila do të lidhet midis përfaqësuesit të Drejtorisë Rajonale të ISSH-së dhe personit të identifikuar në sistemin e sigurimeve si debitor. Objekt i kësaj marrëveshjeje është dakordësimi i një grafiku pagesash me këste të detyrimeve brenda periudhës kohore të rënë dakord dhe në një shumë jo më pak se 50% e pagës minimale.

Akt marrëveshjeje i është dërguar drejtorive rajonale të ISSH-së në rrugë elektronike në datë 13.11.2018, nga drejtoria e financës së ISSH-së. Në komunikimin zyrtar drejtoritë rajonale ngarkohen të njoftojnë zyrtarisht debitorët si dhe ti kontaktojnë verbalisht ata për të mundësuar shlyerjen e detyrimeve. Gjithashtu DRSSH ngarkohen me detyrimin për të raportuar çdo muaj numrin e akti marrëveshjeje të lidhura, por nga auditimi rezulton se, në harkun kohor të një viti, DRSSH kanë raportuar vetëm 23 akti marrëveshjeje të lidhura.

III. Ligji nr.72/2017 “Për faljen e detyrimeve ndaj fondit të sigurimeve shoqërore të personave në pension invaliditeti, sipas Ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të personave në pension, sipas Ligjit nr.150/2014 “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, të krijuara për shkak të punësimit gjatë kohës së përfitimit të pensionit”, konsiston në faljen e gjendjes së papaguar në datë 31.12.2016, e cilaka rezultuar si shkak i punësimit të tyre gjatë kohës që përfitonin pensionin e invaliditetit apo pension si punonjës që ka punuar në minierë në nëntokë. Falja përfshin edhe detyrimet e njohura me vendim gjyqësor. Ligji në nenin 2 ngarkon me përgjegjësi ISSH-në që brenda 3 muajve, nga hyrja në fuqi e ligjit, të evidentojë e të zbatojë të gjitha procedurat administrative dhe dokumentare të evidentimit të detyrimeve të falura.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

ISSH me shkresën nr.4606, datë 24.05.2017 “Mbi administrimin e debitorëve dhe arkëtimin e tyre” ka kërkuar nga të gjitha DRSSH evidentimin e debitorëve sipas natyrës së krijimit. Nga informacioni i disponuar grupit të auditimit rezulton se, DRSSH kanë evidentuar debitorët sipas natyrës së krijimit dhe i kanë raportuar ato në ISSH. Shuma totale e evidentuar dhe e shlyer në zbatim të Ligjit nr.72/2017 është 204,824,805 lekë, nga këto 34,690,712 lekë i përkasin kategorisë së minatorëve.

Të dhëna mbi zbatimin e Ligji nr.72/2017 “Për faljen e detyrimeve ndaj fondit të sigurimeve shoqërore të personave në pension invaliditeti.....”, për vitin 2017.

Tabela nr.5
Në lekë

Nr.	Emërtimi	Shuma e falur sipas Ligjit 72/2017		Totali i shumës së falur
		Minatorë	Invalidë	Minatorë+ Invalidë
1	Berat	-	-	-
2	Dibër	6,145,692	8,551,730	14,697,422
3	Durrës	256,350	8,869,893	9,126,243
4	Elbasan	258,848	2,877,906	3,136,754
5	Fier	-	6,346,458	6,346,458
6	Gjirokastrë	418,019	-	418,019
7	Korcë	1,558,928	12,702,683	14,261,611
8	Kukës	404,158	83,944,421	84,348,579
9	Lezhë	2,563,698	2,329,174	4,892,872
10	Shkodër	882,817	9,707,881	10,590,698
11	Tiranë	8,527,051	4,005,672	12,532,723
12	Vlorë	286,821	4,893,869	5,180,690
	Totali	21,302,382	144,229,687	165,532,069

Burimi: Drejtoria e Financës në ISSH

Të dhëna mbi zbatimin e Ligji nr.72/2017 “Për faljen e detyrimeve ndaj fondit të sigurimeve shoqërore të personave në pension invaliditeti.....”, për vitin 2018.

Tabela nr.6
Në lekë

Nr.	Emërtimi	Shuma e falur sipas Ligjit 72/2017		Totali i shumës së falur
		Minatorë	Invalidë	Minatorë+ Invalidë
1	Berat		652,979	652,979
2	Dibër	2,560,364	1,125,656	3,686,020
3	Durrës	10,221,569	6,027,512	16,249,081
4	Elbasan		74,992	74,992



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

5	Fier		158,148	158,148
6	Gjirokastrë		152,360	152,360
7	Korcë	285,320	589,571	874,891
8	Kukës		13,235,611	13,235,611
9	Lezhë		87,620	87,620
10	Shkodër	321,077	2,260,815	2,581,892
11	Tiranë			-
12	Vlorë		1,539,142	1,539,142
	Totali	13,388,330	25,904,406	39,292,736

Burimi: Drejtoria e Financës në ISSH

Strukturat përgjegjëse në ISSH, për periudhën 2017 e në vazhdim, rezultojnë të kenë zbatuar detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i Ligjit nr.72/2017 “Për faljen e detyrimeve ndaj fondit të sigurimeve shoqërore të personave në pension invaliditeti...”, në lidhje me evidentimin e debitorëve sipas natyrës së krijimit dhe shlyerjen e tyre.

Në zbatim të Ligjit nr.72/2017, ka dalë VKM nr.301, datë 23.05.2018 “Për procedurën e faljes së detyrimeve për subjektet e Ligjit 72/2017, “Për faljen e detyrimeve ndaj fondit të sigurimeve shoqërore të personave në pension invaliditeti, sipas Ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të personave në pension, sipas Ligjit nr.150/2014 “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, të krijuara për shkak të punësimit gjatë kohës së përfitimit të pensionit”

-Në pikën 1/a, VKM nr.301, datë 23.05.2018, ngarkon ISSH-në të evidentojë në kartelë të vecantë financiare dhe të crregjistruar në kontabilitet shumën e detyrimit të mbetur më datë 31.12.2016 të cdo pensionisti në pension invaliditeti dhe ish punonjës nëntoke, dhe

-Në pikën 1/b, të evidentojë në kartelë të vecantë financiare shumat që pensionistët debitorë kanë paguar në periudhën nga 01.01.2017 deri në datën e hyrjes në fuqi të Ligjit nr.72/2017, të cilët janë falur sipas dispozitave të këtij ligji dhe të bëjë kthimin e tyre për llogari të cdo përfituesi.

Nga informacioni i disponuar në ISSH, rezultojnë se, DRSSH kanë evidentuar në kartelë të vecantë financiare shumat që pensionistët debitorë kanë paguar në periudhën nga 01.01.2017 deri në datën e hyrjes në fuqi të Ligjit nr.72/2017. Gjithashtu DRSSH kanë evidentuar këtë fenomen në kontabilitet, duke crregjistruar shumën e detyrimit të mbetur deri në datë 31.12.2016, të cdo pensionisti në pension invaliditeti dhe ish punonjës nëntoke.

Nga hyrja në fuqi e Ligjit nr.72/2017, për vitin 2017 rezultojnë debi të falura në shumën 165,532,069 lekë dhe në vitin 2018 në shumën 39,292,736 lekë.

Ndërkohë me Vendim Gjykatë rezultojnë paksim debie për vitin 2017 në shumën 140,291,535 lekë dhe për vitin 2018 në shumën 122,240,049 lekë.

Në pikën 2 të VKM nr.301, datë 23.05.2018, përcaktohet se falja bëhet me vendim të NA dhe NZ të DRSSH dhe jepet evidentim apo pagesë në sistemin informatik të përfitimeve të ISSH-së.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Grupi i auditimit verifikoi evidentimin/pagesën e faljes në sistemin informatik të përfitimeve të ISSH-së, nga ku rezultoi se detyrimi/shlyerja e faljes sipas përcaktimeve të VKM nr.301, datë 23.05.2018 është pasqyruar në një kartelë të vecantë financiare për secilin përfitues, por kjo shumë e detyrimit të falur nuk është pasqyruar në sistem në një shtyllë të vecantë.

Në pikën 3 të VKM nr.301, datë 23.05.2018, përcaktohet se rregullshmëria e vendimeve të DRSSH lidhur me evidentimin e detyrimeve të falura sipas dispozitave të Ligjit nr.72/2017, do të jenë objekt i vecantë auditimi nga auditi i brendshëm i ISSH-së dhe rezultatet e auditimit do t'i njoftohen Ministrisë të Financave dhe të Ekonomisë”.

Konstatim:

Drejtorja e Auditimit të Brendshëm në ISSH nuk ka hartuar dhe kryer asnjë auditim të vecantë për rregullshmërinë e vendimeve të DRSSH, në lidhje me evidentimin e detyrimeve të falura sipas dispozitave të Ligjit nr.72/2017 dhe për rrjedhojë nuk ka njoftuar Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë mbi rezultatet e arritura, veprim ky në kundërshtim me kërkesat e pikës 3 të VKM nr.301, datë 23.05.2018 “Për procedurën e faljes së detyrimeve për subjektet e Ligjit 72/2017, “Për faljen e detyrimeve ndaj fondit të sigurimeve shoqërore të personave në pension invaliditeti, sipas Ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të personave në pension, sipas Ligjit nr.150/2014 “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, të krijuara për shkak të punësimit gjatë kohës së përfitimit të pensionit”.

Përgjegjësi për veprimet e mësipërme mban, [REDAKTUAR] me detyrë, Drejtor i Auditit të Brendshëm.

IV. Ligji nr.29/2019, “Për trajtimin financiar, suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji”, ka për qëllim trajtimin financiar të punonjësve sipas sektorëve të sipërcituar, përvec trajtimit të përcaktuar në Ligjin nr.4171, datë 13.09.1966, të ndryshuar dhe Ligjin nr.7703, datë 11.05.1993, të ndryshuar.

Vjetërsia e përgjithshme në punë dhe periudhat e sigurimit për efekt të zbatimit të këtij ligji, vlerësohen dhe njihen sipas përcaktimeve të Ligjit nr.7703, datë 11.05.1993, të ndryshuar dhe akteve ligjore të dala në zbatim të tij.

Ky ligj përcakton që për ish punonjësit, të cilët kanë kryer procese pune në miniera në nëntokë, trajtimi me përfitime përpara moshës dhe kushteve të përcaktuara në Ligjin nr.7703, datë 11.05.1993, të ndryshuar, do të vazhdojë të bëhet sipas përcaktimeve të Ligjit nr.150/2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë” dhe akteve ligjore të dala në zbatim të tij.

Në lidhje me masën e përfitimit të shtesës mbi pensionin e pleqërisë, ligji përcakton si kategori përfituesish:

-Ish punonjësit, sipas përcaktimeve të këtij ligji, të cilët kanë përfituar pension pleqërie ose do të plotësojnë kushtet për të përfituar pension pleqërie, sipas Ligjit nr.7703, datë 11.05.1993, të ndryshuar, përfitojnë shtesë pensioni për cdo vit periudhë sigurimi në profesion, konkretisht, punonjësit e nëntokës përfitojnë trajtim financiar suplementar 1% të masës së pensionit të pleqërisë;

-Të gjithë personat që kanë jo më pak se 6 vite në profesionet dhe punët e përcaktuara në këtë ligj;



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

-Personat që marrin pension sipas Ligjit nr.150/2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, kur data e lindjes së të drejtës për pension është deri më 31.12.2014.

Në lidhje me masën e përfitimit të shtesës mbi pensionin e invaliditetit, ligji përcakton si kategori përfituesish:

-Personat të cilët kanë përfituar ose do të plotësojnë kushtet për të përfituar pension invaliditeti, sipas përcaktimeve të Ligjit nr.7703, datë 11.05.1993, të ndryshuar, përfitojnë shtesë pensioni në masën 1% për cdo vit vjetërsie punë në miniera, në nëntokë;

-Ish minatorët që përfitojnë pension invaliditeti nga aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale, të cilët kanë vjetërsi në profesion më pak se periudha e përcaktuar në këtë ligj, për efekt të shtesës mbi pension, vjetërsia në profesion llogaritet 12.5 vjet.

Sipas informacionit të administruar, rezulton se, strukturat pritëse të ISSH-së, duke filluar nga data 01.09.2019 kanë filluar pritjen/regjistrimin e kërkesave për pension për shkak të profesionit dhe për shtesë të pensionit të pleqërisë ose invaliditetit, sipas parashikimeve të Ligjit nr.29/2019 dhe administrimi i tyre, së bashku me dokumentacionin përkatës, bëhet nga DRSSH-të.

Në zbatim të Ligjit nr.29/2019, ka dalë VKM nr.721, datë 11.11.2019, “Për përcaktimin e dokumentacionit, shumës vjetore të transfertës nga buxheti i shtetit dhe procedurave të financimit të fondit të sigurimeve shoqërore për trajtimin financiar suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe punonjësve që kanë punuar në metalurgji”. Në pikën 3 të saj, ngarkon me përgjegjësi ISSH që brenda 10 ditësh nga hyrja në fuqi e këtij vendimi të vendos në dispozicion të kërkuësve formatin e kërkesës për përfitim për shkak të profesionit si dhe formatin e vërtetimit të posaçëm të konfirmimit të llojit të punës në profesionet e vështira.

Nga auditimi rezulton se, ISSH ka hartuar dhe miratuar formatin e kërkesës për përfitim për shkak të profesionit si dhe formatin e vërtetimit të posaçëm të konfirmimit të llojit të punës në profesionet e vështira, si pjesë përbërëse e Rregullores nr.23, datë 31.07.2019 “Për caktimin, administrimin dhe pagesën e trajtimit financiar, suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe punonjësve që kanë punuar në metalurgji”. Kjo rregullore është miratuar me Vendimin nr.23, datë 31.07.2019 të Këshillit Administrativ të ISSH-së dhe me shkresën nr.6035/1, datë 09.09.2019, i është dërguar të gjitha drejtorive rajonale të ISSH-së.

Në rregullore specifikohet që në programin elektronik të pensioneve PCAMS, pensionet sipas Ligjit 29/2019, do të evidentohen më vete me emërtimin “Pensione për shkak të profesionit sipas Ligjit 29/2019” dhe “Shtesë mbi pension sipas Ligjit 29/2019”.

VKM nr.721, datë 11.11.2019, llogarit efekte financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij ligji, në shumën 725 mln lekë, fonde këto të akorduara në buxhetin e ISSH –së për vitin 2019. Nga 725 mln lekë të akorduara, 250 mln lekë do të shkojnë për përballimin e trajtimit financiar suplementar të minatorëve, 350 mln lekë për naftëtarët dhe 125 mln lekë për metalurgët.

Në zbatim të Ligjit 29/2019, ISSH referuar kërkesave të paraqitura deri në momentin e auditimit, ka hartuar data base-n e kërkesave, për kategoritë përfituese, sipas Ligjit 29/2019.

Nga informacioni i vënë në dispozicion të grupit të auditimit, konstatohet se, deri më datë 05.12.2019, kanë paraqitur kërkesën për përfitim sipas parashikimeve të Ligjit 29/2019, 10,965 ish minatorë, të ndarë në 14 rajone, prej të cilëve janë verifikuar 1,254 dosje.

Pas miratimit të VKM nr.721, datë 11.11.2019, ka filluar gjenerimi i pagesave në sistemin e pagesave të ISSH-së për 1,254 përfituesit e parë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

ISSH në faqen zyrtare ka filluar publikimin e listave të përfituesve për të cilët është caktuar përfitimi dhe ju gjenerohet pagesa në pikat paguese si dhe në bankat e nivelit të dytë.

Në lidhje me këtë çështje, nga grupi i auditimit u mbajt Akt Konstatimi, nr.1, datë 05.12.2019, në të cilin strukturat përgjegjëse ngarkohen me përgjegjësi për moszbatimin e kërkesave të Ligjit nr.8685, datë 09.11.2000, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, i ndryshuar; Ligjit nr.9356, datë 17.03.2005 “Për disa shtesa e ndryshime në Ligjin nr.8685, datë 09.11.2000 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në minierë, në nëntokë”;Ligjit nr.150/2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”;Ligjit nr.72/2017;Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;Ligjit nr.9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar; VKM nr.301, datë 23.05.2018 “Për procedurën e faljes së detyrimeve për subjektet e Ligjit 72/2017, “Për faljen e detyrimeve ndaj fondit të sigurimeve shoqërore të personave në pension invaliditeti, sipas Ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të personave në pension, sipas Ligjit nr.150/2014 “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, të krijuara për shkak të punësimit gjatë kohës së përfitimit të pensionit”;VKM nr.73, datë 15.02.2001 “Për kriteret dhe masën e trajtimit të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në minierë, në nëntokë” e dalë në zbatim të Ligjit nr.8685, datë 09.11.2000 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në minierë, në nëntokë”; UMFJE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Titulli i çështjes: **Zbatueshmëria e kuadrit ligjor në fuqi, nga ana e strukturave përgjegjëse të ISSH-sëpërpensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë.**

Gjetja 1: Mosreflektimi në rregulloret e ISSH-sëi ndryshimeve strukturore dhe mospërfshirja në to e kërkesave të Ligjit nr.150/2014 “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”.

Situata: Në zbatim të Ligjit 150/2014, kontrollet/inspektimet janë kryer nga Njësia e Inspektimit të Përfitimeve, strukturë kjo e miratuar me Vendimin e Këshillit Administrativ nr.6, datë 20.07.2010. Njësia e Inspektimit të Përfitimeve ushtron funksionet në zbatim të Rregullores për Organizimin e Detyrave Funksionale në Drejtorinë e Përgjithshme të ISSH-së, si dhe në zbatim të Rregullores nr.1/2, datë 04.03.2011 “Për një shtesë në Rregulloren nr.1, datë 21.10.2008 “Për caktimin, administrimin dhe pagesën e pensioneve”, e ndryshuar.

a) Në Rregulloren për Organizimin e Detyrave Funksionale në Drejtorinë e Përgjithshme të ISSH –së, në kapitullin VIII, emërtesa është “Njësia e Inspektimit të Përfitimeve”, ndërkohë që inspektorët emërtohen “Inspektorë të Njesisë së Kontrollit të Ligjshmërisë së Përfitimeve”;

b) Në Rregulloren nr.1/2, datë 04.03.2011 “Për një shtesë në Rregulloren nr.1, datë 21.10.2008 “Për caktimin, administrimin dhe pagesën e pensioneve”, e ndryshuar, detyrat dhe procedurat i ngarkohen për zbatim Njesisë së Kontrollit të Ligjshmërisë (njësi kjo që nuk është pjesë e strukturës organizative të ISSH në këtë periudhë), dhe jo Njesisë së Inspektimit të Përfitimeve, sipas emërtimeve të strukturës së



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

miratuar.

c) E drejta e vendosjes së gjobës, si detyrim që rrjedh nga zbatimi i Ligjit nr.150/2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, nuk është përcaktuar si detyrë specifike e strukturës përgjegjëse as në Rregulloren për Organizimin e Detyrave Funksionale në Drejtorinë e Përgjithshme të ISSH-së, datë 15.03.2018 dhe as në projekt rregulloren për Njësinë e Inspektimit të Përfitimeve datë 04.03.2011, e për rrjedhojë kjo e drejtë nuk është zbatuar nga strukturat përgjegjëse.

Kriteri:

Ligji nr.150/2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”.

Ligjinr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

Ndikimi:

Të ardhura të munguara nga vjelja e gjobave.

Shkaku:

Mangësi në funksionimin e kontrollit të brendshëm.

Rëndësia:

E lartë.

Rekomandimi 1:

ISSH të marrë masa për përmirësimin e Rregullores për Organizimin e Detyrave Funksionale në Drejtorinë e Përgjithshme të ISSH-së dhe Rregullores nr.1/2, datë 04.03.2011 “Për një shtesë në Rregulloren nr.1, datë 21.10.2008 “Për caktimin, administrimin dhe pagesën e pensioneve”, e ndryshuar, në drejtim të reflektimit në to të ndryshimeve strukturore dhe përfshirjes së të drejtës së vendosjes së gjobës, si detyrim që rrjedh nga zbatimi i Ligjit nr.150/2014.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

31.01.2020.

Gjetja 2:

Pasaktësi në hedhjen fillestare të të dhënave në sistemin e pensioneve PCAMS, në vitin 2012, për përfituesit e skemës së Ligjit nr.8685, datë 09.11.2000 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në minierë, në nëntokë”.

Situata:

Baza e të dhënave të pensioneve në sistemin informatik aktual PCAMS ka filluar të popullohet me të dhëna në vitin 2012 dhe janë hedhur të dhënat me operatorë duke u nisur nga dosjet stok. Në këtë kohë janë hedhur të dhënat e dosjeve të TVM aktive, pra që paguheshin si dhe dosjet që ishin të pezulluara apo mbyllura me qëllim evidentimin e tyre për të shmangur lidhjen e një përfitimi tjetër pa ju evidentuar debia dhe mbajtja e debisë kur të përfitonin nga ndonjë skemë tjetër.

Nga të dhënat e gjeneruara të sistemit elektronik të pensioneve PCAMS, të administruara nga grupi i auditimit, në datë 25.11.2019, rezultojnë: përfitues të Ligjit nr.8685, datë 09.11.2000, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, të ndryshuar, 4,430 persona nga 5,527 kërkesa të administruara dhe njëkohësisht përfitues fillestar të kësaj skeme. Nga 4,430 përfitues paraqiten me status aktiv 147 dosje përfituesishdhe të mbyllura 4,283 dosje, sipas arsyeve të poshtëshënuara:

-37 ish përfitues fillojnë punë;

-2,237 ish përfitues kalojnë si përfitues në një lloj tjetër pensioni (Ligji 150/2014);



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

- 1,818 dosje të ish përfituesve rezultojnë të mbyllura nga auditimi/ose nuk plotësojnë kushtet;
- 90 dosje të ish përfituesve rezultojnë të pezulluara;
- 57 dosje të ish përfituesve rezultojnë të transferuar në një rajon tjetër;
- 44 ish përfitues rezultojnë të vdekur.

Nga të dhënat e paraqitura nga ISSH, me shkresën nr.7719/3, prot, datë 23.12.2019, protokolluar në KLSH me nr.919/3, datë 24.12.2019, rezultojnë se:

- Deri në vitin 2002 janë evidentuar 5,893 kërkesa për përfitim;
- Deri në vitin 2002 janë pranuar 5,549 prej kërkesave të paraqitura;
- Deri në vitin 2012 kanë kaluar nga TVM në një trajtim tjetër (nga Ligji 7703), gjithsej 844 persona, vdekur gjatë kësaj periudhe 59 persona dhe 37 persona kanë ndërprerë trajtimin për shkak të punësimit dhe të vetë punësimit;
- Trajtime të veçanta aktive që paguheshin në vitin 2014 para se të dilte Ligji 150/2014 kanë qënë 3573, nga të cilët 207 përfitues kanë kaluar në një pension tjetër (sipas Ligjit 7703 nga 2012 – 2014) dhe 774 përfitues janë debitorë që vilen apo presin për tu vjelë.
- Në vitin 2012 numri total i përfituesve të hedhur në sistemin informatik aktual të pensioneve PCAMS ka qënë 4,396 përfitues, nga 5,549 kërkesa të pranuar, të cilët sot paraqiten:
 - a)148 përfitues vazhdojnë të përfitojnë trajtimin e veçantë pasi nuk kanë mbushur moshën e daljes në pension sipas Ligjit 150/2014;
 - b)3214 përfitues nga TVM kanë kaluar në përfitues sipas Ligjit 150/2014;
 - c)774 janë debitorë në financë që vilen ose priten të futen në skemë që të vilet debia;
 - d) 207 përfitues kanë kalur në përfitim tjetër nga viti 2012 deri në vitin 2014;
 - e) 53 përfitues kanë ndërruar jetë gjatë viteve 2012-2014.

Të dhënat e gjeneruara në datë 18.12.2019 paraqesin pasaktësi në:

- Hedhjen fillestare të të dhënave në vitin 2012 (1,153 përfitues nuk janë pasqyruar në sistem në vitin 2012 (diferenca 5,549 kërkesa të pranuar - 4,396 përfitime të hedhura në sistem në vitin 2012);
- Analizën e dinamikës së TVM para vitit 2012 (844 persona transferuar nga TVM të Ligji 7703, 59 persona të vdekur dhe 37 persona ndërprerë TVM për shkak të punësimit), në total 940 persona dhe jo 1,153 që është numri i përfituesve që nuk janë pasqyruar në sistem në vitin 2012, për më tepër këto kategori duhej të hishin hedhur në sistem për të krijuar historikun e TVM-së.

Kriteri:

Ligji nr.8685, datë 09.11.2000, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, i ndryshuar.
Ligjinr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

VKM nr.73, datë 15.02.2001 “Për kriteret dhe masën e trajtimit të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në minierë, në nëntokë”.

Ndikimi:

Mungesa e një pasqyre të plotë informacioni mbi përfituesit e Ligjit nr.8685, datë 09.11.2000, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, i ndryshuar dhe dinamikën e



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

zhvillimit të tyre deri në momentin e hedhjes në sistemin informatik të pensioneve.

Shkaku: Hedhja jo e saktë e të dhënave fillestare në sistem nga operatorë joprofesionistë, të dhëna jo të sakta të raportuara nga DRSSH, si dhe dobësi të konstatuara në funksionimin e kontrollit të brendshëm.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi 2: a) ISSH të kalojë në një proces inspektimi/verifikimi dhe më pas dixhitalizimi, të gjithë regjistrat e kërkesave, kthimeve, caktimeve, mbylljeve, të trajtimit të vecantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të cilat administrohen nga Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore;

b) Në përfundim të procesit të inspektimit/verifikimit, ISSH të kalojë në njëproces shqyrtimi tërësor gjithë informacionin e hedhur në sistemin informatik të pensioneve PCAMS, në vitin 2012 dhe të pasqyrojë në një kolonë të vecantë rezultatet e këtij procesi.

Afati për zbatimin e rekomandimit: 31.01.2020.

Gjetja 3: a) 658 nga 774 debitorë, ose 85% e numrit të përgjithshëm të debitorëve nuk janë në proces arkëtimi dhe shuma e debisë që ata përfaqësojnë (436,067,017 lekë) zë 89% të shumës totale të debisë (487,931,873 lekë);

b) 64 përfitues debitorë në shumën 36,561,410 lekë, ose 9,7% e debitorëve nuk shlyejnë debinë edhe pse rezultojnë të jenë pjesë e skemës së përfitimeve nga viti 2013 deri në vitin 2019.

c) 10 nga 37 përfitues (punonjës që kanë punuar në miniera, në nëntokë), ose 27% e atyre që u është ndërprerë TVM për shkak të punësimit, rezultojnë debitorë në shumën 5,741,200 lekë dhe aktualisht janë në kushtet e pamundësisë për të shlyer debinë.

Situata: Në procesin e kontrollit, nga viti 2007 e deri në vitin 2019 janë evidentuar debitor për shkak të mbylljes përfundimisht të përfitimit ose pezullimit të tij dhe kalimit në proces ligjor, 1110 raste nga të cilat 944 raste nga TMV dhe 158 raste nga Ligji nr.150/2014. Nga këto janë shlyer, evaduar edhe me vendime gjyqësore në periudhën 2010- 2019, 336 raste dhe përfundimisht me 31.10.2019 rezultojnë debitorë 774 raste me shumë debie 487,931,873 lekë. Nga këto, janë në proces arkëtimi 116 raste, në proces gjyqësor 141 raste (përfitime të pezulluara, të ngarkuara si debitorë, por në proces gjykimi) dhe në proces shqyrtimi në organet e prokurorisë 231 raste. Në sqarimet e paraqitura nga ISSH, me shkresë nr.7719/3, prot, datë 23.12.2019, protokolluar në KLSH me nr.919/3, datë 24.12.2019, shpjegohet statusi për 488 përfitues debitorë, ndërkohë që për 286 përfitues të tjerë nuk jepet asnjë shpjegim, gjithashtu nuk jepen shpjegime se përse 64 përfitues debitorë në shumën 36,561,410 lekë nuk shlyejnë debinë edhe pse janë futur në skemë në periudhën 2013-2019.

Nga përpunimi i bazës së të dhënave të sistemit elektronik të pensioneve PCAMS, në datë 25.11.2019, rezulton se, për 37 persona përfitues është ndërprerë trajtimi i vecantë për arsye të punësimit/vetëpunësimit. Dosjet e këtyre përfituesve rezultojnë të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

mbyllura në sistem me arsye të sipërcituar. Grupi i auditimit, gjatë kohës së ushtrimit të auditimit në ISSH, kërkoi informacion nëse këta 37 persona, në momentin e ndërprerjes së trajtimit të vecantë, për arsye të punësimit/vetëpunësimit, kanë rezultuar ose jo debitorë dhe nëse po, sa ka qenë shuma respektive. ISSH me shkresë nr.7719/3, prot, datë 23.12.2019, protokolluar në KLSH me nr.919/3, datë 24.12.2019, sqaron si vijon: Nga 37 përfituesit që u është ndërprerë TVM pasi kanë filluar punë ose janë vetëpunësuar, 16 prej tyre rezultojnë se kanë ndërprerë punën, nuk kanë tërhequr trajtimin dhe për rrjedhojë nuk rezultojnë debitorë, në 1 rast është hequr debia me vendim gjyqate, 1 përfitues e ka shlyer debinë prej një muaj pagesë, 2 përfitues janë në procese hetimi dhe gjyqësore, 7 përfituesve po ju vilet debia në pensionin e pleqërisë dhe invaliditetit si dhe 10 përfitues me shumë totale debie prej 5,741,200 lekë priten të futen në skemë, pasi nuk përfitojnë asnjë pagesë nga sigurimet shoqërore.

Kriteri:

Ligji nr.8685, datë 09.11.2000, “Për një trajtim të vecantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, i ndryshuar.

Ligji nr.9356, datë 17.03.2005 “Për disa shtesa e ndryshime në Ligjin nr.8685, datë 09.11.2000 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në minierë, në nëntokë”.

Ligji nr.150/2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”.

Ligjinr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

Ndikimi:

478,369,627 lekë të ardhura të munguara për fondin e sigurimeve shoqërore.

Shkaku:

Mosarkëtimi i 85% të shumës së debisë si dhemosqënia pjesën asnjë nga skemat e pensioneve e 10 përfituesve debitorë.

Rëndësia:

E Lartë.

Rekomandimi 3:

a) ISSH: Të hartojë politika dhe të formalizojë procedura të qarta, për të mundësuar arkëtimin e shumës debitorë prej 436,067,017 lekë, nga përfituesit debitorë të cilët aktualisht janë në kushtet e pamundësisë për të shlyer debinë, pasi nuk janë pjesë e asnjë prej skemave të pensionit;

b) Tëndjek në mënyrë sistematike dhe analitike shlyerjen e shumës debitorë prej 436,067,017 lekë nga moment i hyrjes së përfituesve debitorë në një prej skemave të përfitimit;

c) Të nxjerrë përgjegjësitë administrative, për mosarkëtimin e debisë për 64 përfituesit debitorë të cilët edhe pse rezultojnë të jenë pjesë e skemës së përfitimeve nga viti 2013 deri në vitin 2019, ende vazhdojnë të mosshlyejnë debinë.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

31.01.2020.

Gjetja 4:

Mosrakordim të dhënash midis sistemit informatik të pensioneve PCAMS dhe strukturës së inspektimit, në lidhje me numrin e dosjeve të mbyllura.

Situata:

Në datë 25.11.2019, në sistemin elektronik të pensioneve PCAMS, të ISSH-së, rezultojnë në total 4,168 përfitues nga Ligji 150/2014, prej të cilëve vetëm 3,177 janë përfitues aktiv të skemës. Diferenca prej 991



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

përfituesish, përfaqëson numrin e përfituesve, dosjet e të cilëve kanë rezultuar me problem nga verifikimi dhe janë mbyllur.

Strukturë përgjegjëse për auditimin e përfitimeve në zbatim të Ligjit nr.150/2014, e miratuar me Vendimin e Këshillit Administrativ nr.6, datë 20.07.2010, rezulton të jetë Njësia e Inspektimit të Përfitimeve.

Gjatë ushtrimit të funksioneve të saj, për periudhën pas hyrjes në fuqi të Ligjit nr.150/2014, kjo strukturë ka kryer në total 23 inspektime në 12 degë rajonale. Nga ky proces janë inspektuar në total 3,782 dosje minatorësh përfitues, nga të cilat: certifikuar të rregullta 3,576 dosje, pezulluar 48 dosje dhelënë detyrë për plotësim për 158 dosje. Efekti total i debisë për dosjet e inspektuara nga kjo strukturë arrin në shumën 56,513,530 lekë.

Pra, ndërkohë që nga sistemi rezultojnë të mbyllura 991 dosje përfituesish (nga skema e Ligjit 150/2014), nga struktura përgjegjëse e inspektimit raportohen 48 të tilla.

Kriteri:

Ligji nr.150/2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”.

Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

Ndikimi:

Mosnjohja e saktë e numrit, shumës dhe dinamikës së debisë nga ana e strukturave përgjegjëse në ISSH, për kategorinë e punonjësve që kanë punuar në minierë në nëntokë.

Shkaku:

Mangësi në funksionimin e kontrollit të brendshëm, në drejtim të mungesës së koordinimit midis strukturave të ISSH.

Rëndësia:

E lartë.

Rekomandimi 4:

a)Strukturat përgjegjëse në ISSH të koordinojnë punën në funksion të, saktësimin dhe detajimit të 991 përfituesve, (dosjet e të cilëve rezultojnë të mbyllura nga auditimi në sistemin informatik të pensioneve PCAMS), nga

zbatimi i skemave të Ligjit nr.8685/2000 dhe Ligjit nr.150/2014;

b)Pasi të saktësohet statusi i tyre të pasqyrohen vecmas në sistem kategoria “Përfituar padrejtësisht”.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

31.01.2020.

Gjetja 5:

880 procese gjyqësore të humbura nga ISSH ndaj punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë për periudhën 2000-2019. Vetëm për periudhën 01.01.2008-31.10.2019, ISSH ka paguar për proceset gjyqësore të humbura kundrejt minatorëve përfitues të skemës së Ligjit nr.8685/2000 dhe Ligjit nr.150/2014, në total 709,169,746 lekë, ose 96.3% të debisë totale të arkëtuar.

Situata:

ISSH për vërtetësinë e përfitimeve të identifikuar si të padrejta rezulton të ketë ndjekur rrugën ligjore. Nga informacioni i disponuar grupit të auditimit rezulton se: Në harkun kohor të viteve 2000-2012 kanë përfunduar 418 procese gjyqësore në favor të përfituesve, duke sjellë për pasojë rikthimin e tyre në skemën e pensioneve; Në harkun kohor të viteve 2013-2018, janë hapur gjithësej 610 procese gjyqësore, në 13rajone të vendit. Nga 610 procese të hapura: 434 procese, ose 71.4% e tyre janë humbur nga ISSH dhe 176 procese,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

ose 28.6% e tyre janë fituar nga ISSH. Përgjatë vitit 2019, janë hapur gjithësej 195 procese gjyqësore, në 14 rajone të vendit, nga të cilat: 28 procese, ose 14.4% e tyre janë humbur nga ISSH, 26 procese, ose 13.3% e tyre janë fituar nga ISSH dhe 141 çështje, ose 72.3% e çështjeve janë në proces gjykimi. Pra në harkun kohor 2013-2018 janë humbur nga ISSH mbi 70% e proceseve gjyqësore, ndërkohë që për vitin 2019, ende nuk ka rezultate përfundimtare pasi 72.3% e çështjeve janë në proces gjykimi.

Në total, për vitet 2000-2019, ISSH rezulton të ketë humbur 880 procese gjyqësore, që do të thotë: 880 përfitues, të identifikuar si përfitime të padrejta, i janë rikthyer skemës së përfitimit të pensionit. Për periudhën 01.01.2008-31.10.2019, ISSH ka paguar për proceset gjyqësore të humbura kundrejt minatorëve përfitues të skemës së Ligjit nr.8685/2000 dhe Ligjit nr.150/2014, në total 709,169,746 lekë, ose 96.3% të debisë totale të arkëtuar.

Deri në datën 31.10.2019, ISSH raporton për 770 debitorë minatorë, në shumën totale prej 486,985,324 lekë.

Kriteri: Ligji nr.8685, datë 09.11.2000, “Për një trajtim të vecantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, i ndryshuar.
Ligji nr.150/2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”.

Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

Ndikimi: Nivel i ulët i të ardhurave reale nga vjelja e debisë për kategorinë e debitorëve minatorë.

Shkaku: Mungesë profesionalizmi nga ana e strukturave përgjegjëse, përfaqësuese të ISSH në proceset gjyqësore.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi 5: ISSH të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë administrative në lidhje me vendimet gjyqësore, në dëm të institucionit. Për çdo proces gjyqësor të përfunduar, të zhvillohen analizat nga Drejtoria Juridikenë ISSH dhe të nxirren përgjegjësitë administrative kundrejt personave të autorizuar të ISSH-së, për mosveprimet dhe mospërbushjen e detyrës shtetërore.

Afati për zbatimin e rekomandimit: Menjëherë dhe në vijimësi

Gjetja 6: Pasaktësi në raportimet e Drejtorisë së Financës në drejtim të numrit të përfituesve dhe shumës faktike të transfertës buxhetore, për kategorinë e minatorëve të nëntokës.

Situata: Drejtoria e Financës në ISSH, në informacionin e paraqitur grupit të auditimit:

-Raporton 5,549 minatorë përfitues për vitin 2003 dhe 5,554 përfitues për vitin 2004, ndërkohë që grupit të auditimit nga strukturat e auditimit dhe certifikimit në ISSH i është raportuar si numër fillestar i kërkesave të rregjistruara në DRSSH dhe të pranura 5,527 përfitues.

-Raporton se për periudhën 2003-2018, përfitimet, nga skemat e



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

trajtimeve, për kategorinë e minorëve të nëntokës, i kanë kushtuar buxhetit të shtetit, në total, 6,730,437,000 lekë.

Grupi i auditimit për të vërtetuar saktësinë e informacionit të marrë verifikoi të dhënat e sistemit të thesarit të qeverisjes së përgjithshme, vetëm për vitin buxhetor 2018, nga ku rezultoi se: ISSH për vitin 2018, ka përfituar transfertë për pagesat e parakohshme për minorët në shumën totale 663,702,830 lekë, ndërkohë që, në informacionin e dhënë grupit të auditimit, nga drejtoria e financës, shuma e shpenzimeve faktike për vitin 2018, për këtë kategori, rezulton të jetë 235,822,000 lekë, ose 427,880,830 lekë më pak se tranferta buxhetore e këtij viti.

Referuar verifikimit të mësipërm, shuma faktike e shpenzimeve buxhetore, për periudhën 2003-2018, prej 6,730,437,000 lekë, e paraqitur nga drejtoria e financës, nuk rezulton të jetë e saktë.

-Raporton në fund të vitit 2018, 460 përfitues më shumë se në vitin 2017, ndërkohë që shpenzimet faktike në vitin 2018 i raporton të ulura me 167,400,000 lekë, ose në masën 58.5%, krahasuar me vitin 2017.

Aktualisht të dhënat statistikore, përpunohen manualisht nga drejtoria e financës, pasi sistemi elektronik i pensioneve PCAMS (Pension Calculation Management System) nuk rezulton i lidhur me sistemin e financës FMS (Financial Management System).

Sipas sqarimeve të paraqitur nga ISSH, me shkresën nr.7719/3, prot, datë 23.12.2019, protokolluar në KLSH me nr.919/3, datë 24.12.2019, në lidhje me deformimin e evidentimit të shpenzimeve të transfertës buxhetore për kategorinë e minorëve të nëntokës, sqarohet se: *“ky deformim ka ndodhur pasi në sistemin PCAMS nuk është bërë një zhvillim i veçantë evidentimi i shpenzimeve faktike sipas artikullit. Kjo ka sjellë si pasojë që shpenzimet të ngarkohen në zërin pensione pleqërie dhe stornimi i tyre të bëhet në mënyrë empirike dhe me gabime. Në vitin 2018 nuk është bërë kontrolli i plotë për evidentimin në këtë zë në momentin e mbylljes së raportit fiskal, datë 15 janar si dhe të mbylljes së bilancit financiar. Problematika është konstatuar me vonesë”*.

- Kriteri:** Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhekontrollin”, i ndryshuar.
- Ndikimi:** Informalitet në statistikat e prodhuara.
- Shkaku:** Mungesa e një lidhjeje midis sistemit elektronik të pensioneve PCAMS dhe sistemit të financës FMS.
- Rëndësia:** E lartë.
- Rekomandimi 6:** ISSH të marrë masa për zhvillimin e sistemit elektronik të pensioneve PCAMS duke e ndërlidhur atë me sistemin e financës FMS.
- Afati për zbatimin e rekomandimit:** Gjatë vitit 2020
- Gjetja 7:** Mosushtrimi nga ana e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm e kërkesave të pikës 3 të VKM nr.301, datë 23.05.2018, dalë në zbatim të Ligjit nr.72/2017, që përcaktojnë se, rregullshmëria e vendimeve të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Situata:	<p>DRSSH lidhur me evidentimin e detyrimeve të falura sipas dispozitave të Ligjit nr.72/2017, do të jenë <u>objekt i vecantë auditimi</u> nga auditi i brendshëm i ISSH-së dhe rezultatet e auditimit do t'i njoftohen Ministrit të Financave dhe të Ekonomisë.</p> <p>Nga hyrja në fuqi e Ligjit nr.72/2017, për vitin 2017 rezultojnë debi të falura në shumën 165,532,069 lekë dhe në vitin 2018 në shumën 39,292,736 lekë. Ndërkohë me Vendim Gjykate rezulton paksim debie për vitin 2017 në shumën 140,291,535 lekë dhe për vitin 2018 në shumën 122,240,049 lekë. Grupi i auditimit verifikoi evidentimin/pagesën e faljes në sistemin informatik të përfitimeve të ISSH-së, nga ku rezultoi se detyrimi/shlyerja e faljes sipas përcaktimeve të VKM nr.301, datë 23.05.2018 është pasqyruar në një kartelë të vecantë financiare për secilin përfitues, por kjo shumë e detyrimit të falur nuk është pasqyruar në sistem në një shtyllë të vecantë. Në pikën 3 të VKM nr.301, datë 23.05.2018, përcaktohet se rregullshmëria e vendimeve të DRSSH lidhur me evidentimin e detyrimeve të falura sipas dispozitave të Ligjit nr.72/2017, do të jenë objekt i vecantë auditimi nga auditi i brendshëm i ISSH-së” dhe rezultatet e auditimit do t'i njoftohen Ministrit të Financave dhe të Ekonomisë”.</p>
Kriteri:	<p>Ligji nr.72/2017 “Për faljen e detyrimeve ndaj fondit të sigurimeve shoqërore të personave në pension invaliditeti, sipas Ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të personave në pension, sipas Ligjit nr.150/2014 “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, të krijuara për shkak të punësimit gjatë kohës së përfitimit të pensionit”;</p> <p>VKM nr.301, datë 23.05.2018 “Për procedurën e faljes së detyrimeve për subjektet e Ligjit 72/2017, “Për faljen e detyrimeve ndaj fondit të sigurimeve shoqërore të personave në pension invaliditeti...”.</p>
Ndikimi:	<p>Mundësi për keqpërdorim të fondeve buxhetore.</p>
Shkaku:	<p>Moszbatimi i kërkesave ligjore të VKM nr.301, datë 23.05.2018 “Për procedurën e faljes së detyrimeve për subjektet e Ligjit 72/2017, “Për faljen e detyrimeve ndaj fondit të sigurimeve shoqërore të personave në pension invaliditeti, sipas Ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të personave në pension, sipas Ligjit nr.150/2014 “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, të krijuara për shkak të punësimit gjatë kohës së përfitimit të pensionit”.</p>
Rëndësia:	<p>E lartë</p>
Rekomandimi 7:	<p>Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në ISSH, në planin vjetor të vitit 2020, të planifikojë një auditim të vecantë mbi rregullshmërinë e vendimeve të DRSSH, në lidhje me rregullshmërinë në evidentimin dhe shlyerjen e detyrimeve të falura sipas dispozitave të Ligjit nr.72/2017 dhe në përfundim të procesit, për rezultatet e arritura të njoftojë Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë.</p>
Afati për zbatimin e rekomandimit:	<p>Deri në datë 31.03. 2020</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

- Gjetja 8:** Në relacionin shoqërues të pasqyrave financiare të vitit 2018, nuk ka një analizë të detajuar të kategorive të përfituesve që përbëjnë shumën 7,543,983,113.92 lekë pasqyruar në zërin “Të tjera kërkesa debitore”.
- Situata:** Në pasqyrat financiare të vitit 2018, dërguar në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë me nr.2285 prot, datë 26.03.2019, në klasën 4, në zërin “Të tjera kërkesa debitore”, debitorët nëorganet e sigurimeve shoqërore, për vitin ushtrimor 2018, paraqiten në shumën 7,543,983,113.92 lekë, nga 6,742,028,913.65 lekë që rezultojnë në vitin 2017. Nga viti 2017 në vitin 2018 debitorët janë shtuar në shumën 801,954,200.27 lekë. Në relacionin shoqërues të pasqyrave financiare sqarohet se shuma debitore prej 7,543,983,113.92 lekë, përfaqëson debitorë nga kontributet në shumën 1,560,339,000 lekë dhe debitorë nga përfitimet në shumën 5,893,644,000 lekë. Nga të dhënat statistikore, të marra nga drejtoria e financës, gjendja e mbetur e minatorëve debitorë, në fund të vitit 2018 rezultojnë të jetë 486,359,745 lekë, nga 5,893,644,000 lekë që është shuma totale e debitorëve nga përfitimet, ndërkohë që në relacionin shoqërues të pasqyrave financiare të vitit 2018, nuk ka një analizë se cilat janë kategoritë e debitorëve nga përfitimet që përbëjnë shumën 5,893,644,000 lekë.
- Kriteri:** Ligji nr.9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar;
-UMFE nr.8 datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.
- Ndikimi:** Informacion jo i plotë mbi situatën financiare të ISSH.
- Shkaku:** Zbatimi jo i plotë i kërkesave të Ligjit nr.9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar dhe UMFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.
- Rëndësia:** I mesëm
- Rekomandimi 8:** Drejtoria e Financës të marrë masa që në hartimin e pasqyrave financiare të vitit 2019, të analizojë zërin “Të tjera kërkesa debitore”, sipas të gjitha kategorive të përfituesve që e përbëjnë atë dhe në mënyrë të vecantë, të saktësojë shumën e përfitimeve për kategorinë e punonjësve që kanë punuar në minierë në nëntokë.
- Afati për zbatimin e rekomandimit:** Deri në 31.03.2020

B. Verifikimi i rregullshmërisë dhe saktësisë së basës së të dhënave për përfituesit e pensionit që kanë punuar në minierë, në nëntokë.

Ish minatorëve në RSH, përveç përfitimeve të përcaktuara në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, u sigurohen edhe përfitime të tjera, të financuara nga buxheti i shtetit, si më poshtë:

- a) pension për shkak të profesionit, pagesa të parakoshme për minatorët, të cilat burojnë nga:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

- Ligji nr.8685 datë 09.11.2000 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, dhe
- Ligji nr.150/2014 datë 24.11.2014 “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë”.

b) shtesë mbi pensionin e pleqërisë, që buron nga:

- Ligji nr.29/2019 datë 23.05.2019 “Për trajtimin financiar, suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji”

Sipas këtyre tre ligjeve është bërë edhe identifikimi i përfituesve respektiv në vijim.

A. Përfitues me ligjin nr.8685 datë 09.11.2000

Ligji nr.8685 datë 09.11.2000 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, në nenin 4 të tij përcakton se “E drejta e ushtrimit të kërkesës për përfitime nga ky ligj mund të ushtrohet nga subjektet që përfitojnë deri më datë 31.03.2001.” Grupi i auditimit ka kërkuar dhe i është vënë në dispozicion databaza e minatorëve që u është miratuar përfitimi sipas këtij parashikimi ligjor dhe që sot rezultojnë aktiv. Në tabelën nr.1 më poshtë është bërë pasqyrimi i këtyre përfituesve në dy momente sipas rajoneve, në vitin 2002 që përfaqëson momentin fillestar dhe në vitin 2019.

Nga informacioni vënë në dispozicion konstatohet se numri i përfituesve të trajtimit të vecantë në vitin 2002 ka qënë 5,326.

Nga informacioni i gjeneruar nga sistemi në datë 25.11.2019, konstatohet se sot përfitojnë trajtim të veçantë 147 minatorë.

Përfitues të trajtimit të vecantë sipas ligjit nr.8685

Tabela nr.7

Rajoni	Numër Përfituesish 2002	Numër Përfituesish 2019
Berat	2	-
Dibër	1,105	1
Durrës	174	9
Elbasan	289	7
Fier	18	1
Gjirokastrë	220	2
Korçë	962	16
Kukës	598	6
Lezhë	318	2
Sarandë	-	-
Shkodër	152	2
Tiranë	1,362	99
Tropojë	-	2
Vlorë	126	-
Totali	5,326	147

Burimi: ISSH

Gjatë auditimit është kërkuar dhe vënë në dispozicion nga Drejtoria e Burimeve të Informacionit databaza e minatorëve që kanë përfituar trajtim të veçantë nga ligji nr.8685 datë 09.11.2000, të dhënat e të cilëve janë hedhur në sistemin informatik në vitin 2012. Në këtë moment rezulton të jenë hedhur në sistem të dhënat për 4,430 përfitues të trajtimit të veçantë, pasqyruar në tabelën nr.2 sipas rajoneve. Në tabelën e mëposhtme është pasqyruar edhe numri i subjekteve që nuk përfitojnë më të ardhura nga ky ligj, në total 2,046 subjekte si



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

pasojë e arsyeve të ndryshme pasqyruar në mënyrë të detajuar në tabelën nr.3 që janë: “mbyllje nga auditimi”, “nuk ka kushte”, “pezullime”, “fillon punë”, “vdekje” dhe “transferime në rajon tjetër”.

Përfitues pensioni sipas rajoneve në bazë ligjit nr.8685 datë 09.11.2000.

Tabela nr.8

Rajoni	Numër Përfituesish Aktiv	Numër Përfituesish kaluar në 150/2014	Numër Përfituesish Mbyllur	Total
Berat	-	-	1	1
Dibër	1	-	785	786
Durrës	9	-	208	217
Elbasan	7	179	34	220
Fier	1	20	5	26
Gjirokastrë	2	155	9	166
Korçë	16	586	125	727
Kukës	6	211	85	302
Lezhë	2	157	57	216
Sarandë	-	21	2	23
Shkodër	2	88	23	113
Tiranë	99	653	673	1,425
Tropojë	2	98	32	132
Vlorë	-	69	7	76
Totali		2,237	2,046	4,430

Burimi: Drejtoria e Burimeve të Informacionit, ISSH.

Ligji nr.150/2014 datë 24.11.2014, në nenin 9 të tij “E drejta për të zgjedhur përfitimim” parashikon se “Personat që përfitojnë trajtim të veçantë financiar si punonjës të minierave të nëntokës, sipas ligjit nr. 8685, datë 9.11.2000, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, të ndryshuar, që plotësojnë kushtet e këtij ligji, kanë të drejtë të zgjedhin mes përfitimimit që kanë dhe përfitimimit që u lind nga ky ligj.”

Gjatë auditimit është kërkuar dhe vënë në dispozicion nga Drejtoria e Burimeve të Informacionit databaza e minatorëve që kanë përfitur trajtim të vecantë sipas ligjit nr.8685, që kanë zgjedhur të trajtohen sipas ligjit nr.150/2014 sikurse është citur më sipër.

Kjo databazë e gjeneruar nga sistemi datë 25.11.2019 përbëhet nga 2,237 subjekte, pasqyruar edhe në tabelën 2 dhe 3.

Nga testimi i 57 subjekteve të kategorisë “transferuar në rajon tjetër” konstatohet se:

- 30 prej tyre kanë zgjedhur të trajtohen me ligjin 150/2014 të papërfshirë në këtë databazë, çka e rrit këtë numër në 2,267 subjekte;
- 2 prej tyre përfitojnë ende nga ligji 8685, dhe gjenden edhe në listën e subjekteve aktive;
- 1 transferuar dhe i mbyllur;
- 22 prej tyre kanë kaluar në trajtim sipas ligjit 7703;
- 2 prej tyre kanë vdekur.

Përfitues pensioni sipas kategorive të sistemit në bazë ligjit nr.8685 datë 09.11.2000

Tabela nr.9

Kategoritë	Numër Subjektsh 8685
Aktiv 2019	147
Kaluar në trajtim sipas ligjit 150/2014	2,237
Mbyllur nga auditimi	1,392
Nuk ka kushte	426



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Pezullim	90
Fillon punë	37
Transferuar në rajon tjetër	57
Vdekje	44
Total	4,430

Burimi: Drejtoria e Burimeve të Informacionit, ISSH.

Nga kryqëzimi i tre kategorive “Mbyllur nga auditi”, “Nuk ka kushte” dhe “Pezullim” të dy databazave vëna në dispozicion, asaj të përfituesve me ligjin 8685 dhe asaj të përfituesve të ligjit 150/2014, konstatohet se 42 përfitues sipas ligjit 150/2014 të cilëve u është ndërprerë përfitimi nga strukturat e ISSH pas vitit 2015 në databazën e këtij ligji, rezultojnë të dubluar edhe në databazën e përfituesve që u është ndërprerë përfitimi para vitit 2015 si trajtim i veçantë.

Kryqëzim i përfituesve të mbyllur nga dy ligjet e veçanta të minatorëve

Tabela nr.10

Kategoritë	Numër Përfituesish 8685	Numër Përfituesish 150/2014	Dublime Përfituesish në dy databazat	Numër Përfituesish 8685 pas sistemimeve
Mbyllur nga auditi	1,392	25	14	1,378
Nuk ka kushte	426	31	10	416
Pezullim	90	26	18	72
Total	1,908	82	42	1,866

Burimi: KLSH

B. Përfitues me ligjin nr.150/2014 datë 24.11.2014

Gjatë auditimit është kërkuar dhe vënë në dispozicion nga Drejtoria e Burimeve të Informacionit, databaza e minatorëve që kanë bërë kërkesë dhe kanë përfitur pension sipas parashikimeve të ligjit nr.150/2014 datë 24.11.2014 “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë”.

Ligji nr.150/2014 datë 24.11.2014 “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë”, në nenin 5 të tij parashikon se “Personi, i cili kërkon të përfitojë pension, sipas përcaktimeve të këtij ligji, e përfiton atë nga data e lindjes së të drejtës për përfitim, kur kërkesa paraqitet brenda një viti nga data e lindjes së kësaj të drejte dhe nga data e paraqitjes së kërkesës, kur ajo paraqitet pas një viti pas lindjes së të drejtës për përfitimin e pensionit.” Grupi i auditimit ka kërkuar dhe i është nën dispozicion databaza e minatorëve që kanë bërë kërkesë dhe u është miratuar përfitimi sipas këtij parashikimi ligjor, dhe pas përpunimit të tij ka rezultuar një numër total prej 4,168 përfituesish në harkun kohor 2015-2019 të shpërndarë sipas rajoneve pasqyruar në tabelën më poshtë, prej të cilëve janë **sot aktiv pra që përfitojnë pension nga skema e Ligjit nr.150/2014 datë 24.11.2014 3,177 individë**, dhe 991 prej tyre sot nuk përfitojnë të ardhura nga ky ligj si pasojë e arsyeve të ndryshme pasqyruar në tabelën më poshtë që janë: pezullime apo mbyllje nga njësia e inspektimit, fillim marrëdhënie pune, kalim në lloj tjetër pension dhe vdekje.

Përfitues pensioni sipas rajoneve në bazë ligjit nr.150/2014 datë 24.11.2014.

Tabela nr.11

Rajoni	Numër Përfituesish Aktiv	Numër Përfituesish Mbyllur	Total
--------	--------------------------	----------------------------	-------



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Berat	-	-	-
Dibër	619	167	786
Durrës	233	73	306
Elbasan	218	51	269
Fier	18	11	29
Gjirokastrë	170	32	202
Korçë	493	206	699
Kukës	295	62	357
Lezhë	158	40	198
Shkodër	56	36	92
Tiranë	792	274	1,066
Vlorë	125	39	164
Totali	3,177	991	4,168

Burimi: Drejtoria e Burimeve të Informacionit, ISSH.

Databaza e përfituesve të sotëm dhe atyre që tashmë nuk përfitojnë më pension sipas parashikimeve të ligjit nr.150/2014 datë 24.11.2014, e përpunuar në bazë të kategorive të hedhura në sistem rezulton si në tabelen nr.6 më poshtë. Sikurse shihet tabela e evidenton 7 kategori, prej të cilave vetëm kategoria “Aktiv” përfaqëson individët që sot përfitojnë dhe 6 kategoritë e tjera përfaqësojnë subjekte pasive. Nga sqarimet respektive të bëra nga Njësia e Inspektimit rezulton se kategoritë “mbyllur nga auditi”, “nuk ka kushte” dhe “pezullim” përfaqësojnë të njëjtin veprim që është “ndërprerje e pagesës pas verifikimeve të strukturave të ISSH”. Sa më sipër konstatohet se sipas sistemit informatik PCAMStë ISSH rezultojnë të ndërprera 82 pensione minatorësh në harkun kohor 2015-2019, pas verifikimeve të bëra nga vet strukturat e ISSH. Gjithashtu janë ndërprerë 778 pensione si pasojë e kalimit në një lloj tjetër pensioni, 42 pensione janë ndërprerë si pasojë e lidhjes së marrëdhënies së punës dhe 89 pensione janë ndërprerë si pasojë e vdekjes.

Përfitues pensioni sipas kategorive në sistemin informatik PCAMS në bazë ligjit nr.150/2014 datë 24.11.2014.

Tabela nr.12

Kategoritë	Numër Subjektsh 150/2014
Aktiv 2019	3,177
Mbyllur nga audit	25
Nuk ka kushte	31
Pezullim	26
Fillon punë	42
Kalon lloj tjetër pensioni	778
Vdekje	89
Total	4,168

Burimi: Drejtoria e Burimeve të Informacionit, ISSH.

Nga testimi me zgjedhje i databazave të 5 rajoneve, gjeneruar në raportin e vënë në dispozicion nga Drejtoria e Burimeve të Informacionit, që janë Fier, Lezhe, Elbasan, Gjirokastrë dhe Tiranë, u konstatua se 29 subjekte gjendeshin njëkohësisht në dy kategori, në kategorinë “aktiv 150/2014” dhe në kategorinë “kaluar në pension tjetër”. Pas verifikimeve të bëra në sistem u konstatua se këto subjekte kanë kaluar në pension tjetër dhe përfitojnë pension vetëm sipas ligjit 7703 datë 11.5.1993. Sa më sipër konstatohet se raporti me databazën e përfituesve aktual aktiv të ligjit 150/2014 vënë në dispozicion nga Drejtoria e Burimeve të Informacionit ka pasaktësi.

Testim në raportin përfitues sipas ligjit 150/2014.

Tabela nr.13



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Rajoni	Popullata	Përsëritje emrash në raportin e gjeneruar për 150/2014
Elbasan	218	27
Fier	18	0
Lezhë	158	0
Gjirokastër	170	1
Tiranë	792	1
Total	1,356	29

Burimi: KLSH

Nga kryqëzimi i dy databazave, asaj të “përfitues 8685 kaluar në 150/2014” me “përfitues me 150/2014 në total (aktiv dhe të mbyllur)”, të 5 rajoneve, gjeneruar në dy raporte vënë në dispozicion nga Drejtoria e Burimeve të Informacionit, për rajonet Fier, Lezhe, Elbasan, Gjirokastër dhe Tiranë, u konstatua se 118 subjekte “përfitues 8685 kaluar në 150/2014” nuk gjenden në databazën “përfitues me 150/2014 në total (aktiv dhe të mbyllur)”. Sa më sipër konstatohet se databaza e përfituesve nga ligji nr.150/2014 vënë në dispozicion ka paskatësi.

Kryqëzim i dy raporteve për 5 rajone.

Tabela nr.14

Rajoni	“Përfitues 8685 kaluar në 150/2014” që nuk gjenden në “përfitues me 150/2014 në total”
Elbasan	8
Fier	4
Lezhë	17
Gjirokastër	20
Tiranë	69
Total	118

Burimi: KLSH

C. Përfitues me ligjin nr.29/2019 datë 23.05.2019

Ligji nr.29/2019 datë 23.05.2019 “Për trajtimin financiar, suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji”, në nenin 4 përcakton se “minatorëve u sigurohen përfitime suplementare, mbi ato të përcaktuara në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993, si më poshtë: a) pension për shkak të profesionit (llojit të punës); b) shtesë mbi pensionin e pleqërisë;”

Pensioni për shkak të profesionit të minatorit, pra trajtimi me përfitime përpara moshës dhe kushteve të përcaktuara në dispozitat e ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, do të vazhdojë të bëhet sipas përcaktimeve në dispozitat e ligjit nr.150/2014.

Shtesa mbi pensionin e pleqërisë për çdo vit periudhe sigurimi në profesion me 1 % të masës së pensionit të pleqërisë për punonjësit e nëntokës, do të bëhet nga data e lindjes së të drejtës për përfitim, kur kërkesa paraqitet brenda një viti nga data e lindjes së kësaj të drejte dhe nga data e paraqitjes së kërkesës, kur ajo paraqitet pas një viti pas lindjes së të drejtës për përfitimin e pensionit.

Grupi i auditimit ka kërkuar dhe i janë vënë në dispozicion nga Drejtoria e Përfitimeve kërkesat e minatorëve për përfitim deri më datë 22.11.2019, nga parashikimet e ligjit nr.29/2019 datë 23.05.2019 “Për trajtimin financiar, suplementar të punonjësve që kanë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji”.

Nga informacioni vënë në dispozicion konstatohet se deri më datë 05.12.2019 kanë bërë kërkesë për përfitim sipas parashikimeve të ligjit 29/2019, si ish minatorë 10,965 individë, të ndarë sipas rajoneve në tabelën nr.9 më poshtë, prej të cilëve janë verifikuar 1,254 individë, për të cilët ka filluar dhe pagesa.

Kërkesa për përfitim nga ligji 29/2019, si ish minatorë deri më datë 05.12.2019.

Tabela nr.15

Rajoni	Numër kërkesash	Përfitime të caktuara
Berat	16	2
Dibër	1,195	336
Durrës	646	13
Elbasan	633	41
Fier	71	10
Gjirokastrë	762	72
Korçë	2,391	155
Kukës	459	112
Lezhë	871	96
Shkodër	463	166
Tiranë	2,655	123
Vlorë	462	82
Tropojë	197	16
Sarandë	144	30
Totali	10,965	1,254

Burimi: Drejtoria e Përfitimeve, ISSH

Në lidhje me problematikën e mësipërme, trajtuar në projekt raportin e auditimit, nga ISSH janë paraqitur sqarimeme shkresën nr.7719/3, prot, datë 23.12.2019, protokolluar në KLSHme nr.919/3, datë 24.12.2019, me këtë përmbajtje:

Në lidhje me raportimin e të dhënave nga data baza, në radhë të parë ju kërkojmë ndjesë për informacionin e dhënë për numrin e personave që trajtohen ose janë trajtuar me TVM nga sistemi PCAMS pasi jemi keqkuptuar në kërkesat dhe për shkak të një problemi shëndetësor madhor administratori i sistemit nuk ka qënë gjatë periudhës së auditimit. Ju sqaroj se baza e të dhënave të pensioneve në sistemin informatik aktual PCAMS ka filluar të popullohet me të dhëna në vitin 2012 dhe janë hedhur të dhënat me operatorë duke u nisur nga dosjet stok. Në këtë kohë u hodhën edhe të dhënat e dosjeve të TVM që ishin aktive, pra që paguheshin si dhe dosjet që ishin të pezulluara apo mbyllura me qëllim evidentimin e tyre për të shmangur lidhjen e një përfitimi tjetër pa ju evidentuar debia dhe mbajtja e debisë kur të përfitonin nga ndonjë skemë tjetër. Vlen të theksohet se në atë kohë të dhënat mbaheshin në bazë rajonale në formatin excel gjë që nuk të mundësonte kontrollin total të lidhjes së përfitimeve. Nisur nga aktkonstatimi juaj ju kërkua rajoneve që të dërgonin të dhënat nga regjistrat në letër për përfituesit e TVM dhe ndryshimet që kanë ndodhur. Nga këto ka rezultuar që deri në vitin 2012 kanë kaluar nga trajtim i vecantë në një trajtim tjetër nga ligji 7703, gjithsej 844 persona dhe kanë vdekur gjatë kësaj periudhe 59 persona. 37 persona kanë ndërprerë trajtimin për shkak të punësimit dhe të vetë punësimit. Trajtime të veçanta aktive që paguheshin në vitin 2014 para se të dilte ligji 150/2014 kanë qënë 3573 persona (kjo shifër është marrë nga llogaritjet që janë bërë për efektet financiare të ligjit 150/2014). 207 vetë kanë kaluar në një pension tjetër sipas ligjit 7703 nga 2012 – 2014 dhe 774 persona janë debitorë që vilen apo presin për tu vjelë. Nga numri 5527 që ka qënë në fillim po të zbresim të gjitha sa më sipër rezulton që 33 persona nuk kanë status dhe mendojmë se mund të kenë ndërrura jetë gjatë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

periudhës 2012-2014 ose kanë shlyer debinë dhe nuk janë të evidentuar. Për këta persona do të kontrollohet dhe të sistemohen. Përsa i përket të dhënave nga sistemi PCAMS. Siç e shpreha edhe më sipër të dhënat janë hedhur në vitin 2012 dhe numri total që janë hedhur është 4396 përfitime nga të cilët 148 vetë vazhdojnë të përfitojnë trajtimin e veçantë pasi nuk kanë mbushur moshën e daljes në pension sipas 150/2014, 3214 persona kanë kaluar në përfitim sipas ligjit 150/2014, 774 janë debitorë në financë që vilen ose priten të futen në skemë që të vilet debia, 207 persona që kanë kalur në përfitim tjetër nga 2012 deri 2014, 13 persona të hedhur në vitin 2012 kanë qënë të vdekur pasi NID i tyre është AB....., që është një NID për persona të vdekur si dhe 40 persona kanë ndërruar jetë gjatë viteve 2012-2014. Ju sqaroj se të dhënat e dhëna në datën 25 janë të gjeneruara sipas rajoneve dhe agjensive ndërsa të dhënat që po ju nisim janë gjeneruar duke hequr kufizimin e rajonit dhe përdorur si çelës vetëm NID-in me qëllim shmangjen e rasteve që janë transferuar nga një rajon në tjetrin. Kjo pasi nëse ruhet kufizimi rajon atëherë sistemi i numëron aq herë sa janë sa i gjen dhe për pensionet e transferuara i numëron në të dy apo tre rajonet ku kanë qënë të regjistruar apo paguar. Bashkangjitur, do të gjeni listat në exel të të dhënave të mësipërme. Duke ju falënderuar për të gjithë ndihmesën, rekomandimet dhe diskutimet që kemi bërë në funksion të përmirësimit të punës, ju lutem të vlerësoni punën e drejtuesve kryesor dhe shumë pak njerëzve të tjerë drejtues të përkushtuar për luftën kundër informalitetit dhe falsitetit, e cila gjithmonë mbetet prezent sa kohë të ketë dokumente para 1994, të keq ruajtura dhe të keq evidentuara nga ndërmarrjet. Ne do të ndjekim dhe evadojmë debitor, ata do të vijnë në skemë dhe do të marrin gjysmën e përfitimit deri në larjen e borxheve për të mos u bërë barrë e shtetit. Ndër të tjera, për sa kam dijeni më lejoni të evidentojmë se “disa përfaqësues të minatorëve” 5-6 vetë kishin hartuar një status që së paku do të arrinte të kushtonte rreth 120 milionë dollarë deri në përfundim, duke futur si përfitues të pensioneve të parakohshme etj., persona me 7 vite punë në minierë. Kjo gjë jo vetëm nuk është lejuar, por është mbrojtur dhe abroguar me forcë nga Drejtuesit e ISSH, sepse jo vetëm do të krijonte kosto dhe barrë të pa legjitimuar për brezat, për femijet, do të krijonte pabarazi të reja dhe thellonte ato tashmë të njohura, por do të fuste në skemë mbi 95 % të atyre falsifikatorëve të cilëve u janë rrëzuar përfitimet TMV etj. dhe tashmë gjenden debitor, të kallëzuar, të gjykuar etj.. Sa i përket bazës së të dhënave, përveç sa kemi shpjeguar më lart, lutem duhet të bëhen verifikime sipas periudhave sepse pensionet kalojnë nga një status në tjetrin dhe nga një rajon në tjetrin sipas vendbanimit të personit dhe në të drejtën e tij. Nëse do të dalë e nevojshme atëherë mund të revizionohet dhe dixhitalizojmë të gjithë regjistrat e kërkesave, kthimeve, caktimeve, mbylljeve etj., të cilat gjenden dhe administrohen e ndiqen në DRSSH.

Duke ju falënderuar, lutem merrni në konsideratë shpjegimet për sa gjykohet.

Grupi auditimit pas shqyrtimit të observacionit dhe vënies në dispozicion të evidencave të reja sipas subjektit të sakta, duke vlerësuar angazhimin dhe mirëkuptuar forcat madhore që nuk ndihmuan procesin auditues në terren (shkaqe shëndetësore dhe fatkeqësia natyrore) sqaron se:

Në këtë fazë të procedurës audituese është e pamundur nga ana jonë të rizhillojmë testimet respektive dhe kontrollat e ezauruara gjatë punës në terren në mënyrë që të certifikojmë evidencën e re. Bazuar në rekomandimet tona presim që pasaktësitë e evidentuara të verifikohen dhe sistemohen nga ana juaj para publikimit të listave emërore të përfituesve.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Gjetje : Nga auditimi bazuar në të dhënat e sistemit PCAMS, u konstatua se sot përfitojnë trajtim të veçantë sipas ligjit nr.8685 datë 09.11.2000, ende 147 ish minatorë. Gjithashtu është konstatuar se evidenca e ish minatorëve përfitues sipas ligjit nr.8685 datë 09.11.2000, që kanë zgjedhur të trajtohen në vijim sipas ligjit nr.150/2014 datë 24.11.2014, e vënë në dispozicion ka pasaktësi.

Situata: Gjatë auditimit është kërkuar databaza e minatorëve që kanë përfituar dhe përfitojnë trajtim të veçantë nga ligji nr.8685 datë 09.11.2000 Nga informacioni vënë në dispozicion, konstatohet se numri i përfituesve të trajtimit të veçantë në vitin 2002 ka qënë 5,326. Nga auditimi bazuar në të dhënat e sistemit PCAMS u konstatua se sot përfitojnë trajtim të veçantë ende 147 minatorë.

Gjatë auditimit është kërkuar dhe vënë në dispozicion nga Drejtoria e Burimeve të Informacionit databaza e minatorëve që kanë përfituar trajtim të veçantë nga ligji nr.8685 datë 09.11.2000, të dhënat e të cilëve janë hedhur në sistemin informatik PCAMS me krijimin e tij në vitin 2012. Në këtë moment rezultojnë të jenë hedhur në sistem të dhënat për 4,430 përfitues të trajtimit të veçantë, aktiv dhe të mbyllur. Bazuar në evidencën e vënë në dispozicion datë 25.11.2019 prej tyre sot 2237 përfitues kanë zgjedhur të trajtohen me përfitim sipas ligjit 150/2014 dhe 2046 prej tyre rezultojnë të mbyllur.

Nga testimi i të dhënave u konstatua se lista e përfituesve ndër vite të ligjit nr.8685 datë 09.11.2000, të cilët kanë zgjedhur të trajtohen më pas sipas ligjit 150/2014 ka pasaktësi.

Nga testimi i të dhënave të listës së përfituesve sipas ligjit nr.8685 datë 09.11.2000, që u është ndërprerë pagesa nga strukturat e ISSH u konstatua se ka pasaktësi. Sipas evidencës së vënë në dispozicion rezultojnë se janë ndërprerë nga vet ISSH 1,908 pensione, ndërkohë që nga verifikimet e bëra pas testimeve ky numër konstatohet të jetë 1,866.

Kriteri: Ligji nr.8685 datë 09.11.2000 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, ndryshuar me ligjin nr.9356, datë 17.3.2005, nr.9706, datë 5.4.2007;

Ligji nr.150/2014 datë 24.11.2014 “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë”;

VKM nr.73 datë 15.2.2001 “Për kriteret dhe masën e trajtimit të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në minierë, nëntokë”;

Ligji nr.119/2014 datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”.

Ndikimi/Efekti: Mungesë transparence ndaj grupeve të interesit.

Shkaku: Pasaktësi në evidenca.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: a) Njësia Inspektimit në ISSH të kalojë në një proces shqyrtimi/certifikimi 147 dosjet e personave përfitues të Ligjit nr.8685, datë 09.11.2000, të cilët aktualisht rezultojnë aktiv në skemë.

b) ISSH të identifikojë numrin e saktë të ish përfituesve sipas Ligjit nr.8685 datë 09.11.2000, që sot trajtohen me përfitim sipas Ligjit nr.150/2014 datë 24.11.2014.

c) Në përfundim të procesit, për të garantuar transparencën ndaj grupeve të interesit të publikojë në faqen zyrtare të ISSH listat emërore të personave përfitues aktiv sipas Ligjit nr.8685, datë 09.11.2000.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Gjetje : Nga kryqëzimi dhe testimi me zgjedhje i evidencave të vëna në dispozicion, gjeneruar nga sistemi PCAMS, të përfituesve të ligjit nr.150/2014 datë 24.11.2014, është konstatuar se evidenca e përfituesve aktual aktiv të ligjit 150/2014 vënë në dispozicion nga Drejtoria e Burimeve të Informacionit ka pasaktësi, për rrjedhojë është e pamundur identifikimi i numrit të saktë total të përfituesve nga ky ligj. Gjithashtu nga auditimi është konstatuar se në sistemin PCAMS për të njëjtën kategori përfituesish “subjekte që u ndërpritet përfitimi pas verifikimeve të vet strukturave të ISSH” ekzistojnë në sistem 3 kategori të ndryshme, duke rezultuar në një praktikë të paunifikuar të hedhjes së të dhënave në sistem, çka shkakton konfuzion dhe keq interpretim të shifrave.

Situata:

Grupi i auditimit ka kërkuar dhe i është vënë në dispozicion evidenca me minatorët që kanë bërë kërkesë dhe u është miratuar përfitimi sipas parashikimeve të ligjit nr.150/2014 datë 24.11.2014, ku pas përpunimit të sajkonstatohet se një numër total prej 4,168 përfituesish në harkun kohor 2015-2019 të shpërndarë në 11 rajone, prej të cilëve sot janë aktiv, pra përfitojnë pension nga skema sipas këtij ligji 3,177 individë, dhe 991 prej tyre sot nukpërfitojnë të ardhura nga ky ligj si pasojë e pezullimeve apo mbyllje nga njësia e inspektimit, fillimit të marrëdhënies të punës apo kalimit në lloj tjetër pensioni dhe vdekjes.

Në sistemin PCAMS informacioni për këta përfitues evidentohet i ndarë në 7 kategori, prej të cilave vetëm kategoria “Aktiv” përfaqëson individët që sot përfitojnë nga ky ligj dhe 6 kategoritë e tjera përfaqësojnë subjekte pasive sipas këtij ligji. Nga auditimi është konstatuar se kategoritë “mbyllur nga auditimi”, “nuk ka kushte” dhe “pezullim” përfaqësojnë të njëjtin veprim që është “ndërprerje e pagesës pas verifikimeve të strukturave të ISSH”. Sa më sipër konstatohet se sipas evidencës gjeneruar nga sistemi PCAMS i ISSH rezultojnë të ndërprera 82 pensione minatorësh në harkun kohor 2015-2019, pas verifikimeve të bëra nga vet strukturat e ISSH. Gjithashtu janë ndërprerë 778 pensione si pasojë e kalimit në një lloj tjetër pensioni, 42 pensione janë ndërprerë si pasojë e lidhjes së marrëdhënies së punës dhe 89 pensione janë ndërprerë si pasojë e vdekjes.

Nga testimi me zgjedhje i databazave të 5 rajoneve, Fier, Lezhe, Elbasan, Gjirokastrë dhe Tiranë, gjeneruar në raportin e vënë në dispozicion nga Drejtoria e Burimeve të Informacionit, u konstatua se 29 subjekte gjendeshin njëkohësisht në dy kategori, në kategorinë “aktiv 150/2014” dhe në kategorinë “kaluar në pension tjetër”. Pas verifikimeve të bëra në sistem u konstatua se këto subjekte kanë kaluar në pension tjetër dhe përfitojnë pension vetëm sipas ligjit 7703 datë 11.5.1993. Sa më sipër konstatohet se evidenca e përfituesve aktual aktiv të ligjit 150/2014 vënë në dispozicion nga Drejtoria e Burimeve të Informacionit ka pasaktësi.

Nga kryqëzimi i dy databazave, asaj të “përfitues 8685 kaluar në 150/2014” me “përfitues me 150/2014 në total (aktiv dhe të mbyllur)”, të 5 rajoneve, Fier, Lezhe, Elbasan, Gjirokastrë dhe Tiranë, gjeneruar në dy raporte vënë në dispozicion nga Drejtoria e Burimeve të Informacionit, u konstatua se 118 subjekte “përfitues 8685 kaluar në 150/2014” nuk gjenden në databazën “përfitues me 150/2014 në total (aktiv dhe të mbyllur)”. Sa më sipër, mbështet konstatimin e bërë se evidenca e përfituesve aktiv nga ligji nr.150/2014 vënë në dispozicion ka pasaktësi e për rrjedhojë është e pamundur identifikimi i numrit total të përfituesve nga ky ligj.

Kriteri:

Ligji nr.150/2014 datë 24.11.2014 “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë”;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

VKM nr.78 datë 28.01.2015 "Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë";

Ligji nr.119/2014 datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”.

Ndikimi/Efekti: Mungesë transparence ndaj grupeve të interesit.

Shkaku: Gjenerim i të dhënave jo të sakta.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: a) ISSH të marrë masat për identifikimin e saktë të përfituesve aktiv sipas ligjit 150/2014 datë 24.11.2014, të ndarë sipas dy kategorive në “përfitues të ardhur nga ligji nr.8685” dhe “përfitues të rinj”, dhe në përfundim të procesit të publikojë në faqen zyrtarelistën emërore të përfituesve të këtij ligji, për të garantuar transparencën.

b) ISSH të unifikojë praktikat e hedhjes së të dhënave në sistem në të gjitha rajonet, duke përcaktuar qartësisht në një akt administrativ, se si do të përshkruhen në sistem veprime specifike dhe ndryshime të statusit të dosjeve.

C. Vlerësimi i sistemit të kontrollit të brendshëm në lidhje me mbrojtjen e fondin të sigurimeve shoqërore.

1. Mjedisi i Kontrollit

Mjedisi i kontrollit, është baza e menaxhimit të fondeve buxhetore dhe përbën themelin ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm, sipas nenit 20 të Ligjit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Titullarët e njësive publike janë përgjegjës për ngritjen, gjendjen dhe përmirësimin e mjedisit të kontrollit. Nga auditimi u konstatua se, bazuar në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, neni 9 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues”, pika 4, gërma “a” dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. II “Zbatimi i MFK”, pika, 2.2.7 “Roli i nëpunësit autorizues të njësisë”, gërma “a”, institucioni në objektivat strategjike disa vjeçare, ndër prioritetet e tij nuk ka përcaktuar kontrollin dhe monitorimin e trajtimeve të veçanta suplementare dhe planet e veprimit, me njësitë përgjegjëse dhe drejtoritë rajonale si dhe afatet kohore për realizimin e tyre. Sipas strukturës së Drejtorisë së Përgjithshme të ISSH-së, Njësia e Inspektimit të Përfitimeve përbëhet nga sektori i inspektimit të përfitimeve afatgjata dhe sektori i inspektimit të përfitimeve suplementare dhe trajtimeve. Në Rregulloren për organizimin e detyrave funksionale në Drejtorinë e Përgjithshme të ISSH-së nuk janë të përfshirë pozicionet e punës për sektorin e inspektimit të përfitimeve suplementare dhe trajtimeve.

Si konkluzion: Nga auditimi konstatohet se për shkak të ndryshimeve të strukturës dhe të mosreflektimit në Rregulloren e Brendshme të Institucionit, riskohet të mos garantohet ndarja e qartë e detyrave dhe pozicioneve, pasi drejtoritë e ISSH-së kanë funksionuar pa patur një bazë ligjore të miratuar për parashikimin e detyrave dhe përgjegjësive sipas pozicioneve të punës.

2. Menaxhimi i riskut.

Në mbështetje të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 11, “Përgjegjshmëria menaxheriale e menaxherëve të tjerë të njësisë”, pika 2, si dhe në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, kapitulli III, pika 3.2 “Menaxhimi i Riskut”, si dhe nenit 10 të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 specifikohet se koordinatori i riskut, duhet të jetë Nënpunësi Autorizues, ose kjo detyrë të delegohet. Në përputhje me të, nëpunës autorizues i ISSH-së është Drejtori i Përgjithshëm, por përgatitja e dokumentacioneve përkatës është deleguar tek Zv/Drejtori i Përgjithshëm. ISSH ka përgatitur Raportin e Veprimtarisë së Njësisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2019, ku së bashkë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

me risqet e drejtorisë së auditimit të brendshëm, është dërguar edhe harta e riskut për Institutin e Sigurimeve Shoqërore. Në këtë dokument është paraqitur përshkrimi i risqeve për çdo drejtori, niveli i risqeve, kontrollet ekzistuese, veprimet e ndërmarra për të adresuar risqet si dhe zotëruesi i riskut. Nga auditimi konstatohet se risqet e parashtruar në këto dokumente janë kryesisht të përgjithshëm dhe nuk janë vlerësuar sipas drejtorive. Nga këto dokumente rezulton se një ndër risqet kryesore është ai i informatizimit të institucionit, si dhe garantimi i kapaciteteve të nevojshme për implementimin dhe vënien në zbatim të sistemeve. Gjithashtu, buxheti i ISSH-së ka veçori në disa tregues, dhe megjithëse me efekte të konsiderueshme financiare, bazohet në parashikime specifike, që bartin edhe risqe e pasaktësi në programim. Këtu evidentojmë parashikimin e numrit të pensioneve të reja dhe sidomos parashikimin e përfitimit mesatar vjetor të këtyre pensioneve.

Rregjistri i riskut ka filluar të plotësohet në vitin 2011, pas daljes së Ligjit nr.10296, datë 08/07/2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Me shkresë nr. 8904 prot, datë 11.2.2015; nr. 1063 prot, datë 05.02.2016; nr. 223 prot, datë 10.2.2017; nr. 210/1 prot, datë 12.2.2018; 269/1 prot, datë 12.2.2019 është dërguar përkatësisht sipas viteve Raporti i veprimtarisë së Auditit të Brendshëm të ISSH-së në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm pranë Ministrinë së Financave dhe Ekonomisë, duke pasur parasysh risqet e periudhave të mëparshme si dhe faktorë të tjerë të cilët mund të shfaqeshin si: avancimi i reformave të ndryshme qeveritare, përmirësimi i teknologjisë së avancuar, hedhja dhe pasqyrimi i vjetërsisë së punës të ish kooperativave bujqësore si dhe i ndërmarrjeve që kanë mbyllur aktivitetin, hedhja e të dhënave e të vetpunësuarve, grumbullimi i dokumentacionit nga Arkiva Shtetërore Vendore dhe ndërmarrjet e mbyllura e çertifikimi i tyre, etj. Për vitin 2019 janë evidentuar me risk në total 12 ngjarje të mundshme dhe vlerësim të përgjithshëm/i mesëm.

Regjistri i riskut është hartuar dhe ndjekur nga një sektor i veçantë në drejtorinë e auditit. Drejtoria e përfitimeve ka vlerësuar me risk: vonesat në mënyrën e llogaritjes së pensioneve, moszbatimin e drejtë të VKM-ve “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, nga rritja e çmimit të energjisë elektrike”, i ndryshuar, aplikimi i kërkesave për përfitim. DAB ka vlerësuar me risk: mungesën e një audituesi të brendshëm ekspert në fushën e IT-së, mosnjohjen e mjaftueshme të procedurave dhe standarteve të BE lidhur me auditimin e fondeve të BE-së, përgatitjen e raporteve nga ana e ndërtimit gjuhësor dhe sintaksorë, kuptimi jo i drejtë i AB, ekzistenca e DRSSH-ve që janë me bilanc.

I njëjti vlerësim është bërë edhe për vitin 2017 dhe për vitin 2018. Pra, asnjë prej drejtorive që ka objekt kontrollin, inspektimin dhe çertifikimin e pensioneve të trajtimeve të veçanta suplementare nuk është vlerësuar me risk, edhe pse këto vite ka pasur ndryshim të legjislacionit, problematika dhe efekte financiare nga zbatimi i tyre për këtë kategori përfituesish.

Konstatohet se ISSH ka përgatitur regjistër risku ndër vite, por nuk ka shërbyer për të identifikuar, analizuar, vlerësuar, trajtuar, monitoruar dhe komunikuar risqet kryesore që shoqërojnë përgjegjësitë e ISSH-së me qëllim minimizimin e ngjarjeve negative të paparashikuara dhe maksimizimin e mundësive.

Regjistri i riskut në ISSH nuk është hartuar e mbështetur në Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik- Informacion i zgjeruar për Menaxhimin e Riskut Institucional” dhe në Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”. Regjistri gjithashtu nuk i referohet përgjegjësive dhe objektivave të vendosura të ISSH -së. Punonjësit duhet të kryejnë trajnime në fushën e përdorimit të metodikës së pranuar në identifikimin e riskut dhe vlerësimin e tij, dhe se është detyrim i çdo punonjësi të raportojë për çdo ngjarje pozitive apo negative.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se regjistri i riskut është jo i plotë, sepse nuk e përfshin gjithë ISSH.

3. Aktivitetet e Kontrollit

Legjislacioni në fuqi që trajton sistemin e sigurimeve shoqërore dhe skemën e pensioneve në veçanti, ka ngarkuar ISSH si institucion përgjegjës për caktimin (lidhjen) e pensioneve, pagimin, kontrollin e pagesave dhe auditimin e dosjeve përsa i përket ligjshmërisë së tyre. Si gjithë përfitimet e tjera dhe përfitimet e ish minatorëve u janë nënshtruar auditimeve nga Drejtoria e Auditit sipas metodikës kontrollit dhe planeve të kontrollit.

Kontrolli i dosjeve të pensionit, kryhet nga Njësia e Inspektimit të Përfitimeve, e cila bën edhe çertifikimin e tyre. Në kuadër të informatizimit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, shumica e proceseve të regjistrimit, lidhjes dhe ndjekjes së pensioneve ndiqen nga sistemet informatike.

Për punonjësit e minierave të nëntokës për vetë vështirësinë e punës që paraqet puna në miniera, në nëntokë, ka patur një trajtim preferencial nga punonjësit e tjerë të tregut të punës përsa i përket moshës së daljes në pension, si dhe periudhës së përgjithshme të sigurimit, përfshirë këtu edhe atë të nëntokës. ISSH detyrën e administrimit të pensioneve, si caktimin dhe pagesën e tyre e realizon nëpërmjet DRSSH-ve.

Puna në miniera në nëntokë është kategorizuar si punë e kategorisë së parë, sipas VKM-së nr. 526, datë 20.12.1958 “Për ndarjen e punëve në kategori për efekt pensioni”, i ndryshuar.

ISSH ka funksionin e kontrollit të ligjshmërisë dhe këtë e realizon nëpërmjet drejtorisë së Kontrollit në ISSH dhe drejtorive të tjera, të cilat kanë qenë të strukturura sipas viteve si më poshtë:

ISSH prej vitit 2000 ka pasur në strukturën organizative të saj Drejtorinë e trajtimeve të veçanta e suplementare të ndarë në dy sektorë:

a-sektori i përfitimeve,

b-sektori i kontrollit të ligjshmërisë të trajtimeve të veçanta.

Prej vitit 2001-2007 Drejtoria e kontrollit ka qenë e ndarë në dy degë: dega e kontrollit financiar dhe dega e kontrollit të përfitimeve.

Në vitin 2008 e Drejtoria Auditit është ndarë në dy degë:

a. dega e auditimit financiar;

b. dega e auditimit të përfitimeve.

Dega e auditimit të përfitimeve e cila ka qenë pjesë brenda DAB kishte për objekt auditimin dhe çertifikimin e të gjitha llojeve të përfitimeve të caktuara gjatë vitit deri në vitin 2014 dhe ka vazhduar kontrollin e përfitimeve me kontrole tematike deri në vitin 2017. Më pas kjo strukturë kontrolli përfitimesh u shkri dhe punonjësit e saj kaluan si inspektues, në Njësinë e Inspektimit.

Në vitin 2011 u ngrit një strukturë tjetër kontrolli, Dega e Inspektimit të Përfitimeve Afatgjata. Objekti i kësaj njësie ka qenë dhe është kontrolli i ligjshmërisë në caktimin e përfitimeve dhe çertifikimi nga momenti i fillimit të veprimtarisë së saj (dosje të reja).

Kjo njësi është është ngritur me Vendimin nr.6, datë 20.07.2010 të KA-së dhe është njësi kontrolli specifike vetëm për inspektimin e saktësisë së pensioneve të caktuara.

Kjo degë u krijua me 2 sektorë:

a. sektori i inspektimeve të përfitimeve sipas ligjit 7703.

b. sektori i inspektimeve të përfitimeve suplementare dhe trajtimeve të veçanta.

Kjo njësi e kryen inspektimin e dosjeve të përfitimit bazuar në Rregulloren Nr. 1/2, datë 04.03.2011 “Për një shtesë në rregulloren nr.1, datë 21.10.2008 “Për caktimin, administrimin dhe pagesën e pensioneve”.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

❖ Përfitimet e lidhura dhe të caktuara me ligjin nr. 8685 datë 9.11.2000 kanë qenë objekt kontrolli dhe janë kontrolluar për ligjshmërinë nga sektori i kontrollit të ligjshmërisë të trajtimeve të vecanta. Deri në vitin 2000, për shkak se minierat nuk kishin derdhur kontributet, i gjithë dokumentacioni ishte në ndërmarje. Sipas VKM-së nr.73, datë 15.02.2001 “Për kriteret dhe masën e trajtimit të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në minierë, nëntokë”, dokumentacioni i ndërmarrjeve të mbyllura dorëzohet në arkivin e shtetit.

ISSH, nëpërmjet drejtorive rajonale, ka mundur të marrë dokumentacion për minierat, pas vitit 2001, sipas VKM 73 datë 15.2.2001, “Për kriteret dhe masën e trajtimit të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në minierë, nëntokë” pika 4 ku citohet: “*Administratat e minierave dërgojnë pranë agjencive të sigurimeve shoqërore, listëpagesat, për të cilat janë derdhur kontributet për sigurimet shoqërore dhe listëpagesat për periudhat, për të cilat janë debitorë ndaj sigurimeve shoqërore*”.

Caktimi i përfitimeve është bazuar kryesisht në dokumentacionin e përcaktuar në rregullore, por veçanërisht duke qenë një trajtim i veçantë social, dhe në kushtet e mungesës së dokumenteve në DRSSH, si dokumente bazë ishte dokumenti sipas përcaktimeve në pikat 7,8,9 të VKM-së nr. 73/2001, “Për kriteret dhe masën e trajtimit të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në minierë, nëntokë”.

Për këtë periudhë, grupit të auditimit të KLSH-së nuk iu vunë në dispozicion rezultate dhe evidenca auditimi mbi numrin e përfituesve, çertifikimin, vlera e përfitimit, vlera e dëmit.

1. Deri në vitin 2008, kontrollat nga ISSH dhe inspektimet janë bërë me zgjedhje për të gjitha përfitimet, pasi kontrolli i plotë nuk ka qenë i mundur sepse ISSH argumenton se do të duhej një organikë punonjësish katër herë më e lartë. Për trajtimet e veçanta, në periudhën 2000-2007, ka ekzistuar një strukturë inspektimi e cila ishte në vartësi të Drejtorisë së përfitimeve suplementare. Kjo strukturë, ka kryer kontrole dhe inspektime në të gjithë DRSSH-të. Materialet e kontroleve gjenden në arkiv dhe nuk iu vunë në dispozicion grupit tonë të auditimit. Po kështu këto inspektime, kanë konsideruar të mirëqënë dhe përfundimtar vërtetimin e periudhës së sigurimit dhe periudhës së sigurimit në miniera nëntokë, të dhëna nga Ministria e Industrisë (Drejtoria e Minierave dhe e Gjeologjisë).

2. Për shkak të problematikave që reflektonin këto lloje përfitimesh, të cilat janë konstatuar kryesisht nga kontrolli i dosjes në momentin e kalimit nga pension i parakohshëm, ose trajtim në pension të plotë, në vitin 2008 janë filluar kontrollat mbi bazë risku për të ndaluar veprimtarinë informale sa më shpejt të ishte e mundur. Gjithmonë në ISSH ka ekzistuar standarti i inspektimit të përfitimeve të caktuara nga DRSSH-të.

Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka vijuar kontrollin me grupe pune në të gjitha Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore mbi ligjshmërinë e caktimit të pensioneve të pleqërisë dhe invaliditetit, që rrjedhin nga zbatimi i ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” si dhe trajtimeve të veçanta të punëtorëve të nëntokës”.

Bazuar në manualin e auditit të miratuar nga Këshilli Administrativ (i ndryshuar), me urdhër nr. 219/1, datë 09.02.2007; nr. 987, datë 04.05.2007; nr. 1064, datë 14.05.2007; nr 1253, datë 04.06.2007; nr 1253/1 datë 06.06.2007; nr. 1253/2, datë 06.06.2007; nr. 1402 datë 18.06.2007; nr. 1448 datë 21.06.2007 të Drejtores së Përgjithshme të ISSH-së, janë ngritur katër grupe inspektimi si rezultat i bashkëpunimit midis grupit të auditit dhe drejtuesve të drejtorive rajonale për kontrollin e dosjeve të pensionit të pleqërisë, invaliditetit dhe trajtimit të veçantë për punonjësit e nëntokës (ish minatorët), nga të cilat tre në Drejtori Rajonale dhe një grup është ngritur në ISSH. Parimi i kontrollit ka qenë që dosjet e një rajoni do të kontrollohen nga specialistë dhe auditet e një rajoni tjetër dhe verifikimi do të bëhet nga vetë rajonet e kontrolluara.

Objekti i auditimit kanë qenë, të gjitha pensionet e pleqërisë qytet, invaliditetit dhe trajtimet e veçanta të minatorëve të caktuara nga grupet e kontrollit me zgjedhje prej Drejtorive



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Rajonale të Sigurimeve Shoqërore për periudhën nga dosja e fundit e kontrolluar nga drejtoria e kontrollit të ISSH-së dhe deri në 31.12.2009;

Metoda e auditimit: a. Auditimi do të kryhet me grup pune dhe verifikimi i periudhave të sigurimit bëhet nëpërmjet kontrollit alternativ librezë-rregjistër. b. Grupi i audituesve i cilësuar në këtë urdhër do të kontrollojë ligjshmërinë e caktimit të pensionit, dhe do të evidentojë dosje për dosje dokumentat që kanë nevojë për verifikim apo risaktësim. c. Procesi i verifikimit të dokumentacionit të dosjes me dokumentacion bazë arkivi si regjistra, indekse, listëpagesa, libra pagash etj. Kontrolli realizohet nga revizorët e Drejtorive Rajonale mbi bazën e kërkesave për verifikim të hartuara dhe dërguara nga grupi i parë i Audituesve. g. Verifikimi i dokumenteve që origjinën e tyre e kanë në arkivat jashtë DRSSH-së Tiranë, bëhet nga auditet e autorizuar të DRSSH-ve.

Radha e punës ishte: Fillimisht kontrolli i dosjeve të trajtimeve të veçanta, të cilat do të tërhiqeshin nga DRSSH, sipas radhës. Dosjet që nga kontrolli rezultonin me probleme do të mbaheshin pranë zyrës së grupit të auditit. Destinacioni përfundimtar i tyre do të përcaktohet me përfundimin dhe miratimin e raportit përfundimtar të kontrollit. Përgjegjësi i grupit të audituesve njofton Drejtorin e Përgjithshëm të ISSH-së. Norma ditore e një audituesi ishte jo më pak se 30 dosje në ditë të audituara përfundimisht. Procesi i auditimit në drejtorinë e përgjithshme do të ndiqet vazhdimisht duke analizuar periodikisht ecurinë e këtij auditimi, problemet e evidentuara dhe masat e marra për zgjidhjen e tyre.

Ky parim i përdorur për ngritjen e grupeve dhe mënyrën e kryerjes së kontrollit është përdorur për të shmangur kontrollin nga personat që i kanë lidhur këto përfitime, për të rritur në maksimum saktësinë e kontrollit dhe minimizimin e subjektivitetit. Baza ligjore ishte Ligji nr. 8685, datë 09.11.2000 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, i ndryshuar me datë fillimi vitin 2000.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion grupit të auditimit për këto kontrole rezulton si më poshtë:

- a) një grup inspektimi në Rajonin Shkodër me objekt kontrolli dosjet e ish minatorëve, pleqërisë shtet dhe invaliditetit për rajonet Lezhë, Kukës, Dibër, Shkodër dhe degës Tropojë.
- b) një grup inspektimi në Fier kontrollon dosjet e ish minatorëve, pleqërisë shtet dhe invaliditetit për rajonet Durrës dhe Vlorë.
- c) një grup inspektimi në Vlorë kontrollon dosjet e ish minatorëve, pleqërisë shtet dhe invaliditetit për rajonet Gjirokastrë dhe Fier.
- d) Gjithashtu, nga ana e auditit të ISSH-së është realizuar kontrolli i dosjeve të trajtimit të veçantë për punonjësit e nëntokës për rajonet Tiranë, Korçë dhe Elbasan.

Bazuar në numrin e madh të përfituesve, sipas rajonizimit të kësaj industrie, volumi më i madh i punës ka qenë për grupet Shkodër, Fier, ISSH që kanë mbuluar gjithë veriun, rajonet Tiranë- Durrës dhe rajonet Korçë, Pogradec, Elbasan.

Grupi i ISSH-së ka kontrolluar gjithsej 3264 dosje përfitimesh dhe ka përfunduar pesë raporte auditimi.

Grupi auditit Shkodër ka kontrolluar 1751 dosje përfitimesh dhe ka përfunduar 25 raporte auditimi.

Grupi i auditit Fier ka kontrolluar 318 dosje përfitimesh dhe ka përfunduar 20 raporte auditimi.

Grupi i auditit Vlorë ka kontrolluar 194 dosje përfitimesh dhe ka përfunduar 2 raporte auditimi.

Numri fillestar i përfituesve, sipas kërkesave 5527 persona. Pra, nga 5527 dosje të kontrolluara kanë rezultuar të rregullta 3899 dosje dhe të pezulluara paraprakisht 1,628 dosje me efekt financiar mujor 9,767 mijë lekë. Pra në fund të procesit të kontrollit kanë rezultuar rregullta 3899 dosje përfituesish si dhe 5 raporte të grupit të ISSH të arkivuara, të shoqëruara



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

me urdhër evadimet. Nga krahasimi me të dhënat nga drejtoria e statistikës për numrin e përfituesve në vitin 2009 rezultoi 3701 përfitues, pra 198 përfitues më shumë. Nga 1628 dosje të pezulluara janë rihapur 377 dosje (1628 – 1251) nga rishqyrtimi gjatë periudhës audituese nga faza e projekt raportit deri në raportin përfundimtar të auditimit. Këto rishqyrtime janë rihapur pasi është kryer verifikimi i pagave të punonjësve të nëntokës dhe në sipërfaqe dhe nga listëpagesat nëpër drejtori rajonale, nga verifikimi i ditëve të përfituara të lejeve të zakonshme, etj.

Dosje të pezulluara që janë rihapur nga rishqyrtimi për vitet 2007-2009 në përfundim të auditimeve kanë rezultuar:

a. Dosje të mbyllura nga auditet	1251 dosje
b. Rihapur;	
i. Me vendim të gjykatave	418
ii. Hapur me shkresë të ISSH rikontroll	26
iii. Çelur pas verifikimit vjetërsisë	45
iv. Rihapur nga kontrollet	7
v. Vdekur	1
c. Pensione përfundimisht të mbyllura	754 dosje.
d. Vlera e dëmit	364,974,492 lekë.

Perveç kontrolleve për shkak informaliteti, në dokumentat e financës janë edhe debitorët nga punësimi dhe tërheqja e trajtimit njëkohësisht.

3. Nga viti 2014 e në vazhdim është kontrolluar dhe rikontrolluar çdo pension i lidhur pavarësisht se më parë ka qenë objekt i kontrollit si trajtim i veçantë;

Në vitin 2005 me krijimin e Arkivit Qëndror të ISSH-së, u morën të gjithë dokumentet e vjetërsisë në punë dhe krahas grumbullimit të dokumentacionit filloi dhe procesi i dixhitalizimit. Dixhitalizimi është një proces i kryer në vitet 2010 dhe në vazhdim. Nisur nga raste të veçanta për njësinë e inspektimit është vendosur standardi i kontrollit të çdo përfitimi pavarësisht nëse ka qenë i kontrolluar më parë, kjo për shkak se është krijuar mundësia për të kontrolluar e ballafaquar periudhat e sigurimit në miniera me ato periudha punësimi në kooperativa apo ndërmarrje, meqenëse tashmë administrimi i dokumentacionit nga Drejtoria e Arkivit Qëndror, bënte të mundur verifikimin e periudhave të punës së përfituesve, (për atë sa ato kanë administruar). Nga ana e Njesisë së Inspektimit është bërë kontroll në bazën e të dhënave lidhur me periudhat e punës së secilit përfitues.

Për këtë shkak ka pasur mjaft pensione të rëzuara nga viti 2015 e në vazhdim të cilat kanë kaluar nga TVM (trajtim i veçantë i minatorëve) në pensione me ligjin 150/2014. Raporti për këtë periudhë është përgatitur nga Njësia e inspektimit.

Qëllimi i punës inspektuese së Njesisë së Inspektimit të Përfitimeve është kontrolli dhe çertifikimi i përfitimeve që administrohen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, zbatimi i dispozitave ligjore: në zbatim të Ligjit nr. 8097, datë 21.03.1996 “Për Pensionet Shtetërore Suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, i ndryshuar, Ligjit nr. 10142 datë 15.05.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit nr. 10139, datë 15.05.2009 “Për pensionet shtetërore suplementare të punonjësve të Universiteteve, të shkollave të Larta, Qendrës së Studimeve Albanologjike, Akademisë së Shkencave dhe të gjitha Institucioneve të tjera kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë tituj shkencorë” i ndryshuar, Ligjit nr. 150/2014, datë 06.11.2014 “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Objekt kontrolli i Përfitimeve Supplementare dhe të Trajtimeve të veçanta, është :

1.Zbatimi i akteve ligjore e nënligjore në fuqi, saktësia e llogaritjes së masës së përfitimeve të reja të caktuara në periudhën kohore ndërmjet dy kontrolleve, plotësia dhe vërtetësia e dokumentacionit mbi bazën e të cilave janë caktuar këto përfitime;

2.Regjistrat themeltarë të përfitimeve;

3. Dosjet e lëna me detyra ose të paçertifikuara në kontrollin e mëparshëm.

Caktimi i përfitimeve supplementare dhe trajtimeve të vecanta, inspektohen nga sektori i inspektimit të përfitimeve supplementare dhe trajtimeve të veçanta, i cili ka në strukturën e tij:

Përgjegjës Sektori i Inspektimit të Përfitimeve Supplementare 1

Inspektor 2

Në zbatim të rregulloreve të mësipërme, ky sektor kontrollon dosjet e përfitimeve supplementare dhe trajtimeve të veçanta të caktuara në zbatim të:

-Ligjit nr. 150/2014, datë 06.11.2014 “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë”;

-Ligjit nr. 29/2019 “Për trajtimin financiar, suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji”.

▪ Për realizimin e objektit të kontrollit ky sektor për inspektimin dhe çertifikimin bazohet në Rregulloren nr. 3/1, datë 04.03.2011 “Për një shtesë në Rregulloren nr.3, datë 15.08.1996 “Për caktimin, administrimin dhe pagimin e përfitimeve shtetërore supplementare” e ndryshuar dhe Rregullores nr. 1, datë 21.10.2008 “Për caktimin, administrimin dhe pagesën e pensioneve” e ndryshuar.

Përfitimet e caktuara sipas ligjit nr.150/2014 “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, nëntokë” janë inspektuar nga sektori i inspektimeve supplementare sipas programeve të veçanta për secilën drejtori rajonale të sigurimeve shoqërore dhe sipas periudhave kohore të caktimit të këtyre përfitimeve, duke filluar nga data 1 janar 2015.

Ish-punonjësit e nëntokës që kanë përfitur trajtim të veçantë financiar, sipas ligjit nr. 8685, datë 9.11.2000, "Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë", të ndryshuar, përfitojnë pension sipas këtij ligji kur të arrijnë moshën 55 vjeç dhe të kenë një periudhë të përgjithshme sigurimi 30 vjet e më shumë, përfshirë këtu edhe periudhën e trajtimit të veçantë financiar, nga të cilat, jo më pak se 11 vjet e 6 muaj të jenë në procese pune në miniera, në nëntokë”.

Megjithëse në VKM Nr.78, datë 28.01.2015 “Për zbatimin e ligjit nr. 150/2014, datë 06.11.2014 "Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë”, në kreun I, pika “i është parashikuar që:

- do të konsiderohet periudhë sigurimi në procese pune, në nëntokë, periudha që është njohur dhe miratuar, si periudhë pune në nëntokë, në vendimin e caktimit të trajtimit të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë;

Plani i përcaktuar i punës për çdo inspektor është 15 dosje të kontrolluar në çdo ditë pune. Sektori i Inspektimit të përfitimeve supplementare dhe trajtimeve të veçanta inspekton të gjitha përfitimet supplementare dhe trajtimeve të veçanta të caktuara në zbatim të ligjeve të sipërcituara, lidhur me zbatimin e dispozitave ligjore, dhe kur arrin në përfundimin që përfitimet janë llogaritur saktë i çertifikon ato.

Konkretisht:

për vitin 2016 kontrolli i dosjeve supplementare ka qenë i planifikuar për katër drejtori rajonale dhe janë realizuar katër drejtori rajonale me ndryshim që në vend të DRSSH Tiranë është kontrolluar DRSSH Elbasan.

për vitin 2017 kontrolli i dosjeve supplementare ka qenë i planifikuar për tetë drejtori rajonale dhe janë realizuar katër.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

për vitin 2018 kontrolli i dosjeve suplementare ka qenë i planifikuar për tetë drejtori rajonale dhe janë realizuar shtatë.

për vitin 2019 kontrolli e dosjeve suplementare ka qenë i planifikuar për gjashtë drejtori rajonale dhe janë realizuar pesë.

Pensionet e caktuara sipas ligjit nr. 150/2014 “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë”, nisur nga periudha kohore gjatë së cilës janë caktuar, (nga data 16.12.2014 e në vazhdim), ishin objekt kontrolli sipas programeve të veçanta të inspektimit të miratuara për secilën Drejtori Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, nga viti 2015 e në vazhdim. Konkretisht janë kryet këto inspektime:

Për periudhën 01.01.2015-30.06.2019 janë kryer 23 auditime me programe inspektimi (viti 2016 kryer 5 auditime; viti 2017 kryer 4 auditime; viti 2018 kryer 9 auditime; viti 2019 kryer 5 auditime) dhe rezultojnë:

a-Janë kontrolluar 12 drejtoritë rajonale dhe dy agjensitë lokale për kategorinë e minatorëve dhe rezulton se nga 3782 dosje të trajtimit të veçantë përfshirë këtu edhe 650 dosje të cilat janë plotësuar dhe verifikuar gjatë procesit të auditimit për minatorët, janë çertifikuar 3576 dosje, pra 206 dosje përfituesh më pak, për të cilat 158 dosje janë lënë për plotësim dhe 48 dosje kanë rezultuar debitorë.

b- përfitime të padrejta kanë rezultuar 48 përfitues debitorë në shumën 50,488,598 lekë.

c-efekti financiar nga rishqyrtimi i dosjeve debitorë në shumën 6,024,932 lekë.

d- efekti financiar nga rishqyrtimi i dosjeve kreditorë në shumën 1,894,753 lekë

Të gjitha këto detyrime dhe shuma janë të pasqyruara në sistemin e pensioneve dhe bëhet ndalesë mbi përfitimet mujore në bazë të nenit 62 të ligjit 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në RSH” i ndryshuar.

Tabelë përmbledhëse të kontrolleve të kryera nga viti 01.01.2015-30.06.2019 sipas drejtorive rajonale dhe programeve të inspektimit të miratuara dhe rezultatet e këtyre inspektimeve.

Tabela nr.16

NJËSIA E INSPEKTIMIT TË PËRFITIMEVE									
SEKTORI I PËRFITIMEVE SUPLEMENTARE DHE TRAJTIMEVE TË VEÇANTA									
DRSSH/ DSSH	Periudha, gjatë së cilës janë caktuar përfitimet, e cila është kontrolluar	Numri i përfitimeve të kontrolluara (1) (1= 2+3+4)	Të konstatu ara të rregullta (2)	Pezullime (3)	Efekti financiar nga pezullimet	Numri i përfitimeve të cilat janë plotësuar apo rishqyrtuar gjatë inspektimit (5)	Efekti financiar nga rishqyrtim et (6)	Efekti financiar nga rishqyrtimet (7)	Detyra për plotësim e apo rishqyrti me (4)
DRSSH TIRANË	01.01.2015 - 31.12.2018	934	927	6	8,059,073	78	2,402,773	390,473	1
DRSSH SHKODËR	01.01.2015 - 30.06.2019	97	92	3	332,406	15	257,298		2
DRSSH LEZHË	01.01.2015 - 30.06.2019	198	194	3	929,574	78	325,934	24,984	1
DRSSH KORÇË	01.01.2015 - 30.06.2019	691	676	14	7,588,667	76	1,022,816	478,452	1
DRSSH GJIROKAST ËR	01.01.2015 - 31.12.2018	207	205			82	359,336	130,594	2
DRSSH DIBËR	01.01.2015 - 31.12.2017	669	540	7	12,078,584	30			122
DRSSH KUKËS	01.01.2015 - 31.12.2017	229	216	2	3,522,848	6			11



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

DSSH TROPOJË	01.01.2015 - 31.12.2017	111	93	3	5,128,522	3		96,128	15
DRSSH DURRËS	01.01.2015 - 31.12.2017	257	253	1	1,540,948	105	277,892	527,614	3
DRSSH FIER	01.01.2015 - 30.06.2018	22	21	1	1,444,661	13			
DRSSH ELBASAN	01.01.2015 - 30.06.2018	216	211	5	7,272,231	100	424,616	243,986	
DRSSH VLORË	01.01.2015 - 30.06.2018	115	114	1	321,385	44	76,134		
DSSH SARANDË	01.01.2015 - 30.06.2018	36	34	2	2,269,699	20	878,133	2,522	
TOTALI		3,782	3,576	48	50,488,598	650	6,024,932	1,894,753	158

Burimi i të dhënave: Njësia e Inspektimit të Përfitimeve.

Konstatohet se numri i përfituesve sipas sektorit të përfitimeve suplementare dhe trajtime të vecanta i krahasuar me të dhënat e drejtorisë së statistikës, për të njëjtën datë 30.6.2019, rezulton më shumë për 224 dosje.

Pra, ka një mospërputhje të dhënash, e cila tregon për moskordinim të dhënash brenda drejtorive të ISSH-së.

Në përfundim të auditimit për rezultatet e inspektimit është informuar Drejtori i Përgjithshëm i ISSH-së. Pas kësaj mbetet detyrë e DRSSH-së të ndjekë evadimin përfundimtar të rekomandimeve të kontrollit.

Kontrolli i zbatimit të rekomandimeve bazuar në rregulloren e kontrollit të këtyre përfitimeve realizohet në kontrollin e radhës. Duke parë dinamikën në vite të kontroleve nga Njësia e Inspektimit të Përfitimeve rezulton se përfshin periudha shumë të gjata auditimi deri në 2.5 vite duke mbartur riskut e rritjes së përfitimeve të padrejta (debitore/kreditore), si pasojë e moszhornimit në kohë të ndryshimeve ligjore për llogaritjen e pensioneve të minatorëve nga DRSSH-të.

❖ Në zbatim të ligjit 29/2019 “Për trajtimin financiar, suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji ” dhe të VKM nr.721, datë 11.11.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit, shumës vjetore të transfertës nga buxheti i shtetit dhe procedurave të financimit të fondit të sigurimeve shoqërore, për trajtimin financiar suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji” vazhdon procesi i mbledhjes së kërkesave dhe verifikimit, i cili deri në datën 05.12.2019 rezulton 10,965 ish minatorë të ndarë 14 rajone, prej të cilëve janë verifikuar 1,254 dosje. Për 1254 dosjet e verifikuara është bërë gjenerimi për pagesë në sistemin informatik të pensioneve.

Konstatohet se raportet e prodhuara dhe shpërndara nga Njësia Përgjegjëse për Inspektimin nuk janë të plota dhe të sakta. Kjo praktikë riskon garantimin e gjurmës së auditimit dhe realizimin e objektivit të ISSH –së,që është përmirësimi rrënjësor i praktikave të punës së inspektimit dhe të kontrollit të brendshëm, me fokus luftën kundër informalitetit, nëpërmjet zbatimit të standardeve të përcaktuara.

4. Informimi komunikimi.

Drejtesit e institucionit nuk rezulton të zotërojnë mjaftueshëm informacion për qëllimet dhe rëndësinë e menaxhimit financiar dhe të kontrollit dhe të kenë kryer trajnime mbi Ligjin “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. ISSH disponon një rregullore të shkruar për



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

qarkullimin e dokumentacionit, vendimmarrjes, etj, por duhet të plotësohet (pozicionet e punës për Njësinë e Inspektimit) dhe të miratohet në KA. Institucioni komunikon në formë shkresore zyrtare dhe ka korrespondencë të rregullt me subjektet kryesore të jashtme. Nëpërmjet drejtorive, linjat e komunikimit janë të dobëta, e reflektuar kjo edhe në mungesën e informacionit në drejtim të kohës, përshtatshmërisë, saktësisë dhe disponueshmërinë dhe rakordimit të të dhënave etj, duke ndikuar në cilësinë dhe kushtëzimin e vendimmarrjes.

5. Monitorimi

Në këtë institucion, Drejtori i Përgjithshëm informohet vazhdimisht nga nëndrejtorët e Përgjithshëm, drejtorët dhe përgjegjësit e sektorëve mbi aktivitetin e strukturave që ata drejtojnë me anë të informacioneve, evidencave të ndryshme dhe raporteve, mujore dhe tremujore. Drejtoritë e ISSH kontribuojnë në përgatitjen e raporteve 4-mujore të monitorimit, të cilat dërgohen në Ministrinë e Financave. Çdo muaj dërgohen të dhëna statistikore nga drejtoritë e ISSH-së, por nuk përgatiten raporte të hollësishme për detajimin e tyre. Monitorimet para vitit 2015 nuk kanë funksionuar. Monitorimi i kontrollit të brendshëm kryesisht ka funksionuar në problematikat e identifikuar, nga kontrolli i dosjeve objekt i zbatimit të Ligjit nr. 150/2014 “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë” të cilat janë analizuar nga titullari i institucionit. Stafi ka kryer monitorimin e vetë punës së tyre, nëpërmjet korrigjimit të gabimeve që arrijnë t’i kapin, gjatë kontrollit dhe verifikimit, rishqyrtimit të dosjeve të përfutuesve para se puna e tyre të përcillet për shqyrtim në nivelet më të larta të menaxherëve sektorëve/drejtorive.

Titullari bazuar në rezultatet e monitorimit dhe duke shfrytëzuar problematikat dhe rezultatet e identifikuar ka nxjerrë urdhëra, ka vendosur objektiva për stafin për të korrigjuar gabimet, me qëllim minimizimin e risqeve.

Konkluzion:

1. Nga auditimi konstatohet se ndryshimet strukturore nuk janë pasqyruar në Rregulloren e Brendshme të Institucionit, gjë kjo që riskon të mos garantohet ndarja e qartë e detyrave dhe dhe përgjegjësive sipas pozicioneve të punës.

2. ISSH ka përgatitur regjistër risku ndër vite, por nuk ka shërbyer për të identifikuar, analizuar, vlerësuar, trajtuar, monitoruar dhe komunikuar risqet kryesore që shoqërojnë përgjegjësitë e ISSH-së me qëllim minimizimin e ngjarjeve negative të paparashikuara dhe maksimizimin e mundësive.

Regjistri i riskut në ISSH nuk është hartuar e mbështetur në Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik- Informacion i zgjeruar për Menaxhimin e Riskut Institucional” dhe në Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”. Regjistri gjithashtu nuk i referohet përgjegjësive dhe objektivave të vendosura të ISSH-së. Punonjësit duhet të kryejnë trajnime në fushën e përdorimit të metodikës së pranuar në identifikimin e riskut dhe vlerësimin e tij, dhe se është detyrim i çdo punonjësi të raportojë për çdo ngjarje pozitive apo negative.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se regjistri i riskut është jo i plotë, sepse nuk e përfshin gjithë ISSH.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

Përgjegjësi për të cilën mbajnë z.Astrit Hado me detyrë Drejtori Përgjithshëm i ISSH-së , z. [REDAKTUAR] me detyrë Zv. Drejtor i Përgjithshëm i ISSH-së.

3. Konstatohet se raportet e prodhuara dhe shpërndara nga Njësia Përgjegjëse për Inspektimin nuk janë të plota dhe të sakta. Kjo praktikë riskon garantimin e gjurmës së auditimit dhe realizimin e objektivit të ISSH –së për përmirësimin rrënjësor të praktikave të punës së



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

inspektimit dhe të kontrollit të brendshëm, me fokus luftën kundër informalitetit, nëpërmjet zbatimit të standardeve të përcaktuara.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

Përgjegjësi për të cilën mbajnë zj. [REDAKTUAR] me detyrë Kryetare Dege e Njesisë së Inspektimit të Përfitimeve Afatgjata, z. [REDAKTUAR] me detyrë Drejtor i Auditit të Brendshëm, në cilësinë e kryetarit të Degës së Njesisë së Inspektimit të Përfitimeve për periudhën 07.07.2014-05.02.2018.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në:

Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; Neni 9 Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues: 4. Nëpunësit autorizues të të gjitha niveleve të njësisë publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto përgjegjësi kryesore: c) monitorimin e kontrolleve të risqeve, që vënë në rrezik arritjen e objektivave të njësisë që menaxhojnë;

Neni 10 Përgjegjshmëria menaxheriale e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut 1. Koordinator i menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatori i riskut është nëpunësi autorizues i njësisë publike si dhe në Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit Kapitulli II 2.2.7 Roli i KR-së për njësinë që mbulon, NA kryen aktivitetet e mëposhtme: a) bashkërendimin e veprimtarive që lidhen me identifikimin dhe vlerësimin e risqeve, që vënë në rrezik arritjen e objektivave të njësive dhe ngritjen e sistemit për menaxhimin e riskut, në përpjestim me përmasat e tij; b) këshillimin dhe dhënien e instruksioneve menaxherëve të tjerë të njësisë publike, në bashkëpunim me njësinë qëndrore të harmonizimit, për menaxhimin financiar dhe kontrollin; c) paraqitjen e raportit të përgjithshëm të risqeve të njësisë publike tek titullari i njësisë publike dhe grupi i menaxhimit strategjik të njësisë publike.

Neni 11. Përgjegjshmëria menaxheriale e menaxherëve të tjerë të njësisë Menaxherët e tjerë të strukturave të të gjitha niveleve të njësisë publike janë përgjegjës dhe raportojnë e i japin llogari eprorit, sipas shkallës hierarkike, për: pika 2. Identifikimin dhe krijimin e regjistrit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë. Dhe pika 5. Informacionin në kohë dhe në formën e kërkuar për rezultatet e arritura gjatë përbushjes së përgjegjësive të tyre, për risqet dhe defektet serioze në veprimtarinë e strukturave që drejtojnë, si dhe për masat e marra e të zbatuara për riparimin e këtyre defekteve.

Neni 12. Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues, pika 3. Nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve të njësisë publike përgjigjen përpara nëpunësit autorizues përkatës për: d) identifikimin dhe krijimin e regjistrit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë;

dh) dokumentimin e të gjitha transaksioneve financiare dhe të tjera dhe garantimin e gjurmës së auditimit për të gjitha proceset që ndodhin në njësi;

Neni 16 Detyrimi për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit, pika 2 , Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit, për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit.

Për sa më lart është mbajtur Akt Konstatim nr. 3, datë 05.12.2019.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Vlerësimi i sistemit të kontrollit të brendshëm në lidhje me mbrojtjen e fondit të sigurimeve shoqërore

Titulli i çështjes: Vlerësimi i sistemit të kontrollit të brendshëm

Gjetja 11: Mangësi në funksionimin dhe dokumentimin e Kontrollit të Brendshëm, në drejtim të hartimit të regjistrit të riskut dhe raporteve të prodhuara dhe shpërndara nga Njësia Përgjegjëse për Inspektimin.

Situata: 1. Nga auditimi konstatohet se për shkak të ndryshimeve të strukturës dhe të mosreflektimit në Rregulloren e Brendshme të Institucionit, riskohet të mos garantohet ndarja e qartë e detyrave dhe pozicioneve, pasi drejtoritë e ISSH kanë funksionuar pa patur një bazë ligjore të miratuar për parashikimin e detyrave dhe përgjegjësi sipas pozicioneve të punës.

2. ISSH ka përgatitur regjistër risku ndër vite, por nuk ka shërbyer për të identifikuar, analizuar, vlerësuar, trajtuar, monitoruar dhe komunikuar risqet kryesore që shoqërojnë përgjegjësitë e ISSH-së me qëllim minimizimin e ngjarjeve negative të parashikuara dhe maksimizimin e mundësive.

Regjistri i riskut në ISSH nuk është hartuar e mbështetur në Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik- Informacion i zgjeruar për Menaxhimin e Riskut Institucional” dhe në Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”. Regjistri gjithashtu nuk i referohet përgjegjësi dhe objektivave të vendosura të ISSH-së. Punonjësit duhet të kryejnë trajnime në fushën e përdorimit të metodikës së pranuar në identifikimin e riskut dhe vlerësimin e tij, dhe se është detyrim i çdo punonjësi të raportojë për çdo ngjarje pozitive apo negative.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se regjistri i riskut është jo i plotë, sepse nuk e përfshin gjithë ISSH.

3. Konstatohet se raportet e prodhuara dhe shpërndara nga Njësia Përgjegjëse për Inspektimin nuk janë të plota dhe të sakta. Kjo praktikë riskon garantimin e gjurmës së auditimit dhe realizimin e objektivit të ISSH –së, që është përmirësimi rrënjësor i praktikave të punës së inspektimit dhe të kontrollit të brendshëm, me fokus luftën kundër informalitetit, nëpërmjet zbatimit të standardeve të përcaktuara.

Kriteri: Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe Manuali Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

Ndikimi/Efekti: Mangësi në mjedisin e kontrollit, sistemet e kontrollit të brendshëm, linjave të raportimit dhe monitorimit.

Shkaku: Mos marrja e masave nga ana e drejtuesve për përgatitjen dhe miratimin e dokumentacioneve në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

Rekomandimi 11: a) Struktura përgjegjëse të ISSH-së të vlerësojnë në regjistrin e riskut të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

gjitha problematikat e dala nga Njësia e Inspektimit të Përfitimeve, për pensionet suplementare të minatorëve që paraqesin risk.

b) Institucioni të marrë masa që planifikimi i kontrolleve dhe çertifikimi i pensioneve të minatorëve nga Njësia e Inspektimit të Përfitimeve të kryhet jo më vonë se një vit, me qëllim identifikimin në kohë të mangësive dhe dëmeve të shkaktuara në mënyrë që fondet për pensione të përdoren me efektivitet.

c) Njësia Përgjegjëse për Inspektimin të marrë masa për përmirësimin rrënjësor të praktikave të punës së inspektimit dhe të kontrollit të brendshëm, me synim garantimin e gjurmës së auditimit dhe realizimin e objektivit të ISSH –së, me fokus luftën kundër informalitetit.

Afatipër zbatimin e rekomandimit: Në vijimësi.

V. KONKLUZIONE DHE OPINIONI AUDITIMIT

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Pasaktësi në hedhjen fillestare të të dhënave në sistemin e pensioneve PCAMS, në vitin 2012, për përfituesit e skemës së Ligjit nr.8685, datë 09.11.2000 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në minierë, në nëntokë”. Më konkretisht: Nga të dhënat e gjeneruara të sistemit informatik të pensioneve PCAMS, të administruara nga grupi i auditimit, në datë 25.11.2019, rezultojnë përfitues të Ligjit nr.8685, datë 09.11.2000, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, të ndryshuar, 4,430 persona, ndërkohë që nga të dhënat e paraqitura nga ISSH, me shkresën nr.7719/3, prot, datë 23.12.2019, protokolluar në KLSH me nr.919/3, datë 24.12.2019, numri total i përfituesve të hedhur në sistemin informatik aktual të pensioneve PCAMS, në vitin 2012 ka qenë 4,396 përfitues, nga 5,549 kërkesa të pranuar. Ndonëse në sistem në vitin 2012 janë hedhur të gjitha dosjet stok, që do të thotë: dosje aktive plus dosje të mbyllura, në asnjë rast, në informacionet që ISSH vuri në dispozicion të grupit të auditimit, numri i përfituesve nga Ligji nr.8685, datë 09.11.2000 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në minierë, në nëntokë” të hedhur në sistem nuk përputhet me numrin e kërkesave për përfitim të pranuar nga ISSH (*Më hollësisht trajtuar në pikën A, faqe 12-15 & 32-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandimi: a) ISSH të kalojë në një proces inspektimi/verifikimi dhe më pas dixhitalizimi, të gjithë regjistrat e kërkesave, kthimeve, caktimeve, mbylljeve, të trajtimit të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të cilat administrohen nga Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore;

b) Në përfundim të procesit të inspektimit/verifikimit, të dokumentacionit të administruar nga DRSSH, ISSH të verifikojë gjithë informacionin e hedhur në sistemin informatik të pensioneve PCAMS, në vitin 2012 dhe rezultatet e këtij procesi t’i pasqyrojë në sistem në një kolonë të veçantë.

Brenda datës 31.01.2020

2. Gjetje nga auditimi: Bazuar në të dhënat e sistemit PCAMS, sot përfitojnë trajtim të veçantë sipas Ligjit nr.8685 datë 09.11.2000, ende 147 ish minatorë, por të dhënat e



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

gjeneruara nga sistemi informatik i pensioneve në datë 25.11.2019 dhe në datë 18.12.2019, për grupin e auditimit, paraqesin pasaktësi në lidhje me kategorinë e minatorëve përfitues të cilët në momentin e plotësimit të kriterëve të Ligjit nr.150/2014 datë 24.11.2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë”, kanë zgjedhur të heqin dorë si përfitues të Ligjit nr.8685 datë 09.11.2000 dhe kanë kërkuar të trajtohen sipas përcaktimit të Ligjit nr.150/2014 datë 24.11.2014.

Më konkretisht: Nga të dhënat e gjeneruara të sistemit informatik të pensioneve PCAMS, të administruara nga grupi i auditimit, në datë 25.11.2019, rezultojnë përfitues të Ligjit nr.8685, datë 09.11.2000, “Për një trajtim të vecantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, të ndryshuar që kanë zgjedhur të heqin dorë si përfitues të Ligjit nr.8685 datë 09.11.2000 dhe të kërkojnë të trajtohen sipas përcaktimit të Ligjit nr.150/2014 datë 24.11.2014, 2,237 persona, ndërkohë që nga të dhënat e paraqitura nga ISSH, me shkresën nr.7719/3, prot, datë 23.12.2019, protokolluar në KLSH me nr.919/3, datë 24.12.2019, numri total i përfituesve nga Ligji nr.8685, datë 09.11.2000 që kanë zgjedhur të trajtohen sipas Ligjit nr.150/2014, paraqitet, 3,214 persona (*Më hollësisht trajtuar në pikën B, faqe 41-42&47-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1. Rekomandimi:a) Njësia e Inspektimit në ISSH të kalojë në një proces shqyrtimi/certifikimi 147 dosjet e personave përfitues të Ligjit nr.8685, datë 09.11.2000, të cilët aktualisht rezultojnë aktiv në skemë;

b) ISSH të identifikojë numrin e saktë të ish përfituesve sipas Ligjit nr.8685 datë 09.11.2000, që sot trajtohen me përfitim sipas nenit 9 “E drejta për të zgjedhur përfitimin”, të Ligjit nr.150/2014 datë 24.11.2014 “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë”;

c) Në përfundim të procesit, për të garantuar transparencën ndaj grupeve të interesit të publikojë në faqen zyrtare të ISSH listat emërore të personave përfitues aktiv sipas Ligjit nr.8685, datë 09.11.2000 “Për një trajtim të vecantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”.

Brenda datës 31.01.2020

3. Gjetje nga auditimi:Nga kryqëzimi dhe testimi me zgjedhje i evidencave të vëna në dispozicion, gjeneruar nga sistemi PCAMS, të përfituesve të Ligjit nr.150/2014 datë 24.11.2014, është konstatuar se evidenca e përfituesve aktual aktiv të Ligjit 150/2014 vendosur në dispozicion nga Drejtoria e Burimeve të Informacionit ka pasaktësi, për rrjedhojë është e pamundur identifikimi i numrit të saktë total të përfituesve nga ky ligj. Gjithashtu nga auditimi është konstatuar se në sistemin PCAMS për të njëjtën kategori përfituesish “subjekte që u ndërpritet përfitimi pas verifikimeve të vet strukturave të ISSH” ekzistojnë në sistem 3 kategori të ndryshme, duke rezultuar në një praktikë të paunifikuar të hedhjes së të dhënave në sistem, çka shkakton konfuzion dhe keq interpretim të shifrave (*Më hollësisht trajtuar në pikën B, faqe 43-45&48-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1. Rekomandimi:a) ISSH të marrë masat për identifikimin e saktë të përfituesve aktiv sipas Ligjit 150/2014 datë 24.11.2014, të ndarë sipas dy kategorive në “përfitues të ardhur nga Ligji nr.8685” dhe “përfitues të rinj”, dhe në përfundim të procesit të publikojë në faqen zyrtare listën emërore të përfituesve të këtij ligji, për të garantuar transparencën;

b) ISSH të unifikojë praktikën e hedhjes së të dhënave në sistem në të gjitha rajonet, duke përcaktuar qartësisht në një akt administrativ, se si do të përshkruhen në sistem veprime specifike dhe ndryshime të statusit të dosjeve.

Brenda datës 31.01.2020

4. Gjetje nga auditimi: a) Aktualisht në momentin e auditimit, 658 nga 774 debitorë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

(përfitime të padrejta), ose 85% e numrit të përgjithshëm të debitorëve nuk janë në proces arkëtimi dhe shuma e debisë që ata përfaqësojnë (436,067,017 lekë) zë 89% të shumës totale të debisë (487,931,873 lekë);

b) 64 përfitues debitorë në shumën 36,561,410 lekë, ose 9,7% e debitorëve nuk shlyejnë debinë edhe pse rezultojnë të jenë pjesë e skemës së përfitimeve nga viti 2013 deri në vitin 2019.

c) 10 nga 37 përfitues (punonjës që kanë punuar në miniera, në nëntokë), ose 27% e atyre që u është ndërprerë trajtimi se kanë filluar punë, rezultojnë debitorë në shumën 5,741,200 lekë dhe aktualisht janë në kushtet e pamundësisë për të shlyer debinë, pasi aktualisht nuk janë pjesë e asnjë prej skemave të pensionit (*Më hollësisht trajtuar në pikën A, faqe 17-18; 21-23 & 34-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1. Rekomandimi: a) Të hartojë politika dhe të formalizojë procedura të qarta, për të mundësuar arkëtimin e shumës debitorë prej 436,067,017 lekë, nga moment i hyrjes së përfituesve debitorë në një prej skemave të përfitimit;

b) Të nxjerrë përgjegjësitë administrative, sipas DRSSH-ve respektive për mosarkëtimin e debisë për 64 përfituesit debitorë të cilët edhe pse rezultojnë të jenë pjesë e skemës së përfitimeve nga viti 2013 deri në vitin 2019, ende vazhdojnë të mosshlyejnë debinë.

Brenda datës 31.01.2020

5. Gjetje nga auditimi: Në harkun kohor të viteve 2000-2012 kanë përfunduar 418 procese gjyqësore në favor të përfituesve (ish punonjës që kanë punuar në miniera në nëntokë), duke sjellë për pasojë rikthimin e tyre në skemën e pensioneve, ndërkohë që në viteve 2013-2018, nga 610 procese gjyqësore të hapura, 434 procese, ose 71.4% e tyre janë humbur nga ISSH dhe vetëm 176 procese, ose 28.6% e tyre janë fituar nga ISSH. Gjatë vitit 2019, janë hapur gjithësej 195 procese gjyqësore, në 14 rajone të vendit, nga të cilat: 28 procese, ose 14.4% e tyre janë humbur nga ISSH, 26 procese, ose 13.3% e tyre janë fituar nga ISSH dhe 141 çështje, ose 72.3% e çështjeve janë në proces gjykimi. Pra në harkun kohor 2013-2018 janë humbur nga ISSH mbi 70% e proceseve gjyqësore, ndërkohë që për vitin 2019, ende nuk ka rezultate përfundimtare pasi 72.3% e çështjeve janë në proces gjykimi. Në total, për periudhën 2000-2019, rezultojnë 880 procese gjyqësore të humbura nga ISSH ndaj punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë (880 përfitues, të identifikuar si përfitime të padrejta, i janë rikthyer skemës së përfitimit të pensionit) nga të cilat vetëm për periudhën 01.01.2008-31.10.2019, ISSH ka paguar kundrejt minatorëve përfitues të skemës së Ligjit nr.8685/2000 dhe Ligjit nr.150/2014, në total 709,169,746 lekë, ose 96.3% të debisë totale të arkëtuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën A, faqe 21 & 36-37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1. Rekomandimi: ISSH të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë administrative në lidhje me vendimet gjyqësore, në dëm të institucionit. Për çdo proces gjyqësor të përfunduar, të zhvillohen analizat nga Drejtoria Juridike në ISSH dhe Drejtori i Përgjithshëm i ISSH-së dhe të nxirren përgjegjësitë administrative kundrejt personave të autorizuar të ISSH-së, për mosveprimet dhe mospërmbushjen e detyrës shtetërore.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Pasaktësi në raportimet e kryera nga Drejtoria e Financës në ISSH:

a) Raportimin e numrit të përfituesve 5,549 minatorë përfitues për vitin 2003 dhe 5,554 përfitues për vitin 2004, ndërkohë që grupit të auditimit nga strukturat e auditimit dhe certifikimit në ISSH i është raportuar si numër fillestar i kërkesave të rregjistruara në DRSSH dhe të pranuar 5,527 përfitues;

b) Raportimin e shumës faktike të shpenzimeve buxhetore, për periudhën 2003-2018. Nga



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Drejtoria e Financës raportohen shpenzime faktike për pagesat e parakohshme për minatorët e nëntokës, për vitin 2018 në shumën 235,822,000 lekë, nga 663,702,830 lekë, që rezulton tëketë përfituar ISSH, në zërin “Transferte për pagesat e parakohshme për minatorët”, siguruar kjo nga të dhënat e sistemit të thesarit të qeverisjes së përgjithshme, për vitin buxhetor 2018.

Në fund të vitit 2018, Drejtoria e Financës raporton 460 përfitues më shumë se në vitin 2017, ndërkohë që shpenzimet faktike në vitin 2018 i raporton të ulura me 167,400,000 lekë, ose në masën 58.5%, krahasuar me vitin 2017.

Sipas sqarimeve të paraqitur nga ISSH, me shkresën nr.7719/3 prot, datë 23.12.2019, protokolluar në KLSH me nr.919/3, datë 24.12.2019, në lidhje me deformimin e evidentimit të shpenzimeve të transfertës buxhetore për kategorinë e minatorëve të nëntokës, sqarohet se: *“ky deformim ka ndodhur pasi në sistemin PCAMS nuk është bërë një zhvillim i veçantë evidentimi i shpenzimeve faktike sipas artikullit. Kjo ka sjellë si pasojë që shpenzimet të ngarkohen në zërin pensione pleqërie dhe stornimi i tyre të bëhet në mënyrë empirike dhe me gabime. Në vitin 2018 nuk është bërë kontrolli i plotë për evidentimin në këtë zë në momentin e mbylljes së raportit fiskal, datë 15 janar si dhe të mbylljes së bilancit financiar. Problematika është konstatuar me vonesë”*.

Aktualisht të dhënat statistikore, përpunohen manualisht nga drejtoria e financës, pasi sistemi informatik i pensioneve PCAMS nuk rezulton i lidhur me sistemin e financës FMS në ISSH (Financial Management System), detyrim ky për organizimin dhe koordinimin e të dhënave midis dy sistemeve. *(Më hollësisht trajtuar në pikën A,faqe 23-25&37-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1. Rekomandimi: ISSH të marrë masa për zhvillimin e sistemit elektronik të pensioneve PCAMS duke e ndërlidhur atë me sistemin e financës FMS me synim prodhimin e raporteve dhe statistikave në kohë reale dhe me nivel minimal gabimi.

Gjatë vitit 2020

7. Gjetje nga auditimi: Mosushtrimi nga ana e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm i kërkesave të pikës 3 të VKM nr.301, datë 23.05.2018, dalë në zbatim të Ligjit nr.72/2017, që përcaktojnë se, rregullshmëria e vendimeve të DRSSH lidhur me evidentimin dhe shlyerjen e detyrimeve të falura sipas dispozitave të Ligjit nr.72/2017, do të jenë objekt i vecantë auditimi nga auditi i brendshëm i ISSH-së dhe rezultatet e auditimit do t’i njoftohen Ministrsit të Financave dhe të Ekonomisë. Në total, për vitet 2017-2018, rezultojnë debi të falura në shumën 204,824,805 lekë. Kjo shumë e detyrimit të falur nuk është audituar nga DAB e ISSH-së. *(Më hollësisht trajtuar në pikën A,faqe 26-29&38-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në ISSH, në planin vjetor të vitit 2020, të planifikojë një auditim të vecantë mbi rregullshmërinë e vendimeve të DRSSH, në lidhje me evidentimin dhe shlyerjen e detyrimeve të falura, në shumën 204,824,805 lekë, sipas dispozitave të Ligjit nr.72/2017 dhe në përfundim të procesit, rezultatet e arritura të pasqyrohen në një shtyllë të vecantë në sistemin informatik të pensioneve PCAMS si dhe t’i bëhen me dije Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Deri në datë 31.03. 2020

8. Gjetje nga auditimi: Mosrakordim të dhënash midis sistemit informatik të pensioneve PCAMS dhe strukturës së inspektimit, në lidhje me numrin e dosjeve të mbyllura, si vijon: Në datë 25.11.2019, në sistemin elektronik të pensioneve PCAMS, të ISSH-së, rezultojnë në total 4,168 përfitues nga Ligji 150/2014, prej të cilëve vetëm 3,177 janë përfitues aktiv të skemës. Diferenca prej 991 përfituesish, përfaqëson numrin e përfituesve, dosjet e të cilëve



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

kanë rezultuar me problem nga verifikimi dhe janë mbyllur. Njësia e Inspektimit të Përfitimeve si struktura përgjegjëse për auditimin e përfitimeve në zbatim të Ligjit nr.150/2014, e miratuar me Vendimin e Këshillit Administrativ nr.6, datë 20.07.2010, raporton për 3,782 dosje minatorësh përfitues të inspektuara në total, nga të cilat: certifikuar të rregullta 3,576 dosje, pezulluar 48 dosje dhe lënë detyrë për plotësim për 158 dosje, nga 991 dosje të mbyllura të raportuara nga informacioni i gjeneruar nga sistemi PCAMS, në datë 25.11.2019 (*Më hollësisht trajtuar në pikën A,faqe 18-19&35-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

8.1. Rekomandimi:a)Strukturat përgjegjëse në ISSH të koordinojnë punën në funksion të, saktësisimit dhe detajimit të 991 përfituesve, (dosjet e të cilëve rezultojnë të mbyllura nga auditimi në sistemin informatik të pensioneve PCAMS), nga zbatimi i skemave të Ligjit nr.8685/2000 dhe Ligjit nr.150/2014;

b) Pasi të saktësohet statusi i tyre të pasqyrohen vecmas në sistem nën kategorinë “Konkluduar sa përfitur padrejtësisht”.

Brenda datës 31.01.2020

9. Gjetje nga auditimi: Janë konstatuar mangësi në komponentët e Kontrollit të Brendshëm, si vijon: a) Në rregulloren për Organizimin e Detyrave Funksionale në Drejtorinë e Përgjithshme të ISSH –së si dhe në rregulloren nr.1/2, datë 04.03.2011 “Për një shtesë në Rregulloren nr.1, datë 21.10.2008 “Për caktimin, administrimin dhe pagesën e pensioneve”, e ndryshuar, e emërtuar projekt rregullore për Njësinë e Inspektimit të Përfitimeve, nuk janë reflektuar ndryshimet strukturore gjë e cila nuk garanton ndarjen e qartë të detyrave sipas pozicioneve të punës; b) Në të dy rregulloret e sipërcituara nuk është përfshirë “E drejta e vendosjes së gjobës”, si detyrim që rrjedh nga zbatimi i nenit 5 të Ligjit nr.150/2014“Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, ku shprehimisht citohet: “...personi dënohet me gjobë në masën katërfish të dëmit të shkaktuar, pavarësisht nga dënimi i parashikuar në dispozitën përkatëse të Kodit Penal”; c) Në regjistrin e riskut nuk janë përfshirë objektivat që lidhen me, identifikimin e saktë të të gjithë përfituesve të pensioneve që kanë punuar në miniera, në nëntokë dhe pasqyrimin e tyre në sistemin informatik të pensioneve PCAMS; d) Pasaktësi në raportet e prodhuara dhe shpërndara nga Njësia Përgjegjëse për Inspektimin, gjë e cila riskon garantimin e gjurmës së auditimit dhe realizimin e objektivit të ISSH –së, që është përmirësimi rrënjësor i praktikave të punës së inspektimit dhe të kontrollit të brendshëm, me fokus luftën kundër informalitetit, nëpërmjet zbatimit të standardeve të përcaktuara (*Më hollësisht trajtuar në pikën A&C, faqe 18-19; 31-32&50-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

9.1. Rekomandimi:a)ISSH të marrë masa për përmirësimin e Rregullores për Organizimin e Detyrave Funksionale në Drejtorinë e Përgjithshme të ISSH–së dhe Rregullores nr.1/2, datë 04.03.2011 “Për një shtesë në Rregulloren nr.1, datë 21.10.2008 “Për caktimin, administrimin dhe pagesën e pensioneve”, e ndryshuar, në drejtim të reflektimit në to të ndryshimeve strukturore si dhe të përfshirjes në detyrat e Njësisë Përgjegjëse për Inspektimin të drejtën e vendosjes së gjobës, si detyrim që rrjedh nga zbatimi i nenit 5 të Ligjit nr.150/2014“Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”;

b)Strukturat përgjegjëse të ISSH–së të vlerësojnë në regjistrin e riskut të gjitha problematikat e dala nga Njësia e Inspektimit të Përfitimeve, për pensionet suplementare të minatorëve që paraqesin risk;

c) Institucioni të marrë masa që planifikimi i kontrolleve dhe çertifikimi i pensioneve të minatorëve nga Njësia e Inspektimit të Përfitimeve të kryhet jo më vonë se një vit, me qëllim identifikimin në kohë të mangësive dhe dëmeve të shkaktuara në mënyrë që fondet për pensione të përdoren me efektivitet;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

d)Njësia Përgjegjëse për Inspektimin të marrë masa për përmirësimin rrënjësor të praktikave të punës së inspektimit dhe të kontrollit të brendshëm, me synim garantimin e gjurmës së auditimit dhe realizimin e objektivit të ISSH –së, me fokus luftën kundër informalitetit.

Brenda datës 31.01.2020, për pikën (a) dhe në vijimësi për pikat e tjera

10. Gjetje nga auditimi: Në pasqyrat financiare të vitit 2018, në klasën 4, në zërin “Të tjera kërkesa debitoare”, debitorët në ISSH, për vitin ushtrimor 2018, paraqiten në shumën 7,543,983,113.92 lekë, që përfaqëson: debitorë nga kontributet në shumën 1,560,339,000 lekë dhe debitorë nga përfitimet në shumën 5,893,644,000 lekë. Në relacionin shoqërues të pasqyrave financiare të vitit 2018, nuk ka një analizë të kategorive të debitorëve nga përfitimet që përbëjnë shumën 5,893,644 mijë lekë, veprim ky jo në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar (Më hollësisht trajtuar në pikën A,faqe 25-26&39-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1. Rekomandimi:Drejtoria e Financës të marrë masa që në hartimin e pasqyrave financiare të vitit 2019, të analizojë zërin “Të tjera kërkesa debitoare”, sipas të gjitha kategorive të përfituesve që e përbëjnë atë dhe në mënyrë të vecantë, të saktësojë shumën e përfitimeve për kategorinë e punonjësve që kanë punuar në minierë në nëntokë.

Deri në datë 31.03. 2020

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT